

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

GJYKATA E QARKUT NË PRISHTINË

P.Nr. 244/10

Data: 17 Qershor 2011

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me trupin gjykues të përbërë nga:

- 1) Gjykatësi i EULEX, Z. Gianfranco Gallo, si kryetar i trupit gjykues,
- 2) Gjykatësi Vendor, Z. Gëzim Llulluni, si anëtar i trupit gjykues, dhe
- 3) Gjykatësi i EULEX, Z. Ferdinando Buatier de Mongeout, si anëtar i trupit gjykues,

Të ndihmuar nga procesmbajtësja e nënshkruar më poshtë, në çështjen penale kundër:

1. Shpejtim ADEMAJ, data e lindjes 13 Dhjetor 1980, Gjakovë, mashkull, kombësia Shqiptar, shtetësia Kosovare, numri i pasaportës: K00152217, adresa Fshati Jabllanicë, Gjakovë;
2. Avni HAJDARI, emri i babait Ahmet, data e lindjes 29 Gusht 1958, në fshatin Ballovc, Podujevë, mashkull, kombësia Shqiptar, shtetësia Kosovare, adresa fshati Ballovc, Podujevë;
3. Fatmir PAJAZITI, data e lindjes 24 Maj 1959, mashkull, kombësia Shqiptar, adresa e fundit e njohur Fshati Smire, komuna e Vitisë;
4. Xhemajl HALILAJ, emri i babait Hamit, data e lindjes 20 Prill 1953, në Tërdevc, Drenas, kombësia Shqiptar, shtetësia Kosovare;
5. Shaip SELMANI, emri i babait Ismail, 30 Nëntor 1961, lagja Emshir-Kalabria, Rruga Agim Qela Prishtinë Sheka 1010002407;
6. Ismail KRAPI, emri i babait Rexhep, data e lindjes 08 Qershor 1980 në Emshir-Kalabria, Rruga Agim Qela, Prishtinë, nofka: Buci, numri i letërnjoftimit: 1010002482;
7. Rabit AJVAZI, data e lindjes 11 Shtator 1975, në Zhegër, Komuna e Gjilanit, kombësia Shqiptar, shtetësia Kosovare, numri i letërnjoftimit 10095961480; dhe
8. Blerim ADEMAJ, data e lindjes 7 Shkurt 1988, Jabllanicë, Gjakovë, mashkull, kombësia Shqiptar, shtetësia Kosovare, adresa e tanishme Av D'EC Hallens 128, 1004 Lausanne, Zvicër.

Të gjithë përveç Blerim Ademajt të akuzuar sipas aktakuzës së 7 Korrikut 2010, të paraqitur në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë më 13 Shtator 2010,

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

për veprat penale:

- Krimi i Organizuar, sipas nenit 274 paragrafi 4 dhe Nenit 23 të KPK
- Kontrabandimi me Migrantë në bashkëkryerje, sipas Nenit 138 (6) dhe Nenit 23 të KPK.

Pas shqyrtimit gjyqësor, të mbajtur në praninë e Prokurorit Publik, të akuzuarve, avokatëve të tyre mbrojtës më:

20 Janar 2011;
2, 3, 9, 10, 21, 23 dhe 24 Shkurt 2011;
4 Mars 2011;
7, 14, 15 dhe 18 Prill 2011;
12, 13 dhe 24 Maj 2011; dhe
9, 10 dhe 17 Qershor 2011

pas shqyrtimit dhe votimit nga ana e trupit gjykues të mbajtur më 17 Qershor 2011, në bazë të Neneve 390 dhe 391 para. 1 të KPPK,

më 17 Qershor 2011, sipas Nenit 392 Paragrafi (1) të KPPK, shpall publikisht dhe në prezencën e të akuzuarve, këtë

AKTGJYKIM

Rabit AJVAZI

LIROHET NGA AKUZA

për veprat penale Krimi i Organizuar, sipas nenit 274, paragrafi 4 të KPK dhe Kontrabandimi me Migrantë në bashkëkryerje, sipas Nenit 138, paragrafi 6 dhe Nenit 23 të KPK, pasi që nuk është provuar që i akuzuari ka kryer veprën për të cilën është akuzuar;

Fatmir PAJAZITI, Xhemajl HALILAJ dhe Blerim ADEMAJ

LIROHEN NGA AKUZA

për veprën penale Krimi i Organizuar, sipas nenit 274, paragrafi 4 të KPK, pasi që nuk është provuar që të akuzuarit kanë kryer veprën për të cilën janë akuzuar;

Shaip SELMANI dhe Ismail KRAPI

LIROHEN NGA AKUZA

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

për veprën penale Kontrabandimi me Migrantë në bashkëkryerje, sipas Nenit 138, paragrafi 6 dhe Nenit 23 të KPK, pasi që nuk është provuar që të akuzuarit kanë kryer veprën për të cilën janë akuzuar;

Avni HAJDARI dhe Shpejtim ADEMAJ

SHPALLEN FAJTORË

për veprën penale Krimi i Organizuar, sipas Nenit 274, paragrafi 4 të KPK, sepse gjatë vitit 2009, deri në Tetor 2009, në territorin e Kosovës, kanë marrë pjesë aktivisht në veprimet kriminale të një grupi të organizuar të përbërë nga ata vetë, Anton Gecaj, Ismet Rama, një person me nofkën Joca, Ismail Krapo, Shaip Selmani dhe njerëz të tjerë ende të pidentifikuar. Aktiviteti kryesor i grupit të organizuar ka qenë kontrabandimi ilegal i migrantëve nga Kosova për në shtetet tjera të Evropës (kryesisht Francë, Gjermani, Zvicër dhe Austri) duke fituar kështu përfitime enorme materiale nga aktiviteti i lartpërmendur. Organizata ka mundur të llogaris në një strukturë të organizuar mirë, e cila, nën udhëheqjen e Anton Gecajt, në këmbim të një shume të parave të ndryshueshme prej 3000 deri në 1500 euro për migrant, ka marrë dhe transportuar migrantët nga Kosova për në Serbi (në këtë pjesë të aktivitetit kriminal kryesisht kanë qenë të përfshirë Avni Hajdari, Ismet Rama, Shpejtim Ademaj, Ismail Krapo dhe Shaip Selmani) pastaj nga Serbia (për këtë pjesë të aktivitetit kriminal kryesisht ka qenë përgjegjës Joca) dhe pastaj nga Serbia për në Hungari (për këtë pjesë të aktivitetit kriminal ka qenë përgjegjës Anton Gecaj) dhe pastaj nga aty për në destinacionet e cekura më lartë. Aktivitetet e grupit të organizuar kanë rezultuar, më 14 Tetor 2009, në vdekjen e migrantëve ë vijim: Elvira Jaha, Ilir Agushi, Brahim Koci, Florin Ademi, Elfete Ademi, Albert Ademi, Florian Ademi, Lendita Krasniqi, Agnesa Krasniqi, Anita Krasniqi, Rrahim Mirena, Valbona Mirena, Doruntina Mirena, Dafina Mirena dhe Agnesa Mirena.

Shpejtim ADEMAJ

SHPALLET FAJTORË

për veprën penale Kontrabandimi me Migrantë në bashkëkryerje, sipas Nenit 138, paragrafi 6 dhe Nenit 23 të KPK sepse më 14 Tetor 2009, në territorin e Kosovës, duke vepruar si pjesëtar i një grupi kriminal dhe në bashkëkryerje me Anton Gecajn dhe të tjerët, në një mënyrë në të cilën ka vënë në rrezik jetën dhe sigurinë e migrantëve, është përfshirë në kontrabandimin e migrantëve Ilir Agushi, Lendita Krasniqi, Agnesa Krasniqi, Anita Krasniqi nga Kosova për në Zvicër, Brahim Koci nga Kosova për në Gjermani; veçanërisht Shpejtim ADEMAJ ka transportuar migrantët e cekur më lartë për në Gjilan ku ata janë marrë nga shoferë të tjerë me qëllim që të përcillen ilegalisht përjashta Kosovës dhe ai është dashtë të merrte një pjesë të parave nga çmimi i kontrabandimit (që ishte 3000 për person për Ilir Agushin dhe Brahim Kocin dhe 10000 Franga Zvicerane për familjen Krasniqi) pasi që migrantët të arrijnë në destinacionin e tyre përfundimtar;

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Avni HAJDARI

SHPALLET FAJTORE

për veprën penale Kontrabandimi me Migrantë në bashkëkryerje, sipas Nenit 138, paragrafi 6 dhe Nenit 23 të KPK sepse më 14 Tetor 2009, në territorin e Kosovës, duke vepruar si pjesëtar i një grupi kriminal dhe në bashkëkryerje me Anton Gecajn dhe të tjerët, në një mënyrë në të cilën ka vënë në rrezik jetën dhe sigurinë e migrantëve, është përfshirë në kontrabandimin e migrantëve B R, Elvira Jaha dhe dy fëmijëve të tyre, Florin Ademi, Elfete Ademi, Albert Ademi, Florian Ademi nga Kosova për në Austri; veçanërisht Avni Hajdari ka bërë marrëveshjet për çmimin e kontrabandimit dhe për transportim të migrantëve përjashta Kosovës dhe ai është dashtë të merrte shumën e parave nga çmimi i kontrabandimit (që ishte 6.500 euro për familjen Rama dhe 6900 për familjen Ademi) pasi që migrantët të arrijnë në destinacionin e tyre përfundimtar;

Ismail KRAPI dhe Shaip SELMANI

SHPALLEN FAJTORE

për veprën penale Krimi i Organizuar, sipas Nenit 274 paragrafi 2 të KPK, në këtë mënyrë e ri-klasifikuar akuza origjinale, sepse nga Qershori deri në Shtator 2009, në territorin e Kosovës, kanë marrë pjesë aktivisht në aktivitetet kriminale të një grupi të organizuar të përbërë nga ata vetë, Anton Gecaj, Ismet Rama, një person me nofkën Joca, Avni Hajdari, Shpejtim Ademaj dhe njerëz të tjerë ende të paidentifikuar. Aktiviteti kryesor i grupit të organizuar ka qenë kontrabandimi ilegal i migrantëve nga Kosova për në shtetet tjera të Evropës (kryesisht Francë, Gjermani, Zvicër dhe Austri) duke fituar kështu përfitime enorme materiale nga aktiviteti i lartpërmendur. Organizata ka mundur të llogaris në një strukturë të organizuar mirë, e cila, nën udhëheqjen e Anton Gecajt, në këmbim të një shume të parave të ndryshueshme prej 3000 deri në 1500 euro për migrant, ka marrë dhe transportuar migrantët nga Kosova për në Serbi (në këtë pjesë të aktivitetit kriminal kryesisht kanë qenë të përfshirë Avni Hajdari, Ismet Rama, Shpejtim Ademaj, Ismail Krapo dhe Shaip Selmani) pastaj nga Serbia (për këtë pjesë të aktivitetit kriminal kryesisht ka qenë përgjegjës Joca) dhe pastaj nga Serbia për në Hungari (për këtë pjesë të aktivitetit kriminal ka qenë përgjegjës Anton Gecaj) dhe pastaj nga aty për në destinacionet e cekura më lartë.

Fatmir PAJAZITI dhe Xhemajl HALILAJ

SHPALLEN FAJTORE

për veprën penale Kontrabandimi me Migrantë në bashkëkryerje, sipas Nenit 138, paragrafi 6 dhe Nenit 23 të KPK sepse më 14 Tetor 2009, në territorin e Kosovës, duke vepruar si pjesëtarë të një grupi kriminal dhe në bashkëkryerje me njerëz ende të paidentifikuar, në një mënyrë në të cilën kanë vënë në rrezik jetën dhe sigurinë e migrantëve, janë përfshirë në kontrabandimin e migrantëve Rrahim Mirena, Valbona Mirena, Doruntina Mirena, Dafina Mirena nga Kosova për në Francë; veçanërisht Fatmir Pajaziti ka bërë marrëveshjet për

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

çmimin e kontrabandimit dhe për transportim të migrantëve përjashta Kosovës dhe ai është dashtë që të merr 8500 euro nga Xhemajl HALILAJ, i cili ka vepruar si garant për Rrahim Mirenën, pasi që migrantët të arrijnë në destinacionin e tyre përfundimtar;

Blerim ADEMAJ

SHPALLET FAJTOR

për veprën penale Kontrabandimi me Migrantë në bashkëkryerje, sipas Nenit 138, paragrafi 6 dhe Nenit 23 të KPK sepse më 14 Tetor 2009, në territorin e Kosovës, duke vepruar si pjesëtar i një grupi kriminal dhe në bashkëkryerje me Anton Gecajn, Shpejtim Ademajn dhe të tjerë, në një mënyrë në të cilën ka vënë në rrezik jetën dhe sigurinë e migrantëve, është përfshirë në kontrabandimin e migrantëve Ilir Agushi, Lendita Krasniqi, Agnesa Krasniqi, Anita Krasniqi nga Kosova për në Zvicër; veçanërisht Blerim Ademaj ka bërë marrëveshjet për çmimin e kontrabandimit, i ka vënë migrantët në kontakt me Anton Gecajn dhe është dashtë që të merrte një pjesë të parave nga çmimi i kontrabandimit (që ishte 3000 euro për Ilir Agushin dhe 10.000 Franga Zvicerane për familjen Krasniqi) pasi që migrantët të arrijnë në destinacionin e tyre përfundimtar;

PRANDAJ, të akuzuarit

DËNOHEN

Shpejtim ADEMAJ

Me 14 vite burgim dhe 200.000 euro gjobë për veprën penale Krimi i Organizuar, sipas Nenit 274, paragrafi 4 të KPK;

Me 2 vite burgim për secilin migrant të kontrabanduar për veprën penale Kontrabandimi me Migrantë në bashkëkryerje, sipas Nenit 138, paragrafi 6 dhe Nenit 23 të KPK (kontrabandimi i secilit migrant paraqet kryerjen e një vepre penale sipas Nenit 138 paragrafi 6 të KPK, prandaj i pandehuri i lartpërmendur ka kryer pesë vepra penale sipas Nenit 138, 6 të KPK);

dënimi unik, sipas Nenit 71, paragrafi 1 dhe 2, të KPK, përcaktohet të jetë 17 vite burgim dhe 200.000 euro gjobë;

gjoha duhet të paguhet brenda 3 muajve nga dita kur aktgjykimi merr formë të prerë.

Avni HAJDARI

Me 16 vite burgim dhe 250.000 euro gjobë për veprën penale Krimi i Organizuar, sipas Nenit 274, paragrafi 4 i KPK;

Me 2 vite burgim për secilin migrant të kontrabanduar për veprën penale Kontrabandimi me Migrantë në bashkëkryerje, sipas Nenit 138, paragrafi 6 dhe Nenit 23 të KPK (kontrabandimi i secilit migrant paraqet kryerjen e një vepre penale sipas Nenit 138, 6 të KPK);

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

dënimi unik, sipas Nenit 71 paragrafi 1 dhe 2 të KPK, përcaktohet të jetë 19 vite burgim dhe 250.000 euro gjobë;

gjoba duhet të paguhet brenda 3 muajve nga dita kur aktgjykimi merr formë të prerë.

Ismail KRAPI dhe Shaip SELMANI

Me 8 vite burgim secili për veprën penale Krimi i Organizuar, sipas Nenit 274, paragrafi 2 të KPK.

Fatmir PAJAZITI

Me 2 vite burgim për secilin migrant të kontrabanduar për veprën penale Kontrabandimi me Migrantë në bashkëkryerje, sipas Nenit 138, paragrafi 6 dhe Nenit 23 të KPK (kontrabandimi i secilit migrant paraqet kryerjen e një vepre penale sipas Nenit 138 paragrafi 6 të KPK, prandaj i pandehuri i lartpërmendur ka kryer pesë vepra penale sipas Nenit 138, 6 të KPK);

dënimi unik, sipas Nenit 71 paragrafi 1 dhe 2 të KPK, përcaktohet të jetë 7 vite burgim.

Xhemajl HALILAJ

Me 1 vit dhe 6 muaj burgim për secilin migrant të kontrabanduar për veprën penale Kontrabandimi me Migrantë në bashkëkryerje, sipas Nenit 138, paragrafi 6 dhe Nenit 23 të KPK (kontrabandimi i secilit migrant paraqet kryerjen e një vepre penale sipas Nenit 138 paragrafi 6 të KPK, prandaj i pandehuri i lartpërmendur ka kryer pesë vepra penale sipas Nenit 138, 6 të KPK);

dënimi unik, sipas Nenit 71 paragrafi 1 dhe 2 të KPK, përcaktohet të jetë 2 vite burgim.

Sipas Neneve 41, 42, 43 dhe 44 të KPK dënimi kundër Xhemajl HALILAJ suspendohet (shqiptohet dënimi me kusht) dhe prandaj dënimi nuk do të ekzekutohet nëse personi i dënuar nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale për një periudhë 3 vjeçare.

Blerim ADEMAJ

Me 2 vite burgim për secilin migrant të kontrabanduar për veprën penale Kontrabandimi me Migrantë në bashkëkryerje, sipas Nenit 138, paragrafi 6 dhe Nenit 23 të KPK (kontrabandimi i secilit migrant paraqet kryerjen e një vepre penale sipas Nenit 138 paragrafi 6 të KPK, prandaj i pandehuri i lartpërmendur ka kryer katër vepra penale sipas Nenit 138, 6 të KPK);

dënimi unik, sipas Nenit 71 paragrafi 1 dhe 2 të KPK, përcaktohet të jetë 5 vite burgim.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Koha e kaluar në paraburgim nga ana e Fatmir Pajazitit, Avni Hajdarit dhe Shpejtim Ademajt nga 16.12.2009 deri në kohën kur aktgjykimi merr formë të prerë do të llogaritet në dënim, sipas Nenit 391 Paragrafi (1), Nënparagrafi 5 dhe Neni 278 Para. 7 të KPPK.

Koha që e ka kaluar në paraburgim Xhemajl Halilaj nga 16.12.2009 deri më 14.09.2010 do të llogaritet në dënim, sipas Nenit 391 Paragrafi (1), Nënparagrafi 5 dhe Neni 278 Para. 7 të KPPK.

Koha e kaluar në paraburgim nga ana e Shaip Selmanit dhe Ismail Krapit nga 16.12.2009 deri më 17.12.2009 dhe nga 17.6.2011 deri në kohën kur aktgjykimi merr formë të prerë do të llogaritet në dënim, sipas Nenit 391 Paragrafi (1), Nënparagrafi 5 dhe Neni 278 Para. 7 të KPPK.

Koha e kaluar nga ana e Blerim Ademajt nën arrest shtëpiak nga 27.12.2011 deri më 16.6.2011 dhe në paraburgim prej 17.6.2011 deri në kohën kur aktgjykimi merr formë të prerë do të llogaritet në dënim, sipas Nenit 391 Paragrafi (1), Nënparagrafi 5 dhe Neni 278 Para. 7 të KPPK.

Të akuzuarit do të kompensojnë shpenzimet e procedurës penale sipas Nenit 102 Paragrafi (1) të KPPK me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit. Shpenzimet përcaktohen të jenë 70 euro për seancë për një shumë totale prej 1.330 euro, duke përfshirë shpenzimet e masave të fshehta të lëshuara gjatë hetimeve, plus 1000 euro për shpenzimet e udhëtimeve që janë bërë, respektivisht nga Gjermania dhe Sllovenia, nga ana e dëshmitarëve Avdurrhim Ademi dhe Halil Curri. Prandaj shuma totale përcaktohet të jetë 2.330 euro. Pasi që nuk është e mundur që të specifikohet se çfarë pjese të shpenzimeve do të paguaj secili i pandehur, personat e dënuar do të jenë së bashku dhe veçmas përgjegjës për shpenzimet.

ARSYETIMI

1. SFONDI PROCEDURAL

Më 29 Shtator 2010, Prokurori Special Besim Kelmendi ka ngritur aktakuzën kundër Shpejtim Ademaj, Avni Hajdari, Fatmir Pajaziti, Xhemajl Halilaj, Shaip Selmani, Ismail Krapit dhe Rabbit Ajvazi, me akuzat Krimi i Organizuar dhe Kontrabandimi me Migrantë.

Pastaj, njëri prej të pandehurve të tjerë nën hetime, Blerim Ademaj, i cili ka qenë me vendbanim në Zvicër, i është dorëzuar Autoriteteve Kosovare.

Pasi që ka intervistuar Blerim Ademajn, prokurori më 21 Janar 2011 ka ngritur aktakuzë kundër tij për akuzat e njëjta si për të pandehurit e lartpërmendur.

Aktakuza e parë është konfirmuar nga Gjykatësi për Konfirmim të Aktakuzës me aktvendimin e datës 20 Tetor 2010, përderisa aktakuza e ngritur kundër Blerim Ademaj është konfirmuar me aktvendimin e datës 28 Janar 2011 të lëshuar nga Gjykatësi për Konfirmim të Aktakuzës (i pandehuri dhe avokati i tij mbrojtës kanë hequr dorë nga e drejta për mbajtjen e seancës për konfirmim).

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Seanca e parë e shqyrtimit gjyqësor ka filluar më 20 Janar 2011 dhe është shtyrë deri më 2 Shkurt 2011, pas kërkesave të të gjitha palëve për të bashkuar dy procedurat në bazë të dy aktakuzave.

Në datën e lartcekur, dy procedurat janë bashkuar dhe, pas kryerjes së formaliteteve fillestare, ka filluar faza e provave.

Në seancat e cekura më poshtë, janë marrë në pyetje dëshmitarët dhe palët e dëmtuara si në vijim:

Më 2 Shkurt 2011, B R dhe A A;

Më 3 Shkurt 2011, SH A, B H, B M dhe B J;

Më 9 Shkurt 2011, R K;

Më 10 Shkurt 2011, SH K dhe M J;

Më 21 Shkurt 2011, I K, A A dhe Z M K;

Më 23 Shkurt 2011, I K;

Më 24 Shkurt 2011, V J;

Më 4 Mars 2011, G U dhe R Z;

Më 7 Prill 2011, H C dhe D V;

Më 14 Prill 2011, janë listuar provat materiale dhe me Avni Hajdarin ka filluar marrja në pyetje e të pandehurve;

Në seancat e cekura më poshtë janë marrë në pyetje të pandehurit si në vijim:

Më 15 Prill 2011, Shpejtim Ademaj dhe Fatmir Pajaziti;

Më 18 Prill 2011, Xhemajl Halilaj dhe Shaip Selmani;

Më 12 Maj 2011, Ismail Krapë dhe Rabbit Ajvazi;

Më 13 Maj 2011, Blerim Ademaj.

Më 24 Maj, 9 dhe 10 Qershor 2011 palët kanë prezantuar fjalët përfundimtare dhe më 17 Qershor 2011, pasi që Prokurori ka hequr dorë nga e drejta që të i përgjigjet mbrojtjes, Aktgjykimi është shpallur publikisht.

1.2. Deklaratat, raportet e policisë, raportet mjekësore, ekspertizat dhe provat në formë dokumentesh të pranuar në bazë të pajtimit të palëve

- Raportet e policisë të datës 23 Tetor 2009
- Raportet e policisë të datës 27 Tetor 2009
- Raportet e policisë të datës 31 Tetor 2009
- Raportet e policisë të datës 6 Nëntor 2009
- Raportet e policisë të datës 13 Nëntor 2009
- Raportet e policisë të datës 17 Nëntor 2009
- Raportet e policisë të datës 18 Nëntor 2009
- Raportet e policisë të datës 23 Nëntor 2009
- Raporti nga administrata tatimore i datës 6 Maj 2010
- Raiffeisen Bank i datës 15 Prill 2010
- Pro Credit bank i datës 12 Prill 2010

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

- Raporti nga NLB i datës 12 Prill 2010
- Raportet e mëtejme të datës 13 Prill 2010
- Raportet e mëtejme të datës 16 Prill 2010
- Raportet e mëtejme të datës 28 Prill 2010
- Raportet e mëtejme të datës 12 Shkurt 2010
- Raporti i përgjithshëm i policisë mbi hetimin financiar i datës 31 Maj 2010
- Raporti i përgjithshëm i policisë i datës 22 Shkurt 2010
- Raporti i mëtejme i policisë i datës 12 Mars 2010
- Raporti i policisë i datës 13 Janar 2009
- Raporti përmbledhës i datës 6 Dhjetor 2009
- Raporti mbi provat e konfiskimit të sendeve gjatë kontrollit të shtëpisë
- Raporti fillestar i informacioneve i datës 13 Nëntor 2009
- Raporti i regjistrimit të thirrjeve telefonike i datës 19 Nëntor 2009
- Raporti mbi listimin e thirrjeve telefonike i datës 2 dhe 3 Dhjetor 2009 24 Nëntor 2009
- Raporti përfundimtar me përmbledhjen e thirrjeve i datës 25 Nëntor 2009
- Raportet nga PTK me një CD që përmban regjistrimin e mesazheve SMS
- Raporti i policisë i datës 18 Nëntor 2009
- Raporti i policisë i datës 21 Tetor 2010
- Raporti i policisë i datës 21 Janar 2010
- Raporti i policisë i datës 20 Nëntor 2009
- Raporti i policisë i datës 18 Gusht 2010
- Raporti i policisë i datës 26 Nëntor 2010
- Raporti i policisë i datës 26 Gusht 2010
- Raporti i policisë i datës 2 Dhjetor 2009
- Raporti i policisë i datës 25 Nëntor 2009
- Raporti i policisë i datës 26 Gusht 2010
- Raporti i policisë i datës 4 Dhjetor 2009
- Raporti i policisë 23 Mars 2010
- Raportet e policisë 17 Nëntor 2009
- Pesë raportet e policisë të datës 16 Dhjetor 2009 mbi kontrollin e shtëpive
- Fotografitë e viktimave që janë mbytur në lumë;
- Fletëlëshimi i datës 9 Shkurt 2009 në lidhje me Shaip Selmanin
- Certifikata mjekësore e datës 27 Korrik 2007 Xhemajl Halilaj
- Certifikata mjekësore e Rabbit Ajvazit e datës 20 Gusht 2008
- Dokument mjekësor nga Ndihma mjekësore shtetërore në lidhje me Avni Hajdarin
- Deklarata me shkrim që e ka dhënë Kadrush Ajvazi
- Deklarata me shkrim që e ka dhënë Lavdi Thaqi
- Deklarata me shkrim që e ka dhënë A A

Sa i përket deklaratave që i ka dhënë M R, ato janë pranuar pa pajtimin e palëve sipas Nenit 368 para. 1 pika 1 e KPPK.¹

¹ Procesverbali i 14 Prillit 2001, faqja 4;

Kryetari i Trupit Gjyqësor: Pasi që tashmë e kemi një palë që nuk pajtohet, nuk ia vlen që të pyeten palët tjera për pajtimin e tyre. Trupi gjyqësor, pas dëgjimit të mendimeve të palëve, lëshon këtë aktvendim: deklarata e dhënë nga M R më 14 Maj 2010 dhe më 10 Nëntor 2009 sipas nenit 368 paragrafi 1 pika 1 pranohet dhe do të zëvendësojë marrjen në pyetje të dëshmitarit. Pasi që nuk ka qenë e mundur apo ka

2. RIKONSTRUKSIONI FAKTIK I NGJARJEVE DHE VLERËSIMI I PROVAVE TË PREZANTUARA.

2.1 Kalimi tragjik i lumit Tisa me barkë natën në mes 14 dhe 15 Tetorit 2009.

Natën në mes 14 dhe 15 Tetorit 2009 një grup njerëzish ishte duke e kaluar kufirin në mes Serbisë dhe Hungarisë me një varkë përmes lumit Tisza afër Suboticës (Serbi).

Mirëpo barka është përmbysur dhe njerëzit që ishin në të ranë në ujë. Kjo ngjarje, që pati një jehonë të madhe në media, është e padiskutueshme dhe nuk është kontestuar nga avokatët mbrojtës e as nga të pandehurit.

Çështja në lidhje me njerëzit të cilit ishin në barkë në atë natë fatale dhe me atë se cili ishte fati i tyre përfundimtar do të vlerësohet pas prezantimit të të gjithë episodeve të veçanta të kontrabandimit që janë cekur nga prokurori në aktakuzë.

2.2 Episodet e veçanta të kontrabandimit me migrantë.

2.2.1 Kontrabandimi i familjes së B R.

Dëshmia e B R ka sqaruar që ai dhe dy fëmijët e tij të vegjël (Erida Jaha dhe Rendi Jaha) ishin të mbijetuarit e vetëm të udhëtimit tragjik në lumin Tisa i cili ndodhi natën e 14 Tetorit 2009, përderisa partnerja e tij Elvira Jaha, e cila gjithashtu ishte në barkë, është mbytur në ujërat e lumit.²

Prandaj B R është dëshmitari i vetëm okular i cili ka mundur ta informojë gjykatën për modalitetet e udhëtimit nga Kosova deri në lumin Tisa (i cili, siç dihet, e shënon kufirin në mes të Serbisë dhe Hungarisë në rajonin e Suboticës).

qenë e vëshirë që ai të detyrohet të paraqitet përpara gjykatës. Në fakt M R duket se banon ilegalisht në Zvicër dhe nuk ka një adresë të njohur.

² Procesverbali i 2 Shkurtit 2011, faqja 19 dhe faqet 36-37:

Prokurori Publik: Kush ka qenë afër teje?

M R: Vajza ime ishte në duart e mia dhe gruaja ime dhe djali im pranë meje dhe gjithë të tjerët ishin në barkë.

Prokurori Publik: Ti ke qenë në pjesën e përparme të barkës?

M R: Po.

Prokurori Publik: Çfarë ke bërë kur keni filluar të fundoseni?

M R: Jam dorëzuar. Pastaj e kam dëgjuar gruan time duke e thirrur djalin tim dhe kjo më bëri që të kap vajzën time të cilën e kisha lëshuar. Unë jam kthyer te gruaja ime. E kam kapur djalin tim i cili kishte qenë në duart e gruas time tërë kohën, dhe i thash gruas time, "vazhdo dhe unë do të i marr fëmijët". Dhe unë kam vazhduar të notoj.

...

Kryetari i Trupit Gjyqësor: Kur e ke parë kufomën e gruas tënde?

M R: Pas dy javëve.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: Por ditën e nesërme ti je kthyer te lumi, pas ngjarjes, e ke kërkuar atë?

M R: Nuk jam i sigurt nëse ka qenë të nesërmen apo një ditë më pas.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: Dhe nuk ke mundur ta gesh?

M R: Jo.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: A ka pasur diçka në breg, një çantë apo diçka që do të mund të kishte lidhje me të?

M R: Jo asgjë, përveç çantës që kisha qenë duke e bartur, çanta e fëmijëve të mi dhe këpucët e fëmijëve që u kishin dalë nga këmbët

Kryetari i Trupit Gjyqësor: Kush të ka thirrur dhe të ka treguar që ishte gjetur kufoma e gruas tënde?

M R: Policia e Hungarisë. Unë kam identifikuar jo vetëm gruan time por edhe të tjerë.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Dëshmitari i ka shpjeguar gjykatës se si një person i cili është prezantuar si Ismajli (dhe i cili është njohur nga ana e dëshmitarit përpara gjykatës si i pandehuri Avni Hajdari³), në këmbim për shumën prej 6.300 euro, ka pranuar të organizojë udhëtimin ilegal nga Kosova për në Austri për B R, partneren e tij Elvirën dhe dy fëmijët e tyre.⁴

Shumica e të hollave për kontrabandimin është dashtë të paguhet pasi që migrantët të arrijnë në Austri.⁵

B R ka shtuar që janë bërë disa kontakte me telefon në mes të tij dhe Ismailit/Avni Hajdarit në numrin e telefonit që i përkiste këtij të dytit.⁶

Ditën e caktuar për udhëtim (faktikisht 14 Tetor 2009) B R dhe familja e tij kanë takuar Ismailin/Avni Hajdarin dhe një individ të panjohur në Emshir, në zonën e Prishtinës. Ky i dyti e çoi familjen me veturë në Gjilan ku migrantët hynë në një veturë tjetër të cilën e ngjiste një person tjetër.⁷

Pastaj udhëtimi vazhdoi:

Prokurori publik: Pasi që ju hytë në një makinë tjetër në Gjilan, ku shkuat?

B R: Tek kufiri serb.

³ Procesverbali i 2 Shkurtit 2011, faqja 22

Prokurori publik: A jua ka treguar Policia ndonjëherë juve fotografitë për të ju pyetur nëse personat që jua kanë kërkuar parat janë në ndonjërin nga ato foto?

M R: Po.

Prokurori publik: A keni njohur personin që ju ka dërguar juve jashtë Kosovës?

M R: Po.

Prokurori publik: Kur e more vesh, nëse e ke marr vesh, se emri i këtij personit nuk është Ismail?

M R: Në ditën e ...

Bajram Tmava: Kundërshtoj, pyetje sugjестive.

Kryetari i trupit gjykues: Nuk është sepse është pyetje sugjестive ngase ato lejohen. Mirëpo kjo është përtej pyetjes sugjестive. Ti duhet ta pyesësh nëse emri i vërtet i atij nuk ka qenë Ismail.

Prokurori publik: A e ke ditur që Ismaili nuk ka qenë emri i tij i vërtet?

M R: Nuk e kam ditur këtë deri kur më i kanë treguar fotot.

Kryetari i trupit gjykues: Ne mund të kërkojmë nga dëshmitari që ta njoh personin në fotografi ose nëse ai person është i pranishëm në sallën e gjykatës.

Prokurori publik: A mund ta identifikoni këtë person sot?

M R: Po.

Kryetari i trupit gjykues: A mund ta identifikoni këtë personin që ju keni kontaktuar për të dal jashtë Kosovës?

Fillimisht, dëshmitari e identifikon të pandehurin Avni Hajdarin si personin me të cilin ai ka qenë në kontakt për të dal jashtë Kosovës dhe pasi që i pandehuri u ngrit në këmbë, dëshmitari e konfirmon identitetin e tij si Avni Hajdari të cilin fillimisht dëshmitari e njihje si "Ismail".

⁴ Procesverbali i 2 Shkurtit 2011, faqja 13.

⁵ Procesverbali i 2 Shkurtit 2011, faqja 22:

Prokurori publik: Në lidhje me pagesën e 6,300 Euro, si është dashtë që ju ti paguani ato para?

Kryetari i trupit gjykues: Cila ka qenë marrëveshja me Avni Hajdarin ose "Ismailin"?

M R: Çka doni të thoni, se si do t'ia jepja parat atij? Ne u pajtuam që do t'ia jepja 600 euro gjatë rrugës ndërsa 5,700 euro pasi që unë të arrija në Austri.

Prokurori publik: A ja keni dhënë ju atij 600 euro?

M R: Po.

Prokurori publik: Kujt ja keni dhënë 600 euro?

M R: Shoferit të Pasatit të parë.

⁶ Procesverbali i 2 Shkurtit 2011, faqja 32:

Kryetari i Trupit Gjykues: Në pyetjen e Bajram Tmavës në lidhje numrin e telefonit të personit Ismailit i cili të ka kontaktuar ty, ti ke thënë që ty nuk të kujtohet numri i telefonit, në deklaratën që ia ke dhënë policisë më 29 Tetor 2009, ti ke thënë që numri i telefonit ka qenë 044 610 955, a qëndron prapa deklaratës tënde të mëparshme?

M R: Po. Atëherë kur unë e dhashë këtë numër telefoni, unë e dhashë edhe këtë numër.

⁷ Procesverbali i 2 Shkurtit 2011, faqja 14.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Prokurori publik: A keni kaluar përmes pikës kufitare të zakonshme?

B R: Po.

Prokurori publik: Si e kaluat kufirin?

B R: E kam kaluar kufirin e Kosovës së bashku me gruan dhe dy fëmijët e mi në këmbë. Dy makina na kanë marr neve në zonën në mes të dy pikave të kontrollit. Unë hyra në një makinë dhe gruaja me fëmijët e mi hynë në një makinë tjetër dhe u bëmë bashkë tek kufiri.

...

Prokurori publik: A i keni treguar dokumentet tuaj të identifikimit tek pika kufitare?

B R: Askush nuk na ka pyetur për dokumente.

Prokurori publik: Pasi që hytë në Serbi, në cilin drejtim ju shkuat?

B R: Ne shkuam në oborrin e një shtëpie, hymë pastaj në një makinë dhe shkuam me makinë tutje për 15 minuta. Pastaj hymë në një makinë tjetër dhe vazhduam për në Suboticë me atë makinë.

...

Kryetari i trupit gjykues: Cila ka qenë makina e parë e cila e dyta? Çfarë lloji i makinës ka qenë?

B R: E para ka qenë Golf 2 prej Prishtine për në Gjilan, dhe e dyta ka qenë Opel Astra prej Gjilan deri tek kufiri Serb.

Kryetari i trupit gjykues: E pasi që ju e kaluat kufirin?

B R: Unë hyra në një Pasat, ndërsa gruaja dhe fëmijët e mi në një Nissan Micra.

Prokurori publik: Pasi që shkuat dhe ti dole prej Pasati dhe familja e jote dolën prej Nissanit, ju a i ndërruat prapë makinat, çfarë makine ka qenë kjo tjetra?

B R: Ajo në të cilin jam vozitur unë ka qenë Pasat.

Prokurori publik: Ku shkuat sa ishit në këtë Pasat?

B R: Ishte në atë fshatin. Ne shkuam me makina për 15 minuta dhe u takuam me atë makinën tjetër.

...

Prokurori publik: Përafërsisht sa gjatë jeni vozitur në këtë Passat?

B R: Rreth 15 minuta.

Prokurori publik: Pastaj ju hytë në makinën tjetër, çfarë makine ka qenë kjo?

B R: Ford Sierra.

Prokurori publik: Sa gjatë jeni vozitur në këtë Ford Sierra?

B R: Tërë ditën, ndoshta 4-5 orë, nuk më kujtohet.

...

Prokurori publik: Ku keni mbërritur pas këtij segmentit të udhëtimit tuaj?

B R: Mendoj se kemi arritur në Suboticë.

Prokurori publik: Ku jeni ndalur dhe çfarë keni bërë?

B R: U ndalëm tek një fshat. Ka qenë si një kabine stacionit. Pastaj dolëm. Ai na tha që të prisnim dhe se një makinë tjetër do të vinte e të na merrte ne. Pas pak kohe, një Pasat erdhi dhe na mori.

Kryetari i trupit gjykues: Një Pasat tjetër?

B R: Po.

Prokurori publik: Ku shkuat?

B R: Ne shkuam me atë Pasat deri të një shtëpi në Suboticë.

...

Kryetari i trupit gjykues: Pse mendon se ka qenë Subotica? Çfarë ju shtyn që të mendoni se ka qenë Subotica?

B R: Unë kurrë nuk kam qenë atje mirëpo u cek se ne po shkonim për në Suboticë.

...

Prokurori publik: Sa kohë qëndruat në atë shtëpi?

B R: Ne qëndruam aty deri në orët e vona.

Prokurori publik: Deri kur, çfarë doni të thoni me orët e vona?

B R: Nuk e di saktësisht, ka qenë ora 9 ose 11 kur ne kemi dal prej shtëpisë.

Prokurori publik: A keni dal që të gjithë prej shtëpisë?

B R: Me duhet ta ceku se pas meje ka ardhur një familje nga Vushtrria. Të gjithë hymë në një kamionetë.

Prokurori publik: Sa gjatë keni udhëtuar në atë kamionetë?

B R: Rreth gjysme ore.

Prokurori publik: Pastaj çfarë ndodhi?

B R: Ne shkuam afër një mali, hymë në mal dhe një xhip po priste aty dhe që të gjithë hymë në atë xhip.

Prokurori publik: Sa gjatë keni udhëtuar në xhip?

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

B R: Rreth gjysme ore.

Prokurori publik: Çfarë ndodhi pasi që xhipi u ndal?

B R: Dolëm jashtë në një mal tjetër, dhe filluam që të ecim në këtë mal.

Prokurori publik: Dolët nga xhipi dhe filluat të ecni?

B R: Po.

...

B R: Kemi ecur rreth 10-15 minuta.

Prokurori publik: Ku keni arritur?

B R: Ne arritëm tek lumi. Kur e pashë se çfarë po ndodhte isha i fundit në rresht. E kisha vajzën time në duar dhe vetëm pashë që të gjithë kishin hipur në një barkë. Ne lundruam me atë barkë rreth 10-15 minuta.

...

Prokurori publik: Si e ke vërejtur që varka po fundosej?

B R: Ne ramë në ujë. Unë isha i pari që rashë në ujë.⁸

Një vërtetim i fortë i besueshmërisë së tregimit të dëshmitarit paraqitet me këmbimin vijues të mesazheve tekstuale që u bë në mes të B R (duke përdorur telefonin e tij mobil me numrin 044 264 655) dhe një shoku (apo të afërmi) të tij që përdorte një kartelë telefonike Gjermane, më 13.10.2009 dhe 14.10.2009 (tekst mesazhi është regjistruar nëpërmes urdhrit për regjistrim të lëshuar nga prokurori).

Në fakt, më 13.10.2009, në ora 12.51 B R i dërgoi personit që përdorte numrin +4915204556457 tekstin në vijim: *“Unë sapo fola me të dhe ai më tha që derisa Kroati të i thotë atij që të i nisë ata unë nuk do të të nisi ty dhe ai ka thënë ndoshta këto dy ditë do të ndodh, ai ka thënë që ai mund të më nisë menjëherë por pastaj unë do të duhet të qëndroj në Suboticë”*.

Ditën e njëjtë, në ora 21.20, B i ka dërguar personit të njëjtë një tekst tjetër: *“Ne do të nisemi nesër në 5 por Sinani duhet të mi jep 600 e dhe 5700 të ja lë Tafës”* dhe një tjetër në ora 22.18: *“Kroatët i kanë thënë atij që nesër deri në muzg ne duhet të jemi në Suboticë 044 610 955 emri i tij është Ismail”*.

Dhe në fund më 14.10.2009 ai e ka dërguar tekstin në vijim: *“Ne kemi hy në Preshevë pa asnjë problem”*.

Një vërtetim i mëtejshëm i versionit të B R jepet nga dhjetë thirrjet telefonike të shkëmbyera me Avni Hajdarin në ditët e tragjedisë (13 dhe 14 Tetor 2009) siç rezulton nga regjistrimet në lidhje me numrin e përdorur nga ana e palës së dëmtuar (shih raportin e policisë të datës 21.01.2010).

Besueshmëria e tregimit të B R (dhe të njohjes së të pandehurit që e bëri ai) përforcohet me deklaratat e V J dhe M J, respektivisht babai dhe motra e të ndjerës Elvira Jaha.

V J ka deklaruar përpara gjykatës që, dy ditë pas tragjedisë, ai ka arritur të flas me dhëndrin e tij B R i cili i ka thënë si në vijim:

Prokurori Publik: Çfarë të ka thënë ty dhëndri yt?

V J: Ai më ka thënë, “Nuk e di se çfarë ka ndodhur; ne kemi rënë në ujë. Unë arrita ta shpëtoj vetën dhe fëmijët. Nuk e di çfarë ndodhi me gruan time, nuk e di nëse ajo shpëtoi”.

Prokurori Publik: Gjatë kësaj bisede që e ke pasur me dhëndrin, a të ka treguar ai se kush ishin personat të cilët i kanë çuar te ai vend?

V J: Po, i kam pyetur atë se kush ishin ata, dhe ai më ka thënë që ai ka mbajtur kontakt me Smajl Kacanollin.

⁸ Procesverbali i 2 Shkurtit 2011, faqet 15-19.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Prokurori Publik: A mund të shpjegosh se çfarë dëshirosh të thuash me kontakt me Smajl Kacanollin?

V J: Do të thotë biseda dhe udhëtimi – ai ka qenë personi i cili e ka organizuar udhëtimin, e ka menaxhuar tërë udhëtimin dhe ka udhëtuar me ta.⁹

V J ka deklaruar që, pas varrimit të bijës së tij, ai ka pasur një takim me personin për të cilin ai ka menduar që quhet Smajl Kacanolli; në atë rast Veseli ka thënë që ai e ka konsideruar Smajlin përgjegjës dhe ky i dyti ka pranuar që ai e kishte organizuar udhëtimin përjashta Kosovës për B R dhe familjen e tij.¹⁰

Pastaj Smajl Kacanolli/Avni Hajdari ka tentuar që të siguroj falje nga Veseli duke dërguar ndërmjetësues sipas traditave Shqiptare¹¹.

V J ka identifikuar përpara trupit gjykues, me siguri absolute, të pandehurin Avni Hajdari si personin për të cilin, kur ka ndodhur takimi i lartcekur, ai ka menduar që ishte Smajl Kacanolli.¹²

Në fund, gjithashtu dëshmia e M J, edhe pse ajo vetëm i ka raportuar rrethanat dhe emrat që i kanë dëgjuar babai dhe dhëndri i saj, ofron konfirmim të mëtejshëm, sa i përket besueshmërisë, për versionin e ngjarjeve të paraqitur nga B R (në veçanti sa i përket modaliteteve të udhëtimit përjashta Kosovës dhe përfshirjes së personit që e thërriste veten Smajl)¹³ dhe nga ana e babait të saj Veselit.¹⁴

Në anën tjetër, me qëllim që të neutralizojë provat konsekuente të prezantuara nga prokurori, mbrojtja ka ofruar vetëm deklaratën e dhënë nga ana e dëshmitarit. Në veçanti, Hajdari ka pohuar që ai thjeshtë i kishte dhënë B R, pas shumë kërkesave të përsëritura, numrin e telefonit të një personi në Gjilan i cili do të mund të i ndihmonte atij që të largohet nga Kosova. Përveç kësaj, ai fare nuk ka qenë i përfshirë në udhëtim.

⁹ Procesverbali i 24 Shkurtit 2011, faqja 4.

¹⁰ Procesverbali i 24 Shkurtit 2011, faqja 7.

¹¹ Procesverbali i 24 Shkurtit 2011, faqja 8:

Prokurori Publik: A ka kërkuar ai falje nga ti?

Vesel Jaha: Po, sipas traditave tona.

Prokurori Publik: A mund të i shpjegosh të lutem Trupit Gjykues se për çfarë e ke fjalën kur thua "në bazë të traditave tona"?

Vesel Jaha: Ai ka dërguar njerëz te unë dhe ai ka kërkuar falje nëpërmes njerëzve të cilët ai i ka dërguar.

Kryetari i Trupit Gjykues: Njerëz? E ke fjalën për të afërmit e tij?

Vesel Jaha: Jo ai ka dërguar njerëz reputacioni i të cilëve në rrethin tonë është që janë njerëz me njëfarë autoriteti dhe rëndësie.

¹² Procesverbali i 24 Shkurtit 2011, faqja 6.

¹³ Procesverbali i 10 Shkurtit 2011 faqet 12-13:

Prokurori Publik: A të ka treguar Blerimi ty se kush i kishte marrë këta njerëz për të i dërguar në atë drejtim?

Mimoza Jaha: Pas këtyre fjalëve që ai më i ka thënë, që ai është ndarë nga gruaja e tij dhe që ajo ka hipur në barkë, ai ka thënë që ai nuk është lejuar të flas më dhe e ka ndalë telefonin. Babai i Blerimit na ka thirrur dhe na ka dhënë neve dy emra, Smajl Kacanolli dhe një emër tjetër Zeqa. Ai na ka dhënë dy numra të telefonit dhe ne e kemi thirrur Smajlin. Kur e kemi thirrur ai ka thënë që ai nuk është Smajli dhe që ne e kemi numrin e telefonit gabim. Pastaj ne e kemi thirrur Zeqën dhe ai na ka thënë që dikush nga Vushtrria ka shkaktuar probleme dhe që ata janë kapur.

...

Mimoza Jaha: Blerimi ka thënë që nga fillimi ai është dashitë të shkoj me Smajl Kacanollin dhe Smajli i ka thënë atij që ju nuk do të kaloni ndonjë ujë. Blerimi ka thënë që "Smajli më ka gënjer mua dhe unë tani po tregoj sepse nuk kam mundur ta tregoj këtë më parë që ata na kanë lënë neve në ujë dhe unë nuk e di ku e kam gruan."

¹⁴ Procesverbali i 10 Shkurtit 2011, faqja 14:

Prokurori Publik: A ka treguar ty babai yt se për çfarë ka biseduar me Smajlin?

Mimoza Jaha: Ai ka thënë që pasi që ne kemi folur që ai i ka thënë atij që nëse vajza ime është mbytur, ti duhet të jesh i vetëdijshëm që më ke borbxh "një gjak". Ai ka thënë që ajo nuk është vvarë por që ajo është kapur. Pas këtyre fjalëve Smajli ka rënë në tokë.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

I pyetur nëse mund të ekzistojë ndonjë arsye pse B R do të ngrinte akuza të tilla të rrejshme kundër tij, ai nuk ka qenë në gjendje që të jepte ndonjë shpjegim.
I pandehuri gjithashtu ka mohuar të ketë përdorur numrin e telefonit 044 610 955.

Megjithatë, vetë mohimi i çfarëdo përfshirjeje që e bën i pandehuri nuk mund të neutralizojë dëshminë solide dhe të fortë të B R, e cila më tej forcohet me elementet vërtetuese si më lart.

Për më tepër, besueshmëria e të pandehurit fuqimisht dobësohet me faktin që ai ka mohuar të ketë njohur të pandehurit tjerë Shpejtim Ademajn dhe Shaip Selmanin,¹⁵ përderisa ai ka pasur disa kontakte telefonike me ta (shih në pikën e pjesës së arsyetimit në lidhje me masat e fshehta).

Mënyra e vetme për të hedh dëshmitë e lartcekura do të ishte që ato të konsiderohen si rezultat i një trillimi gjigant kundër të pandehurit. Megjithatë i paqartë dhe i pashpjegueshëm mbetet jo vetëm qëllimi i një trillimi të tillë, por gjithashtu nuk është paraqitur asnjë rrethanë e vetme gjatë tërë shqyrtimit gjyqësor që do të sugjeronte një gjë të tillë.

Në përfundim, pas vlerësimit të provave të lartcekura, përgjegjësia e të pandehurit Avni Hajdari sa i përket kontrabandimit të B R, Elvira Jahës dhe fëmijëve të tyre Erida dhe Rendi duket evidente dhe e pamohueshme.

2.2.2. Kontrabandimi i familjes Ademi.

Rrethanat e udhëtimit përjashta Kosovës të ndërmarrë nga Florim Ademi, gruaja e tij Elfete Ademi dhe fëmijët e tyre Albert dhe Florian Ademi janë sqaruar me dëshmitë e B J t, B H dhe A A.

Dëshmitari B J ka deklaruar që kushëriri i tij Florini është marrë vesh me një person me emrin Ismet për çmimin që do ta paguante Florimi për udhëtimin ilegal të familjes së tij nga Kosova për në Austri.¹⁶

¹⁵ Procesverbali i 14 Prillit 2011, faqja 22.

¹⁶ Procesverbali i 3 Shkurtit 2011, faqja 39:

B J: Unë kam qenë aty me kushëririn tim. Ai e ka thirrur Ismetin për të folur për të shkuar në një shtet tjetër dhe ai ka premtuar.

Prokurori Publik: Kushëriri yt Florin Ademi?

B J: Po. Ata janë pajtuar që destinacioni do të jetë Austria. Nga ajo që më kujtohet, ata është dashtë të shkojnë në Vjenë dhe ka qenë një qytet tjetër, tani nuk më kujtohet cili. Ismeti i ka thënë atij, "Unë gjithashtu e kam dërguar djalin tim rrugës së njëjtë dhe unë do ta siguroj të njëjtën gjë për ty. Unë nuk do të të jap asnjë garanci: nëse të kapin në Serbi mos kërko ndihmë nga unë. Nëse të kapin në Hungari mund të kërkos azil. Nuk do të humbasësh asgjë. Të hollat do të paguhen pasi që të arrish në Vjenë."

Prokurori Publik: A të kujtohet data kur Florimi dhe të tjerët janë nisur?

B J: Gjithmonë mendoj 14 Tetor 2009 nëse nuk e kam harruar datën.

Prokurori Publik: Ti ke përmendur marrëveshjen. A u përmend diçka për çmimin?

B J: Çmimi ka qenë 7,000. Në fund, ata janë marrë vesh për 6,900. Ai i ka heq 100 Euro nga 7,000 sepse ai e ka pasur një fëmijë të vogël.

Prokurori Publik: A e di se si duhej të jepeshin këto të holla?

B J: Marrëveshja ka qenë në mes Florimit dhe të tjerëve që kanë qenë këtu por Ismeti ka thënë, "Unë do të të jap të hollat kur ti të arrish atje". Është arritur të Martën dhe ai ka thënë, "Ti do të nisësh të Enjten". Kur ata nuk kanë mundur të nisen, ai ka premtuar që do të nisen të Dielën gjë që gjithashtu nuk ka ndodhur prandaj ai është nisur pas rreth një muaji pas arritjes së marrëveshjes.

Prokurori Publik: A janë marrë vesh ata për kohën kur do të paguëshin të hollat?

B J: Marrëveshja ka qenë që të hollat të paguhen kur ata arrijnë në Vjenë dhe është dashtë që ti jepen Ismetit. Florimi ka thënë që ai do ta zgjidhte këtë nëpërmes Ismetit por unë e di që marrëveshja ka qenë që Ismeti të i merr të hollat.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Më 14 Tetor 2009 B J ka shoqëruar Florim Ademin dhe familjen e tij në takimin që ata e kanë pasur me Ismetin dhe një individ tjetër me qëllim që të largohen nga Kosova dhe, në atë rast, dëshmitari ka dëgjuar rastësisht që ky individ tjetër quhej Qaka.¹⁷

Dëshmitari ka qenë në gjendje që të njohë përpara gjykatës të pandehurin Avni Hajdari si personin me nofkën Qaka, të cilin ai e ka parë së bashku me Ismetin për rreth 15-20 minuta ditën kur familja Ademi është nisur në udhëtimin total.¹⁸

Ia vlen të ceket që B R, i vetmi i mbijetuar i rritur i udhëtimit tragjik me barkë, i ka parë anëtarët e familjes Ademi duke arritur në shtëpi në Suboticë në ditën fatale dhe pastaj ai i ka

¹⁷ Procesverbali i 3 Shkurtit 2011, faqet 39-41:

B J: Atë ditë në mëngjes, Florimi më ka thirrur dhe më ka thënë, "Unë planifikoj të udhëtoj sot, nëse dëshiron me ardhë me më përshëndetë dhe me i marrë çelësat e shtëpisë pasi që do të mbetet e zbrazët dhe me i marrë disa obligime në lidhje me shtëpinë", dhe aty ata e kanë filluar udhëtimin në drejtim të rrugës kryesore Prishtinë-Mitrovicë. Ai ka shkuar në rrugën kryesore. Sa më kujtohet, ai ka thënë "më duhet të të çoj me met dhe voziti shpejtë për në Milloshevë", dhe deri në atë lokacion unë kam qenë me ata.

Prokurori Publik: A keni udhëtuar nga Vushtrria për në Milloshevë në një veturë apo dy?

B J: Në një veturë.

Prokurori Publik: Kush e ka vozitur atë veturë?

B J: Ismeti.

Prokurori Publik: Në cilën ulëse ke qenë i ulur në veturë?

B J: Florimi ka qenë i ulur me një fëmijë përpara dhe unë kam qenë i ulur prapa me gruan e tij.

Prokurori Publik: Vendi të cilin e çuan Milloshevë, ku ka qenë?

B J: Në rrugën nga Mitrovica për në Prishtinë, aty është një pompë benzine. Ne jemi ndalur aty. Dy veturat tjera kanë ardhur aty. Ismeti u takua me një person tjetër, vetura tjetër e ka marrë kushëririn tim dhe gruan e tij dhe dy fëmijët.

Prokurori Publik: Çfarë veture ishte kjo?

B J: Ishte Golf 2.

Prokurori Publik: Kush ka mbetur në Milloshevë?

B J: Ismeti u takuar me një person atje të cilin unë e kam identifikuar në fotografi. Unë nuk di asgjë për bisedën në mes të tij dhe Ismetit.

Prokurori Publik: Sa gjatë keni qëndruar atje bashkë?

B J: 10-15 minuta.

...

Prokurori Publik: Ti e ke identifikuar personin që ka ndenjor me juve. Kur ka ndodhur kjo?

B J: Ka qenë më pas. Nuk e di kurrë.

Prokurori Publik: Për çfarë e ke fjalën kur thua më pas?

B J: Një apo dy javë pasi që e kam dhënë deklaratën. Nuk më kujtohet saktë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ty të janë treguar fotografitë në deklaratë, të dytën që e ke dhënë?

B J: Po.

Prokurori Publik: A të kujtohet emri i personit i cili ka qenë me Ismetin?

B J: Nuk më kujtohet emri i tij. Ai ka pasur një nofkë. Ismeti e ka përdorur atë kur e ka thirrur por nuk më kujtohet. Ka qenë Qaka sa e kam dëgjuar në telefon.

Kryetari i Trupit Gjykses: Nuk të kujtohet apo nuk e di emrin e tij?

B J: Nuk e di dhe nuk më kujtohet. Ne nuk kemi pasur asgjë të bëjmë me të. Kushëriri im nuk ka pasur asnjë marrëveshje me të por ai e ka pasur me Ismetin.

¹⁸ Procesverbali i 3 Shkurtit 2011, faqet 47-48:

Kryetari i Trupit Gjykses: Z. B J, a mund të shohësh nëse në gjykatore është prezent personi me nofkën Qaka?

Dëshmitari kthehet dhe shikon përreth gjykatores.

B J. Ai në mes në bazë të fotografive.

Dëshmitari B J e identifikon Avni Hajdarin.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ti ke thënë që e ke parë atë një herë për 15 apo 20 minuta.

B J: Ashtu është.

Kryetari i Trupit Gjykses: A është ky personi me nofkën Qaka, të cilin e ke parë me Ismetin?

B J: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: A mund të ngrihet Avni Hajdari?

Avni Hajdari ngrihet.

B J: Ky është personi të cilin e kam identifikuar në fotografi.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pyetja ime është ndryshe, dëshiroj të di nëse personi të cilin e treguat, ai të cilin e treguat me gisht në gjykatore, është personi të cilin e ke parë me Ismetin dhe i cili e kishte nofkën Qaka.

B J: Po, saktë.

Kryetari i Trupit Gjykses: A je i sigurt për këtë? Po ose jo?

B J: Nuk kam qenë tërësisht i sigurt në kohën kur e kam dhënë deklaratën por në mendjen time ishte ky person.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

njohur ata kur autoritetet Hungareze, pak kohë pasi që kishte ndodhur tragjedia, ia ka treguar atij fotografitë e kufomave të tyre.¹⁹

Marrëveshja me Ismet Ramën sa i përket kontrabandimit dhe rrethanave të udhëtimit gjithashtu konfirmohet me dëshminë e Avduraim Ademit, babai i të ndjerit Florim Ademi, i cili shtoi që djali i tij e thirri nga Subotica duke e pyetur nëse, pasi që ai të arrijë në Suboticë, babai i tij do të shkonte atje për ta marrë.²⁰

Ekzistimi i marrëveshjes në mes të Florim Ademit dhe Ismet Ramës për të kontrabanduar familjen e të parit jashtë Kosovës konfirmohet nga dëshmia e B H²¹ i cili po ashtu kreu identifikimin nëpërmjet fotografisë së Ismet Ramës.²²

Për të barazpeshuar provat e prezantuara nga prokurori, mbrojtja ofroi vetëm deklaratën e dhënë nga i pandehuri. Në veçanti, Hajdari afirmoi se nuk kishte gjë të bënte me familjen Ademi dhe se nuk dinte gjë lidhur me udhëtimin e tyre jashtë Kosovës.

¹⁹ Procesverbal i 2 Shkurtit 2011, faqet 34-36:

Kryetari i trupit gjykues: A ju kujtohet a kishte ndonjë familje specifike në këtë shtëpi?

M R: Po.

Kryetari i trupit gjykues: Rahime Mirena gruaja e tij dhe tri vajzat ?

M R: Po dhe të tjerët.

Kryetari i trupit gjykues: Një familje nga Vushtrria?

M R: Ajo ishte familja e fundit që kishte arritur atje, nëna, babi dhe dy djemtë.

Kryetari i trupit gjykues: Pastaj sa veta hipnin në kamionetë, të gjithë personat nga shtëpia?

M R: 18 prej nesh dhe shoferi i 19-ti.

...

Kryetari i trupit gjykues: Kush ju thirri dhe lajmëroj se ishte gjetur kufoma e gruas tuaj?

M R: Policia Hungareze, unë e identifikova jo vetëm gruan time por edhe të tjerët.

Kryetari i trupit gjykues: A ju ishin treguar foto, më vjen keq, e di që është e rëndë por më duhet të pyes edhe për trupat e tjerë.

M R: Foto.

Kryetari i trupit gjykues: Foton e gruas, nuk e keni parë kufomën e saj?

M R: Më është treguar vetëm fotoja, e pashë kufomën e saj vetëm kur ajo ishte kthyer në Kosovë.

Dëshmitarit i tregohen fotot që gjendeshin në Dosjen numër 8 të dosjes së lëndës, disa nga fotot paraqisnin trupat e vdekur të personave, disa të tjera janë foto të personave derisa ishin gjallë.

Kryetari i trupit gjykues: E di se është e dhembshme por a mund t'i thoni trupit gjykues nëse këto janë fotot që ju ishin treguar kur ishit intervistuar në Kosovë dhe nëse fotot e njëjta ju ishin treguar kur ishit intervistuar nga autoritet Hungareze?

M R: Po.

Kryetari i trupit gjykues: E di se nuk është e këndshme. E di.

M R: I pashë tre nga trupat dhe atë të gruas sime. Nuk i kam parë të tjerët.

Kryetari i trupit gjykues: Sepse në deklaratën e dhënë për policinë thuhet se juve u janë treguar foto të familjes Ademi, a janë këto fotot për të cilat po flisni?

M R: Po.

Kryetari i trupit gjykues: Dhe ishin 4 persona, babai, nëna dhe dy fëmijë?

M R: Po.

²⁰ Procesverbal i 20 Shkurtit 2011.

²¹ Procesverbal i datës 3 shkurt 2011, faqe 21:

Prokurori Publik: Përmendët Ismetin. Kush është Ismeti?

B H: E njoh si fytyrë. Është nga Mitrovica. Nuk di asgjë më shumë për të.

Prokurori Publik: Ju thatë se e takuat ditën që u lidh marrëveshja.

B H: Po, isha aty atë ditë, siç edhe thashë në deklaratë.

Prokurori Publik: Ju thatë marrëveshje. Për çfarë marrëveshje është fjala?

B H: Për ta dërguar jashtë.

Prokurori Publik: Ku është mbajtur ky takim dhe ku është lidhur kjo marrëveshje?

B H: Në një ëmbëltore në lagjen time Tafnik.

Prokurori Publik: Për çka biseduan Florimi dhe Ismeti?

B H: Biseduan për çështjen për të dalur jashtë. Ai tha, "unë mund të të dërgoj, por nuk mund të garantoj se a do të ia dalësh apo jo." Kërroi 7000 Euro nga personi dhe u pajtuan për shumën 6500 Euro dhe të hollat të paguhen pasi që të arrin. Ai e pyeti për mënyrën se si do të ikte dhe tha, "a do të më duhet të eci gjatë?" ai tha, "jo më shumë se dy deri në tre orë."

²² Procesverbal i datës 3 shkurt 2011, faqe 24 – 25.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Sërish, mohimi i përfshirjes, konfirmuar nga i pandehuri nuk mund të rrëzojë dëshminë e fortë dhe solide të B Jt, i cili qartazi identifikoi Hajdarin si personin e quajtur "Qaka" të cilit i dorëzoi familjen Ademi për të filluar udhëtimin e tyre tragjik jashtë Kosovës.

Përpos kësaj, për arsyet e cekura më lart, besueshmëria e përgjithshme e të pandehurit është tejet e dobët.

Prandaj, përgjegjësia e të pandehurit Avni Hajdari (dhe ajo e Ismet Ramës) sa i përket kontrabandimit të katër anëtarëve të familjes Ademi duket evidente dhe e pamohueshme.

2.2.1. Kontrabandimi i Ilir Agushit.

Rrethanat e udhëtimit jashtë Kosovës ndërmarrë nga i ndjeri Ilir Agushi janë qartësuar nga dëshmitë e A dhe SH A t, pra babait dhe vëllait së viktimit. Këto janë qartësuar edhe nga deklaratat e dhënë nga Blerim Ademaj.

A A deklaroi se mori numrin e telefonit të Shpejtim Ademaj nëpërmjet Rabbit Ajvazit, për të cilin e dinte se ia doli të dërgojë të motrën nëpërmjet Shpejtim Ademajt.²³

Dëshmitari po ashtu deklaroi se ka biseduar për udhëtimin në fjalë me të birin SH A, i cili punonte dhe jetonte në Zvicër, dhe se ky i fundit e kishte informuar për çmimin e udhëtimit (3000 Euro). Thënë më shkurt, 500 Euro duhet paguar në Zvicër Blerimit, vëllait të Shpejtim dhe 2.500 Euro në Kosovë Shpejtim Ademajt direkt, pasi që Iliri të arrinte në Zvicër²⁴ (në një pjesë të dëshmisë, dëshmitari u konfuzua dhe tha se 2.500 Euro është dashur t'i jepen Shpejtim në Kosovë dhe 500 Euro Shpejtim në Zvicër²⁵: Është e qartë se mendoi se pjesa që duhej paguar në Zvicër nga Sh duhej dhënë dikujt që punonte për Shpejtimin, pasi që nuk hedhet poshtë se ky i fundit gjendej në Kosovë. Shihet qartë se personi që kujdesej për interesat e Shpejtim Ademajt dhe Anton Gecajt në Zvicër ishte Blerim Ademaj).

A A shtoi se kishte shoqëruar të birin Ilirin për në takimin me Shpejtim Ademajn për udhëtimin e tij fatal jashtë Kosovës.²⁶ Së fundi, para Trupit Gjykses dëshmitari ka njohur me siguri të plotë të pandehurin Shpejtim Ademaj si personi të cilit i ka dorëzuar të birin.²⁷

²³ Procesverbal i datës 2 shkurt 2011, faqe 42.

²⁴ Procesverbal i datës 2 shkurt 2011, faqe 60:

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju shtuat se i biri juaj Shkelzeni vuri kontakt me të vëllanë e Shpejtim dhe u pajtuan se 500 euro t'i jepen vëllait të Shpejtimit?

A A: Po, siç thashë, Shpejtim, të vëllait të tij, njëjtë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Se shuma 2.500 Euro është dashur t'i jepen Shpejtim kur i biri të arrijë në Zvicër? A është e vërtetë?

A A: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Të hollat është dashur t'i jepen direkt Shpejtimit?

A A: Po.

²⁵ Procesverbal i datës 2 shkurt 2011, faqe 56:

A A: Shkelzeni ka pasur t'i jep 500 Euro Shpejtimit pasi që të arrin djali në Zvicër.

Kryetari i Trupit Gjykses: Po të holla të tjerë për t'u dhënë të tjerëve?

A A: Pasi që të arrin djali në Zvicër, Shkelzeni kishte për t'i dhënë Shpejtimit 500 Euro dhe kur të pranoja unë telefonatën se ka arritur aty, t'i jepja Shpejtimit 2,500 Euro.

Kryetari i Trupit Gjykses: Nëpërmjet dikujt apo direkt Shpejtimit?

A A: Direkt Shpejtimit.

²⁶ Procesverbal i datës 2 shkurt 2011, faqe 43:

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Gjatë shqyrtimit kryesor, avokati mbrojtës i Shpejtim Ademajt ka prezantuar një deklaratë, të dhënë në zyrë të një avokati, me shkronja shtypi me nënshkrimin e A A t si dhe vulën e personit zyrtar që vërteton identitetin e nënshkruesit.

Deklarata që është dorëzuar, e shkruar dhe e nëshkruar, me kërkesën që të konsiderohet provë e pranueshme, përmend se A asnjëherë nuk ka parë Blerimin dhe Shpejtim Ademajn dhe asnjëherë nuk u ka dhënë të holla për kontrabandim të migrantëve.

Është e qartë se kur dëshmitari nënshkroi deklaratën e përmendur, nuk e kishte kuptuar se çfarë përmbante ajo ngase nga procesverbali i marrjes së tij në pyetje, është e qartë se kjo e fundit është në kundërshtim të plotë me përmbajtjen e deklaratës së përmendur. Duket qartë se duke qenë i shtyrë në moshë, dëshmitari ka keqkuptuar se çfarë ka qenë e shkruar në deklaratën që nënshkroi:

Dëshmitari A A lexon deklaratën

A A: Vëllai i Shpejtimit erdhi në Gjilan, ai më thirri në telefon dhe më pyeti 'a mund të vij dhe të të shpreh ngushëllimet e mia për të birin tënd?' unë i thashë jo. Ai thirri 3-4 herë.

Kryetari i Trupit Gjykues : Si është emri i vëllait?

A A: Nuk e di, do ta njihja nëse e shoh.

Haxhi Millaku: A është në këtë sallë të gjyqimit?

Kryetari i Trupit Gjykues : Ta qartësojmë këtë njëherë.

A A: Unë shkova në Gjilan, kam pirë një kafe me të dhe i thashë 'shoku im, të birin tim ia dorëzova vëllait tënd, tani e kërkoj të birin nga ai.' Ai vazhdimisht thoshte Anton, Anton, nuk i di mbiemrin, kishim këtë bisedë.

Kryetari i Trupit Gjykues : dhe pastaj?

A A: Pastaj asgjë.

Kryetari i Trupit Gjykues : Kujt i keni dhënë këtë deklaratë?

A A: Në zyrë të avokatit.

Kryetari i Trupit Gjykues : E keni dhënë këtë deklaratë në zyrë të avokatit?

A A: Po.

Kryetari i Trupit Gjykues : Pastaj e keni nënshkruar para dikujt që punon në gjykatën komunale në Gjilan?

A A: Po.

Kryetari i Trupit Gjykues : Dhe është e vërtetë se asnjëherë nuk keni parë Shpejtim Ademajn?

A A: Kurrë nuk e kam parë Shpejtim Ademajn, e kam parë kur e vura të birin në veturën e tij.

Kryetari i Trupit Gjykues : Pra, në fund e keni parë?

A A: Po.

Kryetari i Trupit Gjykues : sepse në këtë deklaratë ju thoni se asnjëherë nuk keni parë Shpejtim Ademajn.

A A: Po, dhe akoma ashtu them.

Kryetari i Trupit Gjykues : Morrët të birin dhe patë Shpejtim Ademajn?

A A: Po.

Kryetari i Trupit Gjykues : Si thoni pra se asnjëherë nuk e keni parë?

A A: E pashë kur vura të birin tim në veturën e tij dhe jo më parë.

Kryetari i Trupit Gjykues : Pra, e keni parë kur vendosët të birin në veturë?

A A: Kur vdiq i biri im, i vëllai i tij erdh për të shprehur ngushëllimet.

Kryetari i Trupit Gjykues : A e keni parë Shpejtim Ademajn për herë të parë kur e dërguat të birin e juaj në veturën e tij

A A: Në 08:55 e dërgova te shkolla dhe e hipa në veturën e Shpejtimit. Shpejtimi më pyeti se a i ka 300 Euro për ushqim dhe gjëra dhe unë i thashë se po. Ai thotë ta merrja telefonin dhe rrobat, dikush ishte ulur në pjesën e përparme të veturës, Shpejtimi tha: "largohu nga ulësja se do ta dërgoj te i vëllai në Zvicër, këtë ta premtoj".

²⁷ Procesverbal i datës 2 shkurt 2011, faqe 57-58.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

A A: Po.²⁸

Një indikacion tjetër për pabesueshmërisë e deklaratës me shkrim është se dëshmia e dhënë nga dëshmitari para Trupit Gjykses është absolutisht konsistente me versionin e dhënë në polici gjatë hetimeve.

Versioni i A A konfirmohet nga dëshmia e dhënë nga i biri i tij SH A.

Ky i fundit ka raportuar se kishte pasur një takim në Zvicër me vëllanë e Rabit Ajvazit, Kadrush Ajvazin, i cili i kishte thënë se kishte dërguar anëtarët e tij të familjes në Zvicër nëpërmjet Anton Gecajt dhe i kishte dhënë numrin e telefonit të të pandehurit Blerim Ademaj.²⁹

Më pastaj, dëshmitari mbajti më shumë se një takim në Zvicër me Blerimin dhe Kadrushin. Në këto takime u diskutuan detajet e udhëtimit dhe përfundimisht u caktua dita e nisjes së Ilir Agushit.³⁰

Ç'është e vërteta, Iliri është nisur në ditën e caktuar dhe informoi të vëllanë Sh nëpërmjet telefonit se është vozitur nga Shpejtimi në parkingun e taksisë në Gjilan. Nga kjo nisje nga Gjilani, Iliri sërish thirri të vëllanë dhe i tha si në vijim: "ky Antoni është përgjegjës dhe ai do të vijë së shpejti dhe do të na marrë."³¹

²⁸ Procesverbal i datës 2 shkurt 2011, faqe 48-50.

²⁹ Procesverbal i datës 3 shkurt 2011, faqe 4.

³⁰ Minutes of 3 February 2011, pages 5-6:

Prokurori Publik: Ju caktuat takimin. Në cilin vend?

SH A: U takuam në Geneva.

Prokurori Publik: Në cilin vend?

SH A: "Paki."

Prokurori Publik: A u mbajt ky takim në rrugë apo në kafene?

SH A: Në kafene.

Prokurori Publik: Çfarë diskutuat në atë takim?

SH A: Biseduam që t'i sjellnim atje.

Prokurori Publik: Kënd ta sjellni?

SH A: Ilirin.

Prokurori Publik: A mund të na tregoni diçka më shumë? Na jepni detale për diskutimin e juaj.

SH A: Unë vetëm e kam diskutuar se si të sjellet në Zvicër.

Prokurori Publik: Çfarë ju thanë, Kadrushi apo Blerimi?

SH A: Kadrushi apo Blerimi? Kadrushi më tha, "Unë e kam sjellë familjen në Austri nëpërmjet Antonit."

Kryetari i Trupit Gjykses : Si është mbiemri I Antonit?

SH A: Nuk e di. Këto gjëra I kam shkruar diku por nuk më kujtohet.

Prokurori Publik: A ju tha gjë tjetër Kadrushi?

SH A: Kadrushi më tha se është rrugë e gjatë dhe e vështirë, unë e kam sjellur familjen time aty. Kadrushi më tha mos e bëj gabimin që ta lësh se nuk është lehtë.

Prokurori Publik: Çfarë ju tha Blerimi?

SH A: Blerimi më tha, "Mos ke merak. Mati gjërat." Pastaj vendosëm që vëllai im kishte marrë vendim që të vinte. Unë poashtu I thashë babait që të mos e detyronte që të shkonte. Nuk ka nevojë për këtë gjë. Ai u përgjigj se nuk do të ndalej. Ai ka marrë vendim që të largohej.

Prokurori Publik: A është vendosur gjatë takimit se do të vinte Iliri apo vendimi është marrë më vonë.

SH A: Nuk është vendosur menjëherë.

Prokurori Publik: Kur është marrë vendimi?

SH A: Me sa e di unë, ishte data 10. 10 apo 11, nuk më kujtohet me saktësi, por ishte kjo ditë kur ai vendosi të largohet.

Prokurori Publik: Na tregoni më shumë për këtë process vendim-marrjeje dhe si u zhvilluan gjërat.

SH A: Pastaj unë takova Blerimin dhe ne diskutuam se si nuk I kishte mjetet për të u larguar dhe prandaj Blerimi dërgoi Shpetimin të merrte vëllanë tim.

Prokurori Publik: A mund të përsëritni fjalinë e fundit?

SH A: Shpetimi dërgoi të vëllanë tim në Gjilan. Pastaj nuk e di me kë vazhdoi.

Kryetari i Trupit Gjykses : A e dini mbiemrin e Shpetimit?

SH A: Ademi.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Përfundimisht, Shkelzeni konfirmoi versionin e babait të tij për faktin se çmimi i udhëtimit ishte 3.000 Euro dhe se 2.500 Euro do duhej të jepeshin në Kosovë dhe 500 Euro në Zvicër pasi që të arrijë Iliri.

Mirëpo, sa i përket personit që është dashur të pranojë të hollat në Zvicër, dëshmitari ka dhënë dy versione të ndryshme:

Kryetari i Trupit Gjykses : ju thatë se gjatë telefonatës me zë të lartë, Antoni i ka thënë Blerimit se të hollat duhen dhënë taksistit i cili kishte për të sjellë vëllanë tënd. A është kjo e saktë?

SH A: Po, 500 Euro.

Kryetari i Trupit Gjykses : Këtu, në deklaratën që keni dhënë në polici më 30 tetor 2009 shkruan "lidhur me ngjarjen që ndodhi me të vëllanë tim Ilir Agushin, pagesa në shumën prej 3000 Euro për udhëtimin e vëllait, është dashur t'i jap Blerimit në Zvicër. Pastaj është dashur të i jap të hollat personit të quajtur Anton së bashku me personin me nofkën Joca, përgjegjës për këtë udhëtim." Kështu keni deklaruar në polici, pra krejtësisht ndryshe nga ajo që thoni tani. Pse kjo papërputhshmëri?

SH A: Në atë kohë kam qenë nën stres dhe merrja barëra. Merrja barëra.

Kryetari i Trupit Gjykses : Cili version është i saktë?

SH A: Versioni i saktë është se babai im kishte për të dhënë 2500 Euro dhe unë 500 Euro.

Kryetari i Trupit Gjykses : Kuji?

SH A: Shoferit që do t'i sillte.

Kryetari i Trupit Gjykses : Sqarimi juaj është se merrnit barëra dhe ishit nën stres?

SH A: Po.³²

Nga procesverbali më lart, duket e çuditshme dhe pothuajse e pamundur që gjatë hetimit, ai të ketë akuzuar Blerimin se ka marrë të holla vetëm pse ishte nën stres kur është intervistuar nga policia.

E kundërta është më e mundur. Gjasat janë më të mëdha që për arsye të panjohura për Trupin Gjykses, dëshmitari vullnetarisht të ketë vendosur të ndryshojë versionin e tij. Prandaj, versionin e dhënë gjatë hetimeve duhet konsideruar si versionin e besueshëm.

Elemente të tjerë që mbështesin versionin e dhënë nga dëshmitarët e mësipërm gjenden në deklaratën e dhënë nga i pandehuri Blerim Ademaj.

Ai përmendi një takim që u mbajt në Zvicër me Kadrush Ajvazin dhe SH A, të vëllanë e Ilir Agushit. Gjatë këtij takimi, Blerimi thirri Anton Gecajt, i cili e siguroi se mund të organizojë kontrabandimin jashtë Kosove të vëllait të Shkelzenit.³³

³¹ Procesverbal i datës 3 shkurt 2011, faqe 6-7.

³² Procesverbal nga 3 shkurt 2011, faqe 16.

³³ Procesverbal nga 13 maj 2011, faqe:

Blerim Ademaj: Siç ju thashë, Kadrushin e kam shok dhe ai shpesh vinte në vendin tim të punës. Unë punoj në klub nate, dhe Kadrushi erdhi dhe biseduam sepse para këtij rasti Kadrushi dhe familja e tij u zhvendosën në Zvicër me ndihmën e Antonit. Dhe Kadrushi nuk e kishte më numrin e telefonit të Antonit dhe ai erdhi tek unë me Shkelzenin dhe më pyeti nëse e kisha numrin e Antonit dhe unë i thashë po. Dhe unë i thashë se mund të bësh çfarë të duash, mund ta thërrasësh dhe Kadrushi deshi ta thërrasë duke iu referuar Shkelzenit dhe Shkelzeni sugjeroi që unë ta thërras sepse e njihja më mirë. Kadrushi më tha se Shkelzeni ishte djalë i mirë dhe se do të paguante menjëherë sapa të kryhej puna dhe kërkoi nga unë t'i them Antonit se do t'i merrte të hollat e tij.

Prokurori Publik: Në procesverbal shkruante se ai do t'i jepte të hollat.

Blerim Ademaj: E kam fjalë për Shkelzenin.

Prokurori Publik: Çfarë ndodhi pastaj?

Blerim Ademaj: E thirra Antonin me telefon dhe dëshmitarë ishin Shkelzeni dhe Kadrushi dhe ai pyeti se kush do të jepte të hollat.

Prokurori Publik: Antoni pyeti kështu?

Blerim Ademaj: Po, unë e pita Antonin se a po kryente ndonjë punë dhe ai më tha se po. Unë i thashë se njëri donte të sjellte të vëllanë këtu dhe e pita nëse mund ta dërgonte deri në Gjenevë dhe ai tha se po. Ai tha se kur të vjen aty, i donte të hollat menjëherë dhe unë i

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Blerimi po ashtu tha se nuk ka pranuar të holla sa i përket kontrabandimit të Ilirit dhe se nuk ka pasur ndonjë përfitim material për intervenimin e tij me Antonin;³⁴ Blerimi po ashtu foli edhe për rolin e të vëllait Shpejtimit në këtë mes, duke cekur se i vëllai thjeshtë i voziste personat në Gjilan pa e ditur se ishin migrantë që do të kontrabandoheshin jashtë Kosove.

Blerimi po ashtu konfirmoi se të hollat që i vëllai i pranonte zakonisht nga Anton Gecaj për shërbimet e tij ishin diku 200-300 Euro për çdo udhëtim³⁵ (ky është roli që Shpejtimit Ademaj thurri për vete kur dha versionin e tij të ngjarjes).³⁶

thashë se kjo gjë nuk paraqiste ndonjë problem. Ai poashtu sqaroi se si do të zhvillohej udhëtimi. Në Serbi dhe Hungari do të ecnin këmbë për dy orë dhe pjesën tjetër do t'a kryenin me veturë dhe çmimi për këtë ishte 3,000 Euro.

Prokurori Publik: Kur i thatë Antonit se të hollat nuk ishin problem, a e thatë për shkak të Kadrushit dhe Shkelzenit?

Blerim Ademaj: E thashë për shkak të Kadrushit dhe unë nuk e njihja Shkelzenin. Kadrushi i kishte vërtetuar Antonit se ishte njeri i fjalës.

...

Prokurori Publik: A e dini se çfarë ka ndodhur me Ilir Agushin, a është nisur për të dalur jashtë vendit?

Blerim Ademaj: Nuk e di se çfarë ka ndodhur pastaj dhe vetëm se i kam dërguar, numrat dhe i kam thënë të bëhet gati.

Prokurori Publik: Numrin e kujt i keni dërguar?

Blerim Ademaj: Numrin e Ilirit.

Prokurori Publik: Kush ua ka dhënë?

Blerim Ademaj: SH.

³⁴ Procesverbal i datës 13 maj 2011, faqe 19-20:

G K: Do të filloj me pyetjen e fundit të Prokurorit Publik. Kjo kishte të bënte me çmimin e udhëtimit. A i keni pasur të njohura këto çmime më parë apo mu atë ditë jeni njoftuar mbi këto çmime?

Blerim Ademaj: Ajo ishte hera e parë që unë kuptova çmimet. Kurrë më parë nuk kam biseduar këtë punë me askë.

G K: Për këtë arsye pyetët Antonin për çmim?

Blerim Ademaj: Po.

G K: A keni qenë ndonjëherë në Austri apo Gjermani?

Blerim Ademaj: Kurrë.

G K: Gjatë gjithë kohës që insistuat se bisedat telefonike ishin për shokët e juaj, Shkelzenin dhe Ilviun, pot ë mos kishin qenë shokët e juaj këta, a do të kishit thirrë Antonin për t'a diskutuar këtë çështje?

Blerim Ademaj: Jo.

G K: Pasi që erdhën Shkelzeni dhe Ilviu te ju, a jeni përpjekur të zbuloni adresën apo vendndodhjen e Antonit?

Blerim Ademaj: Po.

G K: Çfarë veprimi keni ndërmarrë për këtë?

Blerim Ademaj: Kur Antoni ndërpreu të gjitha kontaktet me ne dhe ne e kuptuam se çfarë u kishte ndodhur, Shkelzeni dhe Ilviu më pyetën 'çfarë mund të bëjmë për të gjetur Antonin?' Më kujtohet kur gjatë procedurës për të ndryshuar pronarin e veturës kërkuam një kopje të pasaportës, dhe pastaj ne shkuam te shkolla për vozitje në Lozanë dhe unë kërkoja kontratën e blerjes së veturës X5 dhe ata më pajisën dhe një kopje dhe këtë kopje i kam dorëzuar Shkelzenit. Pra fotokopja e pasaportës përmbante emrin, mbiemrin, adresën dhe të gjitha detajet. Pra, ai mori kopjen dhe erdhi në Kosovë.

G K: A do të thotë kjo se kur ju e kuptuat se jeni mashtruar nga Antoni, që nga dita e parë jeni përpjekur të kontriboni në arrestimin e Antonit?

Blerim Ademaj: Po.

G K: A mund të themi se këtë e keni bërë për të vërtetuar se jeni i pafajshëm dhe se nuk keni lidhje me këtë incident?

Blerim Ademaj: Kur kuptova se çfarë ka ndodhur, i thashë Shkelzenit, "nuk mund të vij me ty për të gjetur Antonin sepse nuk e kam dokumentacionin". Kështu që unë i dhashë dokumentet dhe Shkelzeni shkoi në Hungari dhe atje ka dhënë një deklaratë lidhur me Antonin. Pastaj erdhi në Kosovë dhe e filloi këtu.

G K: Ju gjithnjë keni thënë se sa i përket Shkelzenit dhe Ilviut, ju vetëm jeni përpjekur t'i ndihmoni pa ndonjë interes, por a kishit ndonjë interes apo përfitim nga Antoni?

Blerim Ademaj: Nuk kisha asnjë interes as nga Ilviu e as nga Shkelzeni, e as nga Antoni dhe kur ne thirrëm, ai dha çmimet prej 3,000 per person. Dhe ata nuk do të mund të më jepnin asgjë sepse ky ishte çmimi që kishin për t'i paguar Antonit. Unë poashu u kam thënë se nuk kam nevojë për të holla dhe se nuk kisha ndonjë interes në atë punë.

³⁵ Procesverbal i datës 13 maj 2011, faqe 35-37:

Kryetari i Trupit Gjykses : Me sa e dini ju, a kryenti i vëllai juaj ndonjë punë për Antonin?

Blerim Ademaj: Unë vetëm çka kam dëgjuar rastësisht kur ka biseduar në telefon sepse vij në Kosovë vetëm një herë në vit.

Kryetari i Trupit Gjykses : Çfarë keni dëgjuar?

Blerim Ademaj: Ai më tha se kishte thirrë Antoni dhe i kishte kërkuar që të merrte disa njerëz nga Gjilani.

Haxhi Millaku: Jo disa njerëz. Një njeri. Ta përsëritni?

Kryetari i Trupit Gjykses : Ta përfundojë njëherë.

Blerim Ademaj: Ka mund të ketë qenë një person apo njëqind.

Kryetari i Trupit Gjykses : Tema për të cilën fliste Shpejtimit Ademaj, a kishte të bënte me një apo më shumë persona?

Blerim Ademaj: Unë vetëm e dëgjova kur foli në telefon. Ai më tha se do të më jepte 200 Euro. Për informatë, neve nuk na duhen 200 Euro e as ndonjë shumë tjetër.

Kryetari i Trupit Gjykses : Kujt?

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Në të vërtetë, deklaratat e dhëna nga Agush dhe SH A bëjnë të qartë se roli i Shpejtim Ademajt nuk është ai që pretendohet nga ana e vëllezërve Ademaj ngase Shpejtimi kishte për të pranuar 2.500 Euro në Kosovë nga Agushi pasi që Iliri të arrijë në Zvicër.

Një shumë e tillë e të hollave e bën të qartë qëllimin e udhëtimit dhe pasi që nuk është hedhur poshtë se Anton Gecaj ishte personi i njohur sa i përket kontrabandimit të Ilirit, është shumë e mundshme se të hollat (apo një pjesë e të hollave) përfundimisht do t'i jepeshin Antonit.

Madje, duket se edhe roli i Blerimit ndryshon nga ai që pretendon ai ngase me ballafaqimin e kryer nga Trupi Gjykses në mes të dëshmitarit SH A me deklaratën e dhënë nga ai gjatë hetimit, ku shihet qartë se Blerimi kishte për të pranuar një pjesë të të hollave që do të paguheshin në Zvicër.

Për më tepër, përpos dëshmisë së A A dhe deklaratës së dhënë në polici nga SH A, është e logjikshme të mendohet se është absolutisht e pamundur që Blerimi të ketë pranuar të përfshihet në një aktivitet të tillë siç është ai i kontrabandimit të migrantëve, për të cilin e ka ditur se është i jashtëligjshëm pa pasur ndonjë përfitim material.

Blerim Ademaj: Se do të më jepte 200 Euro, pra më vonë.

Kryetari i Trupit Gjykses : Antoni do t'i jepte Shpejtimit?

Blerim Ademaj: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses : Sepse kur u intervistuat para Prokurorit Publik, ju thatë se nëse ka probleme në përkthim, avokatë, më lejoni të flas.. 'kur e kyeta Shpejtimin, ai më tha se ndihmonte ca të varfur, që ishin në situatë të rëndë dhe po I dërgonte në Gjilan'.

Blerim Ademaj: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses : A kështu është?

Blerim Ademaj: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses : 'Kur më thotë Antoni dhe Antoni do të më jep 200 Euro'.

Blerim Ademaj: Duke tu referuar të ardhmes.

Kryetari i Trupit Gjykses : 'dhe Antoni do të më jepte 200 Euro për një grup prej tyre'.

Blerim Ademaj: Në të vërtetë, për një veturë.

Kryetari i Trupit Gjykses : Për një udhëtim, e keni fjalën?

Blerim Ademaj: Për një udhëtim.

Kryetari i Trupit Gjykses : Në fakt, ju theksuat se do të thotë se ai do të merrte 200 Euro për një udhëtim me veturë deri në Gjilan.

Blerim Ademaj: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses : A ndodhi kjo një herë apo më shumë se një herë?

Blerim Ademaj: Nuk mund ta di sepse nuk isha në Kosovë, këtë vetëm e kam dëgjuar rastësisht në telefon.

Kryetari i Trupit Gjykses : Pra, Shpejtimi nuk ka thënë se po e bën këtë gjë vetëm një herë apo më shumë?

Blerim Ademaj: Nuk e di. Unë vetëm i kam thënë se nuk ka nevojë për këtë biznes dhe ai më tha se po u ndihmonte atyre që kishin nevojë sepse ata që i kanë të gjitha qëndrojnë në Kosovë dhe nuk shkojnë në Zvicër.

Kryetari i Trupit Gjykses : Lidhur me të vëllanë e Ilir Agushit, a e dini a e ka marrë Shpejtimi Ilirin?

Blerim Ademaj: Pas incidentit apo tragjedisë, Shpejtimi më tha se Antoni nuk më kishte thënë se do t'ihirrte Shpejtimin për të kryer punën, por Shpejtimi më tha se kishte dërguar Ilirin në Gjilan. Por, nuk e di nga.

³⁶ Procesverbal i datës 15 prill 2011, faqe 8:

Shpejtim Ademaj: Më duhet një moment për t'i sqaruar gjërat mirë. Gjatë udhëtimit për në Gjilan, Ilviu dhe Lavdi më thirrën për të më pyetur se a i kam dhënë gruas €300. Gjatë udhëtimit për në Gjilan, gruaja e ulur prapa më tha se do të marrim edhe dike që do të udhëtojnë bashkë me të. Ajo tha se do të udhëtonin bashkë. Nuk më kujtohet se a kam folur me Lavdin apo Ilvin më. Ajo grua kishte numrin e telefonit të atij njeriu. Ne biseduam me të riun që do të udhëtonte së bashku me atë grua. Ai më tha se ku ishte. Më tha "jam në fshatin Zhekar". Ishte një monument, u takuam aty. Ai ishte I shoqëruar nga dikush tjetër. Ai hyri në ulësen e përparme dhe në atë çast nuk po bisedoja me askë. Më kujtohet se kishte çantë shpine. Më pyeti se a bën të vendoset çanta në bagazh. Unë i thashë "bëni çfarë të doni". U nisa për në Gjilan. Sa i përket personit që e shoqëronte atë, nuk u kam thënë asnjë fjalë. Ne as që u përshëndetëm.

Prokurori Publik: Duke qenë se e përmendët këtë të ri, a ju kujtohet se a është përmendur emri i tij nga ndonjëri?

Shpejtim Ademaj: Gruaja e Ilviut përmendi diçka për të, por nuk e di a e ka njohur apo jo. Por këta të dy më thanë se ky I ri do të udhëtonte me gruan e Ilviut.

Prokurori Publik: A përmendi ndonjëri emra?

Shpejtim Ademaj: Pasi që e lexova emrin e tij në gazetë, kuptova se ai quhej Ilir, por ë rastin konkret, nuk e kam ditur se kush ishte.

Prokurori Publik: Pra, i dërguat në Gjilan, ku në Gjilan?

Shpejtim Ademaj: Në stacionin e taksive Shaqa, aty është edhe një pompë benzine.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Prandaj nga këto informata arrijmë deri te bindja se Blerimi dhe jo taksisti i panjohur i përshkruar nga Sh para Trupit Gjykues, ishte personi që kishte për të pranuar në Zvicër një pjesë të çmimit për kontrabandimin e Ilir Agushit dhe sipas të gjitha gjasave, edhe për të dorëzuar të hollat (apo një pjesë të të hollave) Antonit.

Si përfundim, nga provat e përmendura më lart, përgjegjësia e të pandehurve Shpetim dhe Blerim Ademaj (dhe ajo e Anton Gecaj dhe e personit të quajtur Joca) sa i përket kontrabandimit të Ilir Agushi duket qartazi dhe është e pamohueshme.

Kundër SH A do të ushtrohet një kallëzim penal sa i përket veprës penale të dhënies së deklaratës së rrejshme sipas nenit 307, KPK.

2.2.2. Kontrabandimi i Lindita Krasniqit, Agnesa Krasniqit dhe Anita Krasniqit.

Rrethanat e udhëtimit jashtë Kosovës, ndërmarrë nga e ndjera Lindita Krasniqi, Agnesa Krasniqi dhe Anita Krasniqi (përkatesisht gruas dhe të bijave të I K) janë qartësuar nga dëshmitë e dhëna nga I K, SH K si dhe nga deklaratat e dhënë nga Blerim Ademaj.

I K deklaroi se kishte kontaktuar me Blerim Ademajn nëpërmjet shokut të tij Lavdim Thaqit dhe që të tre u takuan në Gjenevë. Gjatë takimit në fjalë, Ilviu dhe Blerimi u pajtuan mbi mënyrën dhe çmimin (10.000 franga zvicerane) për kontrabandimin e familjes së I Kt në Zvicër.³⁷ Dëshmitari në mënyrë të qartë afirmoi se të hollat është dashur t'i jepen Blerimit.³⁸

Blerimi po ashtu informoi Ilmiun lidhur me individët e tjerë (Anton dhe Joca) të përfshirë në kohë të ndryshme të udhëtimit nga Kosova në Zvicër.³⁹

³⁷ Procesverbali i datës 23 shkurt 2011, faqe 2-3.

³⁸ Procesverbali i datës 23 shkurt 2011, faqe 16-17:

G K: Anëtarët e ndjerë të familjes suaj kanë pasur të shkojnë në Zvicër. Kujt është dashur t'i jepni të hollat, Blerimit apo ndonjë vozitësi që kishte për të sjellë familjarët tuaj?

I K: Unë nuk kisha punë me askë përpos me Blerimin.

Kryetari i Trupit Gjykues : Pra, keni pasur për t'i dhënë të hollat Blerimit?

I K: Po.

³⁹ Procesverbali i datës 23 shkurt 2011, faqe 21-22:

Kryetari i Trupit Gjykues : A ju ka sqaruar Blerimi se si është dashur të ndërmerret udhëtimi done, pra pjesa në Kosovë dhe pjesa në Serbi. A ju ka përmendur emrat e personave përgjegjës për disa pjesë të udhëtimit?

I K: Jo.

Kryetari i Trupit Gjykues : Sepse në polici ju keni thënë se pasi që kuptuat se një gabim kishte ndodhur, shkuat te Blerimi, pra në Restorantin e tij në Gjenevë dhe e pyetët se si shkoj udhëtimi dhe përgjigja e tij ishte si në vijim: "Shpejtimi i dërgon te kufiri me Serbinë, nga Serbia Joca, ndërsa Antoni i sjellë nga Subotica në Hungari; nga Hungaria në Vjenë nuk e di kush i sjellë. Por unë, (Blerimi) është dashur të shkoj dhe t'i marr në Vjenë".

Haxhi Millaku: Në versionin shqip, në kuptimin gramatikor dhe logjik duket se pjesa ku thotë "nga Hungaria në Vjenë nuk e di kush i sjellë—por, unë është dashur të shkoj dhe t'i marr në Vjenë" këtu duhet qartësim. A flet personi për veten e tij si person që është dashur të shkoj dhe të marrë të tjerët në Vjenë apo Blerimi?

I K: Blerimi kishte për të sjellur fëmijët e mi në Zvicër dhe të merrte të hollat. Ai më tha se nga Vjena do të udhëtonin me tren.

Kryetari i Trupit Gjykues : Pra, thoni se nga Vjena kishin për të udhëtuar me tren për në Zvicër?

I K: Po.

Kryetari i Trupit Gjykues : Pasi që të arrijnë në Zvicër, kush kishte për t'i marrë?

I K: Blerimi do t'i sjellte në Lozanë.

Kryetari i Trupit Gjykues : Ju jetoni në Lozanë, Blerimi jeton në Gjenevë dhe ai kishte për t'i marrë pasi që kishin për të ardhur në Lozanë?

I K: E rëndësishmja është se ai kishte për t'i sjellë në Lozanë.

Kryetari i Trupit Gjykues : Ju thotë se nga Vjena në Zvicër kishin për të udhëtuar me tren.

I K: Nuk e di se ku kishin për të arritur në Zvicër.

Kryetari i Trupit Gjykues : Marrëveshja ishte se Blerimi kishte për t'ju sjellë ata në Lozanë, apo jo?

I K: Po.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Blerimi dhe Shpejtim Ademaj⁴⁰ u pajtuan mbi ditën e nisjes së familjes së I K nga Kosova dhe atë ditë, SH K (vëllai i I) shoqëroi mbesat dhe kumatën e tij në vendin e caktuar me Shpejtim Ademaj dhe ia dorëzoi këtij të fundit.⁴¹

Shpejt pas tragjedisë, derisa rrethanat e tragjedisë ende ishin të paqarta, I u kontaktua nga Blerim Ademaj, i cili i tha se nëse diçka do të shkonte gabim, ai do të barte gjithë përgjegjësinë.

Sipas dëshmitarit, pas një kohe, një anëtar i familjes Ademaj i ofroi të holla I K dhe ky i refuzoi (edhe pse mbetet e paqartë se a nënkuptonte kjo një lloj kompensimi për atë që ka ndodhur apo ishte përpjekje që të bindet dëshmitari të mos akuzojë anëtarët e familjes Ademaj para autoriteteve gjyqësore).⁴²

Kryetari i Trupit Gjyqësor : Po këta emra që keni përmendur në deklaratën që keni dhënë në polici? Shpejtim Ademaj i dërgon te kufiri i Serbisë, pastaj nga Serbia Joca dhe Antoni i dërgon nga Subotica në Hungari.

I K: Kështu më tha Blerimi.

Kryetari i Trupit Gjyqësor : Këta fjalë ka përdorur Blerimi?

I K: Po.

⁴⁰ Procesverbali i datës 23 shkurt 2011, faqe 4:

Prokurori Publik: A jeni pajtuar mbi datën, kur është dashur të largohen nga shtëpia dhe si?

I K: Unë bisedova me Blerim Ademajn në telefon dhe ai më informoi për ditën që do të niseshin dhe pastaj Blerim Ademaj e diskutoi këtë me të vëllanë e tij Shpejtim Ademaj.

Prokurori Publik: A ju tha Blerim Ademaj se ai ka folur me të vëllanë Shpejtim Ademaj, apo e keni dëgjuar duke folur?

I K: Blerim Ademaj doli me vëllanë e tij dhe ata u pajtuan.

⁴¹ Procesverbali i datës 23 shkurt 2011, faqe 4:

Prokurori Publik: A mund të na thoni se si u larguan nga shtëpia gruaja juaj dhe fëmijët atë ditë?

I K: Vëllai im i dërgoi me veturën e tij në Rahovec.

Prokurori Publik: Kush i tha të vëllait tuaj të vepronte ashtu?

I K: Shpejtim Ademaj.

Prokurori Publik: Si mund ta dini se Shpejtim Ademaj, a ju tha thënë kush gjë?

I K: Vëllai im më tregoi se i dorëzoi gruan time dhe dy fëmijët atij.

Kryetari i Trupit Gjyqësor : Si është emri i vëllait tuaj?

I K: SH K.

Prokurori Publik: Që do të thotë vëllai juaj është SH K e jo Shpejtim Ademaj, korrekt?

I K: Po.

Prokurori Publik: Vetëm desha ta bëj të qartë se janë dy me emrin Shpejtim. Çfarë ndodhi pasi që Shpejtimi i mori? A ishit ju në kontakt me ta?

I K: Po. Unë isha në kontakt me Shpejtim Ademaj. I fola vetëm dy fjalë me të dhe ai tha se çdo gjë ishte në rregull dhe nuk kisha kontakt në shumë me të.

⁴² Procesverbali i datës 23 shkurt 2011, faqe 5-6:

I K: Ne kishim kontakt me Blerim Ademajn pas incidentit. Më thirri në 7 të mëngjesit dhe kemi pirë kafe.

Prokurori Publik: Pra, jeni takuar?

I K: Po. Kemi pirë kafe. Ne biseduam dhe ai tha: "Sidoqoftë, unë jam këtu dhe marr përgjegjësi për çdo gjë."

Kryetari i Trupit Gjyqësor : Kur biseduat me Blerim Ademajn, a e keni ditur se gruaja juaj dhe dy fëmijët ishin mbytur në lum?

I K: Jo, nuk e kam ditur. E dija vetëm se telefoni i saj nuk punonte më dhe më vonë e mësova.

Kryetari i Trupit Gjyqësor : Pse po merrte përgjegjësinë për të gjitha Blerim Ademaj?

I K: Ai tha se nëse ka ndodhë diçka, ai është aty dhe do të përgjigjet.

Prokurori Publik: Çfarë ndodhi pas këtij takimi me Blerim Ademajn, kur keni mësuar për incidentin?

I K: Pas këtij takimi, unë stuturova në shtëpi dhe nuk kisha më kontakt me Blerim Ademajn.

...

I K: Unë kam një pyetje sepse vëllai i Shpejtim Ademajt dhe Blerim Ademaj dërguan njerëz në shtëpinë time.

Kryetari i Trupit Gjyqësor : Kush është ai?

I K: Nuk ia di emrin.

I K: Ai dërgoi njerëz, më ofroi të holla, dhe ofroi të renovonte dhe të ndërtonte shtëpinë time.

Kryetari i Trupit Gjyqësor : Në shkëmbim me çka? Pse ju ofroi të hollat?

I K: Pretendonte për të më ndihmuar për këtë rast.

Kryetari i Trupit Gjyqësor : A ka të bëjë kjo me dëshminë e juaj apo me atë që ka ndodhur me familjen tuaj?

I K: Nuk e di çfarë qëllimi kishte, por nuk kam pranuar gjë.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Dëshmia e Ilmiut konfirmohet nga versioni i vëllait të tij Shpejtim, i cili njohu para Trupit Gjykses Shpejtim Ademajn⁴³ dhe konfirmoi rrethanën e dorëzimit të familjes së I të pandehurit të përmendur më lart, duke theksuar se takimi me Ademaj u zhvillua në Malishevë ku ai pa Lenditën, Agnesën dhe Anitën duke hipur në veturën e të pandehurit.⁴⁴

Elemente të tjera të konfirmimit të versionit të dhënë nga dëshmitarët e përmendur më lart paraqiten edhe në deklaratën e dhënë nga Blerim Ademaj. Ai foli për një takim në Zvicër me Lavdi Thaqin dhe I K. Gjatë këtij takimi, Blerimi thirri Anton Gecajn, i cili e siguroi se mund të organizojë kontrabandimin e familjes së I. Sipas Blerimit, intervenimi i tij kufizohej vetëm me vënien e kontaktit në mes të I dhe Antonit, pa pasur ndonjë përfitim personal.⁴⁵

⁴³ Procesverbal i datës 10 shkurt 2011, faqe 6-7:

Prokurori Publik: A mund ta përshkruani Shpejtimin, e keni takuar atë ditë dy herë, në Rahovec pranë ETC dhe në Malishevë?

SH K: Ishte i veshur në mënyrë elegante.

Prokurori Publik: Çfarë ngjyre kishte flokët?

SH K: Të zinj.

Prokurori Publik: Sa ishte i gjatë?

SH K: Jo shumë i gjatë.

Prokurori Publik: A ishte i plotë, i dobët?

SH K: Mesatar.

Prokurori Publik: Nëse ju lejohet të ktheheni dhe të identifikoni këtë person, a do të mund ta identifikoni dot?

SH K: Më duket se po.

Dëshmitari kthehet dhe e shikon të pandehurin.

Bën me gisht te Shpejtim Ademaj

Kryetari i Trupit Gjykses : Shpejtim Ademaj, ngrituni në këmbë. Ky person?

SH K: Po.

⁴⁴ Procesverbal i datës 10 shkurt 2011, faqe 3-6.

⁴⁵ Procesverbal i datës 13 maj 2011, faqe 12 – 14:

Prokurori Publik: A mund t'i referohemi një personi tjetër? I K, a e njihni?

Blerim Ademaj: Po.

Prokurori Publik: Si e njihni?

Blerim Ademaj: E njoh nëpërmjet Lavdi Thaqit.

Prokurori Publik: Kush është ai?

Blerim Ademaj: Një shok.

Prokurori Publik: Qe sa kohë?

Blerim Ademaj: Ka një kohë të gjatë.

Prokurori Publik: Për çfarë arsye keni takuar Ilviun nëpërmjet Lavdit?

Blerim Ademaj: Për t'i dhënë numrin e Antonit dhe për t'i treguar rrugën dhe për të gjetur një zgjidhje për problemin e tij.

Prokurori Publik: Çfarë problemi kishte ai?

Blerim Ademaj: Deshi të sjellë gruan dhe fëmijët e tij në Zvicër.

Prokurori Publik: A për këtë gjë kërkoi numrin e Antonit ai?

Blerim Ademaj: Po.

Prokurori Publik: A mund të na thoni se a i keni dhënë numrin apo e kontaktuat Antonin lidhur me familjen e Ilviut?

Blerim Ademaj: I kam dhënë numrin Ilviut dhe ai më tha që vetë ta thërras se e kam shok. Unë e thirra Antonin dhe i thashë se gruaja e një shokut tim, së bashku me dy fëmijë dëshiron të shkojë në Zvicër. Ai më pyeti se kush do të paguajë për ta dhe unë i thashë se Lavdi ishte një lloj garantuesi dhe nëse ai nuk të paguan, ky do të të paguajë. E pyeta për rrugën dhe ai më tha, si gjithmonë, Serbi, Hungari dhe Zvicër. Ai pyeti se a mund të ecin për dy orë. Në prani të Ilviut, e pyeta Antonin këtë dhe ai tha po. Antoni pyeti në praninë e Ilviut nëse gruaja e tij dhe fëmijët mund të ecin dy orë dhe Ilviu tha po.

Prokurori Publik: A e dini se kur kanë shkuar gruaja e Ilviut dhe fëmijët?

Blerim Ademaj: Jo.

Prokurori Publik: A e dini kur shkoi Ilviu?

Blerim Ademaj: Jo.

Prokurori Publik: A e dini se çfarë ka ndodhur me këta persona pastaj?

Blerim Ademaj: Atë natë që ndodhi, ai thirri dhe tha se janë arrestuar nga policia në Hungari.

Prokurori Publik: Çfarë ndodhi atë natë?

Blerim Ademaj: Tragjedia.

Kryetari i Trupit Gjykses : Kush thirri?

Blerim Ademaj: Antoni më thirri. Ilviu dhe Lavdi kishin numrin e Antonit, por asnjëri nuk e thirri atë sepse unë e thirra.

Prokurori Publik: Çfarë ju tha Antoni?

Blerim Ademaj: Ai kërkoi që t'ju them se janë arrestuar nga policia hungareze dhe mund të mbahet atje për një javë.

Kryetari i Trupit Gjykses : Nuk kishte kontakt në mes të Ilviut, Lavdit dhe Antonit; ju ishit pika e vetme e kontaktit?

Blerim Ademaj: Po, sepse nuk kishte mënyrë tjetër për t'i informuar për arrestimin.

Kryetari i Trupit Gjykses : Por, që nga fillimi, ju ishit personi i vetëm që kontaktonte Antonin?

Blerim Ademaj: Po.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Gjatë zhvillimit të shqyrtimit kryesor, avokati mbrojtës i Shpejtim Ademajt paraqiti një deklaratë nënshkruar nga Lavdi Thaqi. Në deklaratë, me shkrim dhe e nënshkruar, dhe për këtë arsye propozuar provë e pranueshme, thuhet se të hollat në lidhje me kontrabandimin e familjes Krasniqi supozoheshin t'i jepeshin Anton Gecajt dhe se Blerimi nuk kishte fare të bënte me pranimin e të hollave të lartpërmendura.

Gjykata nuk arriti të ftonë zyrtarisht Lavdi Thaqin meqënëse vendodhja e tij në Zvicër ishte e panjohur. Sidoqoftë, besueshmëria që mund t'i jepet kësaj deklaratë, pa patur mundësinë që dëshmitari të merret në pyetje për të verifikuar besueshmërinë e tij është qartësisht shumë e vogël në krahasim me dëshminë koherente dhe të besueshme dhënë nga I K i cili për më tepër është plotësisht konsistent me deklaratën që ai dha gjatë hetimit.

Edhe Shpejtim Ademaj ka dhënë versionin e tij të episodit dhe ka thënë se ai ka vozitur në Gjilan gruan dhe dy fëmijët e I K vetëm për t'i bërë një të mirë shokut të tij Lavdi Thaqi, pa patur asnjë përfitim material për ndërhyrjen e tij.⁴⁶

...
Kryetari i Trupit Gjykses : Por, sidoqoftë, udhëtimi u organizua nëpërmjet juve?
Blerim Ademaj: Jo, unë isha vetëm aty për t'u thënë çfarë më tha ai mua dhe pastaj i kam dhënë numrin e Antonit dhe Ilviu thirri Antonin.
...
Prokurori Publik: Ju thotë se Antoni ju thirri pas tragjedisë dhe ju tha se janë të arrestuar?
Blerim Ademaj: Po.
Prokurori Publik: A e keni informuar Kadrushin dhe Lavdin se çfarë ka ndodhur?
Blerim Ademaj: Po, menjëherë.
Prokurori Publik: A takuat Kadrushin, Ilvin apo Lavdin pas ngjarjes?
Blerim Ademaj: Unë mora informatëm në 3.00 të mëngjesit. Thirra Lavdin dhe ky erdhi në vendin tim të punës. Në 7.00 apo 8.00 të mëngjesit shkuam në Lozanë.
Prokurori Publik: Në 3.00 të mëngjesit ishit në punë?
Blerim Ademaj: Po.
Kryetari i Trupit Gjykses : Kush ju thirri?
Blerim Ademaj: Antoni. Ne shkuam në Lozanë dhe unë i thashë Ilviut se familja e tij është arrestuar në Hungari. Mendoj, unë dhe Lavdi së bashku. Ne i treguam se ai na thirri dhe na tha se janë arrestuar nga policia. Pastaj e informova Kadrushin, i cili erdhi me Shkelzenin dhe unë i tregova se janë arrestuar nga policia.

⁴⁶ Procesverbali i datës 15 prill 2011, faqet 6-8:

Prokurori Publik: A u thotë diçka mbiemri Krasniqi?
Shpejtim Ademaj: Ka shumë persona me mbiemrin Krasniqi.
Prokurori Publik: I K?
Shpejtim Ademaj: Po.
Prokurori Publik: E njihni këtë person?
Shpejtim Ademaj: Gjatë bisedës me Lavdi, ai m'a kujtoi se ne kishim shkuar bashkë në Zvicër dhe mua m'u kujtoi pak a shumë se kush ishte ai.
Kryetari i Trupit Gjykses: E keni fjalën për Lavdi Thaqin?
Shpejtim Ademaj: Po. Ai jeton në Zvicër.
Prokurori Publik: E njihni familjen e I K?
Shpejtim Ademaj: Jo.
Prokurori Publik: Keni patur rastini takoni apo t'i shihni?
Shpejtim Ademaj: Po, I kam parë.
Prokurori Publik: Mund të na thoni se në ç'rrethana i keni parë?
Shpejtim Ademaj: Meqënëse Lavdi dhe Ilvi ishin marrë vesh me Antonin se gruaja e tij do të shkonte në Austri apo Zvicër Lavdi dhe Ilvi më thirrën mua. Nuk jam i sigurt nëse ai ai ishte një natë më parë apo atë ditë dhe ata më thanë mund t'i japësh €300 gruas së Ilviut. Po, ishte marrëveshja që unë do t'i jepja asaj €300.
Kryetari i Trupit Gjykses: Gruaja e Ilviut ishte në Kosovë?
Shpejtim Ademaj: Po, e saktë.
Prokurori Publik: E keni takuar ndonjëherë gruan e Ilviut?
Shpejtim Ademaj: Po.
Prokurori Publik: Kur e keni takuar atë?
Shpejtim Ademaj: Nuk e di sa ishte data, ishte errësirë dhe binte shi.
Prokurori Publik: Ku e takuat atë?

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Megjithatë dëshmia e fortë dhe koherente e I K sqaroi se çfarë roli kishin patur dy vëllezërit në kontrabandim (Blerimi përcaktoi çmimin dhe dita e nisjes ishte caktuar nga dy vëllezërit). Kjo bën të qartë se të dy ata punonin për Antonin, dhe se ata ishin shumë mirë në dijeni të kontrabandimit dhe se ata kishin përfitim material nga aktiviteti i tyre).

Nga ana tjetër ngelet i paspjegueshëm kuptimi i aktivitetit të furishëm të Blerimin përse i përket udhëtimit të familjes së I K.

Nga pjesët e lartpërmendura të dëshmive, përgjegjësia e të pandehurve Shpetim dhe Blerim Ademaj (dhe e Anton Gecajt dhe personit të quajtur Joca) përse i përket kontrabandimit të Lindita Krasniqit, Agnesa Krasniqit dhe Anita Krasniqit është shumë e qartë dhe e pamohueshme.

2.2.3. Kontrabandimi i Brahim Kocit

Rrethanat e udhëtimit jashtë Kosovës ndërmarrë nga tani i ndjeri Brahim Koci janë sqaruar nga dëshmia e vëllait të tij R K:

Prokurori Publik: I ndjeri Brahim ishte vëllai juaj?

R K: Po.

Prokurori Publik: Ku po shkonte i ndjeri Brahim ditën kritike?

R K: Në Gjermani.

Prokurori Publik: Kur ndodhi?

R K: 11 tetor 2009. Tetor 2009.

Prokurori Publik: Na tregoni si u largua nga shtëpia vëllai juaj i ndjerë Brahim.

R K: Me makinë, në Gjakovë.

Prokurori Publik: Kush e voziti makinën?

R K: Unë.

Prokurori Publik: Deri ku shkuat së bashku në qytet?

R K: Nga fshati deri në qytetin e Gjakovës.

Prokurori Publik: Në çfarë vendi?

R K: Kafeneja quhej Roma, afër hotelit Pashtrik.

Prokurori Publik: Çfarë qëllimi kishit, pse shkuat aty?

R K: Po shkonim të takonim Shpetim Ademajn.

Prokurori Publik: Pse do të takoheshit me të?

R K: Vëllai im donte të shkonte jashtë dhe ai ra në kontakt me të.

Prokurori Publik: E takuat Shpetimin?

R K: Po.

Prokurori Publik: Mund t' a përshkruani takimin?

R K: Ky takim zgjati 5-10 minuta.

Prokurori Publik: Për çfarë biseduat në atë takim?

Shpetim Ademaj: Atë e takova në ETC në Rahovec, në fshatin Xerx. Aty nuk diskutova asgjë me të. Në shtëpi kisha dy punëtorë dhe ata ishin në makinë me mua dhe unë e rregullova që të takoheshim në Malishevë. Mora €300 nga bankomati. Pastaj Lavid më thirri dhe më tha që t'i çoj në Gjilan meqënëse babai dhe vëllai nuk mundeshin sepse ata kishin një kombi të vjetër. U takova me vëllain e lliut tek Raffaisen Bank të cilin e njoha kush ishte kur e pashë në këtë shqyrtim.

Prokurori Publik: Çfarë ndodhi kur u takuat?

Shpetim Ademaj: Gruaja dhe dy fëmijët e tij u futën në Malishevë.

Prokurori Publik: U futën ku?

Shpetim Ademaj: Në makinë, në makinën time në Malishevë.

Prokurori Publik: Ku i çuat ju ata?

Shpetim Ademaj: Në Gjilan.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

R K: Vëllai më tha se donte të shkonte jashtë; Shpejtimi i tha atij "Të çoj unë në Gjermani brenda 24 orësh."

Prokurori Publik: Keni biseduar për dicka tjetër?

R K: Ne biseduam mbi faktin se se ai duhej të ecte në këmbë për gjysëm ore apo një orë. Nuk biseduam fare në lidhje me lumin. Ai tha "do të ecësh në këmbë rreth një orë, një orë e gjysëm dhe nuk ka lumë askund"

Prokurori Publik: Biseduat për diçka tjetër?

R K: Pastaj ai e mori vëllain me vete dhe unë nuk fola me Shpejtimin më, vetëm më vonë. Kur vëllai im arriti në Gjilan, ai më thirri dhe më tha se kishin ndërruar makinat. "Ata n'a hipën në një kombi," më tha.

...

Prokurori Publik: A diskutuat me Shpejtimin për të holla?

R K: Po.

Prokurori Publik: Çfarë biseduat në lidhje me të hollat?

R K: 300-500 me vete, pjesa tjetër kur ai të arrinte do të jepej nga vëllai im, apo nga unë këtu.

Prokurori Publik: Për çfarë e keni fjalën kur thoni i kishte me vete?

R K: T'i kesh me vete, t' i kesh për rrugë. Për të kaluar kufirin, nuk e di se për çfarë i duheshin.

Prokurori Publik: Kush i tha kujt që duhet të kesh të holla me vete?

R K: Shpejtimi i tha vëllait tim "do të të duhen 300-500 për rrugë"

Kryetari i Trupit Gjykuës: Pra vëllai duhet të kishte të holla me vete?

R K: Po.

Prokurori Publik: Çfarë shume?

R K: 3000€.

Prokurori Publik: Kush supozohej të paguante 3000€ dhe kur?

R K: Kur vëllai im të arrinte atje, unë supozohesha t'ia jepja atij këtu apo t'ia dërgoja atij kurdo që ai të më thoshte...

Prokurori Publik: Meqënëse ju ndenjët me Shpejtimin 5-10 min, do të ishit në gjendje t'a njihnit atë nëse e shihni?

R K: Po.

...

Prokurori Publik: Ju lutem kthehuni dhe kontrolloni nëse e shihni personin këtu.

Dëshmitari kthehet dhe tregon të pandehurin Shpejtim Ademaj.

Kryetari i Trupit Gjykuës: A ishte ai personi që patë ditën kur ju shoqëruat vëllain tuaj me qëllim që të largohej nga Gjermania?

R K: Po. Me të kam folur edhe pas tragjedisë.⁴⁷

Dëshmia e R K tregon në mënyrë të pamohueshme përfshirjen dhe përgjegjësinë e Shpetim Ademajt në lidhje me kontrabandimin e të ndjerit Brahim Koci dhe sqaron se ai nuk ishte vozitës i paditur i cili punonte për Anton Gecajn pa ditur qëllimet e udhëtimeve të personave të cilët kishte vozitur në Gjilan (ky version ishte përsëritur nga Ademaj gjithashtu edhe mbi përfshirjen e tij në udhëtimin e Kocit).⁴⁸

⁴⁷ Procesverbali i datës 9 shkurt 2011, faqet 2-6.

⁴⁸ Procesverbali i datës 15 prill 2011, faqe 9:

Prokurori Publik: Ju kujtohet një person me emrin Brahim Koci?

Shpejtim Ademaj: Tani po.

Prokurori Publik: Çfarë ju kujtohet mbi këtë person?

Shpejtim Ademaj: Tani që ia di emrin më kujtohet mirë, njo gjithashtu edhe Gezim Ukën i cili është mik shtëpie prej rreth 20 vjetësh. Vëllai i Gezim Ukës është i martuar me motrën e Haxhiut dhe Sejdiut. Emrin e ka Ajete e cila është martuar me burrin e saj i cili është në Gjermani. Gezimi e njihje shumë mirë situatën në lidhje me se si Sejdi dhe Haxhi kishin dalë. Ata kontaktuan dhe komunikuan me kushërirën Ajete dhe i këkuan numrin tim që ai të merrte vesh se si ia kishin dalë të shkonin jashtë. Ai e dinte që unë e njihja Antonin. Ai më thërriste shpesh, dhe përshembull ai donte të shkonte në Gjermani me shokun tim.

Prokurori Publik: Kush është ky shoku juaj?

Shpejtim Ademaj: Antoni.

Prokurori Publik: Çfarë ndodhi pastaj?

Shpejtim Ademaj: Ai më thirri herë të ndryshme dhe unë thashë se kur ai të vijë këtu do të të thërras. Por ai këmbëngulte dhe thërriste shpesh sepse ai donte që kjo të bëhej sa më shpejt të ishte e mundur. I thashë atij në telefon se "Do të të njoftoj sapo ai të vijë". Fola me Antonin në telefon dhe ai më tha se ai do të vinte në Kosovë. I thashë Gezim se kjo do të ndodhte shpejt. Ai më tha se ai po shkonte te vëllai i tij në Gjermani. Ai më mbërmye Antoni ishte në Kosovë. Ne u takuam në Gjakovë dhe unë i thashë atij se Gezimi ishte shok imi dhe se ai do t' a zgjidhte dhe rregullonte këtë punë të tijën dhe se do t' i jepte të hollat në Gjermani. Unë e dija se ai nuk do të më gënjente mua sepse e kisha shok. Ai u largua të njëjtën mbrëmje si gruaja e Ilviut.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Edhe dëshmitari G U foli mbi udhëtimin e ndërmarrë nga viktimja Brahim Koci, dhe ai deklaroi se e vetmja ndërhyrje që ka bërë i pandehuri Shpejtim Ademaj gjatë udhëtimit fatal të viktimës është se e ka shoqëruar me makinë deri në Gjilan dhe se ai nuk ka pasur fare të bënte me vazhdimin e udhëtimit.

Megjithatë duke u bazuar në tregimin e dëshmitarit të lartpërmendur duket e pabesueshme që ndërhyrja e Ademaj të ketë qenë e kufizuar vetëm në një shoqërim të thjeshtë me makinë, meqënëse ai ishte kontaktuar direkt nga G U për të ndihmuar Brahim Kocin që të largohej ilegalisht nga Kosova. Ai sigurisht që duhet t'a kishte ditur se cili ishte qëllimi i vërtetë i udhëtimit.

Për më tepër masa e vërtetë e përfshirjes në episodin Ademaj del nga vetë fjalët e U kur ai deklaroi se Ademaj tashmë kishte kontrabanduar migrantë të tjerë dhe se dita e nisjes së Kocit i ishte transmetuar U nga Ademaj.

Kjo është pak si shumë për një vozitës që nuk është në dijeni.

G U: i ndjeri Brahim. Pastaj kunata ime tha Shpejtimi kishte disa lidhje në lidhje me këtë sepse ai ka sjellë një kunat timin në këtë vend. Dhe atëherë mora numrin e tij të telefonit dhe u përpoqa të lidhem me të. Nuk arrita të lidhesha me të për rreth dy javë. Numri i tij i telefonit nuk ishte në rregull. Ishte thjesht rastësi që pas dy javësh e thirra dhe ai u përgjigj. I thashë se një kushëri nga ana e nënës po këmbëngulte që t'a thirrja. Natën kur fola me të ai tha, nëse ai do të shkojë, atëherë sonte. Atë natë unë thirra kushëririn nga ana e nënës dhe i thashë të dilte jashtë se edhe unë do të dilja dhe se mund të takohemi tek Hotel Pashtriku në Gjakovë.

Kryetari i Trupit Gjykoës: e keni fjalën kur keni thirrur në telefon Shpejtim Ademajn?

G U: Po.⁴⁹

2.2.4. Kontrabandimi i familjes Mirena.

Rrethanat e udhëtimit jashtë Kosovës ndërmarrë nga Rrahim dhe Valbona Mirena dhe vajzat e tyre Doruntina, Dafina dhe Agnesa janë sqaruar nga dëshmitë e Z M K, motra e të ndjerit Rrahim, e Halil Currit, vëllai i të ndjerës Valbona, si dhe nda deklarata e të pandehurit Xhemaj Halilaj.

Rrethanat para udhëtimit jashtë Kosovës së familjes Mirena janë sqaruar nga deklarata e dhënë nga Xhemaj Halilaj.

Ai sqaroi se ai ishte kontaktuar përmes telefonit nga Rahim Mirena dhe, megjithëse nuk e njihte, ai ishte pajtuar t'a takonte atë në Drenas tek restorant 'Peshkopija'.

Aty Mirena i tregoi të pandehurit se ai donte të shkonte jashtë Kosovës për shërim dhe e pyeti Halilaj nëse ai e njihte Fatmir Pajazitin dhe nëse ai mund të fliste me Pajazitin në lidhje me mundësinë për t'u larguar nga Kosova. Mirena e kishte pyetur gjithashtu Halilajn nëse ai mund t'i mbante të hollat në lidhje me çmimin e udhëtimit derisa udhëtimi të ishte kompletuar.

Në bazë të Halilajt, Mirena i kishte bërë atij një kërkesë të mëtejshme:

Prokurori Publik: Kur thoni u largua, si dhe nga ku u nis?

Shpejtim Ademaj: Nga Hotel Prashitka ku është 'café Roma'. Ne u takuam aty dhe vazhdova rrugën time për në Gjilan.

⁴⁹ Procesverbal i datës 4 mars 2011, faqe 3.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Xhemajl Halilaj: Më vonë. Kërkesa numër dy e Rahimit ishte nëse mund t'a ulja çmimin sepse ai ishte sghumë i varfër. I thashë atij se 'përsa kohë flas me Fatmirin, nuk mund të them gjë sepse s'mund të them gjë.' Pas dy ditësh, takova Fatmir Pajazitin në Prishtinë, dhe ia tregova atij të gjitha mesazhet e ahim. Përgjigja e tij se ai nuk ishte vetmi që merrej me një biznes të tillë sepse ai duhej të bisedonte me të tjerët se çfarë mund të bënte sepse, tani po citoj atë që më tha Fatmiri: 'ata shokët i duan të hollat tek pompa e benzinës'.

...

Prokurori Publik: E kisha fjalën cila ishte marrëveshja përsa i përket të hollave?

Xhemajl Halilaj: Meqënëse Fatmiri ishte mik shtëpie, dhe unë e konsideroj atë akoma si të tillë, ai më tha: 'meqënëse kam besim tek ti, Rahimi mund t'i leje të hollat tek ty', sepse Fatmiri më tha se nëse Rahimi ia del të shkojë në Vienë atëherë do të më duhet të gjej paratë e mia dhe t' i ve të hollat vetë. Me plotëbesim, mund të them këtu në gjykatë, se Fatmir Pajaziti nuk ishte në gjendje t' i niste të gjithë këta persona por nuk mund të them asgjë në lidhje me këtë.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: Çfarë nënkuptoni me 'të vesh të hollat vetë'?

Xhemajl Halilaj: Rahim nuk i gjen të hollat atëherë më duhet t' i paguaj vetë.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: Pra, të hollat janë mbajtur si garanci?

Xhemajl Halilaj: Po.

Prokurori Publik: A folët ju mbi shumën e të hollave?

Xhemajl Halilaj: Mund të jeni më i qartë?

Prokurori Publik: Çfarë shume duhej të jepeshte nga Rahimi?

Xhemajl Halilaj: Shuma fillestare ishte €8000 me premtimin se Fatmir Pajaziti më tha se ai nuk kishte asnjë përfitimi në këtë, megjithatë shuma ishte €8000.

Prokurori Publik: A u pajtuat me Rahimin se ju do t' i mbanit të hollat?

Xhemajl Halilaj: Po.⁵⁰

Halilaj deklaroi gjithashtu se, më datë 12 tetor, Mirena erdhi në shtëpinë e tij dhe i dha 8.000 Euros (ky ishte çmimi për kontrabandimin e të gjithë familjes). Halilaj informoi Mirenën se të nesërmen ai dhe familja e tij supozoheshin të ishin tek restorant "Shaqa", në Gjilan ku do të nisnin udhëtimin me qëllim që të largoheshin nga Kosova.

Dhe në fakt familja arriti në vendin e caktuar:

Xhemajl Halilaj: Siç thashë, nuk e di se si Rahim Mirena shkoi në Gjilan. Qëllimi se pse unë shkova në Gjilan ishte për t' i treguar Fatmir Pajazitit se të hollat i kisha unë.

Prokurori Publik: Kur ju arritët në Gjilan, a u takuat me Fatmir Pajazitin?

Xhemajl Halilaj: Kur arrita në Gjilan, Fatmir Pajaziti ishte në restorantin e quajtur 'Shaqa'. Aty pimë një kafe dhe më kujtohet akoma se si ishte veshur. Ndërkohë, Rahim Mirena, gruaja e fëmijët e tij ishin para restorantit, dhe nuk mund të them se ata ishin me Fatmir Pajazitin.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: Pra, Fatmir Pajaziti ishte në restorant, dhe Rahim Mirena ishte jashtë restorantit?

Xhemajl Halilaj: Tek hyrja.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: Folët ju me Rahim Mirenën?

Xhemajl Halilaj: Po, dhe pyeta 'pse nuk futesh brenda' dhe ai tha se se fëmijët e tij nuk mund të futeshin brenda.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: Çfarë po bënin ata jashtë?

Xhemajl Halilaj: Po prisnin..

Kryetari i Trupit Gjyqësor: Për çfarë?

Xhemajl Halilaj: Për t' u nisur.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: Ku?

Xhemajl Halilaj: Për të dalë jashtë shtetit.

Prokurori Publik: Kur ju takuat Fatmirin, çfarë ndodhi pastaj, a u ulët bashkë? Çfarë ndodhi?

Xhemajl Halilaj: Kur takova Fatmirin u ula në tavolinë dhe porosita një kafe, dhe i thashë se Rahim Mirena me gruan dhe fëmijët e tij po prisnin jashtë, Fatmiri më tha 'tani do të vijë makina që t' i marrë'.

Prokurori Publik: Gjatë asaj here a folët përsëri në lidhje me të hollat?

⁵⁰ Procesverbali i datës of 18 prill 2011, faqe 5.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Xhemajl Halilaj: I thashë se të hollat i kisha unë dhe i thashë 'nëse do hajde dhe shikoji të hollat por nuk do të t' i jap derisa ata të arrijnë në vend, derisa Rahimi të më telefonojë.⁵¹

Pas pak minutash erdhi një makinë Golf II dhe familja u fut në makinë⁵².

Pasi ata u larguan, Halilaj kontaktoi Mirenën vetëm një herë:

Prokurori Publik: Pas takimit me Rahim Mirenën apo pasi u nis pasi Rahim Mirena u nis, a keni patur kontakte të tjera me Rahim Mirenën?

Xhemajl Halilaj: Po, pata.

Prokurori Publik: Kur?

Xhemajl Halilaj: Më datë 14 tetor 2009, ishte mbrëmje, nuk më kujtohet koha e saktë, ora ishte rreth 19.30 20.00. Rahimi më thirri përmes telefonit, prefiksi i telefonit ishte 062, por pjesa tjetër e numrit nuk më kujtohet, numrat duhet të jenë në telefonin tim të cilin m'a konfiskoi policia.

Prokurori Publik: Ai u thirri?

Xhemajl Halilaj: Po, Rahimi më thirri.

Prokurori Publik: Çfarë ju tha?

Xhemajl Halilaj: Rahimi më tha: 'u nisëm sonte dhe arritëm shumë mirë në Suboticë.' I urova udhëtim të mbarë. Nuk di çfarë t' i thosha tjetër.

Prokurori Publik: A ishte ajo hera e fundit që folë me Rahim Mirenën?

Xhemajl Halilaj: Nuk pata asnjëherë më kontakt me të pas atij kontakti.⁵³

Halilaj saktësoi gjithashtu se Pajaziti dukej të ishte i informuar përse i përket hollësive të udhëtimit.⁵⁴ Kur Halilaj mori vesh tragjedinë ai vendosi t' ia dorëzonte të hollat policisë meqënëse e konsideronte vetëm thjesht si mbajtësi i depozitës.

Versioni i ngjarjeve dhënë nga i pandehuri është konfirmuar nga dëshmia e Halil Currit i cili deklaroi se ai kishte qenë i pranishëm kur Rrahim Mirena i kishte dhënë të akuzuarit Xhemajl Halilaj një shumë të hollash që varionte nga 8000 deri 8500 Euro dhe se Rrahimi i kishte thënë atij se ai po ia jepte të hollat Halilajt, sepse ai donte të shkonte në Francë m familjen e tij.

⁵¹ Procesverbali i datës 18 prill 2011, faqe 7-8.

⁵² Procesverbali i datës 18 prill 2011, faqe 17:

Xhemajl Halilaj: Shkova tek makina ime në parking, prej aty pashë makinën që mori familjen nga rruga disa metra më anej. Edhe Fatmiri ishte tek makina.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: Çfarë nënkuptoni me tek makina?

Xhemajl Halilaj: Afër makinës, ai foli me personin, nuk e di se çfarë folën. Fatmiri nuk u fut në makinë.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: Pra ju e patë Fatmirin duke i folur shoferit të makinës Golf?

Xhemajl Halilaj: Do të doja që kjo të mos ishte e vërtetë por është.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: Pasi apo para se të pini kafën?

Xhemajl Halilaj: Pasi.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: E patë familjen e Rrahim Mirenës duke hyrë në makinë apo jo?

Xhemajl Halilaj: Po, i përshëndeta tek parkingun.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: I patë ata duke hyrë në makinë?

Xhemajl Halilaj: Po.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: Dhe Fatmir Pajaziti, çfarë po bënte ai kur ata po hynin në makinë?

Xhemajl Halilaj: Fatmir Pajaziti po fliste me shoferin e makinës.

⁵³ Procesverbali i datës 18 prill 2011, faqe 9.

⁵⁴ Procesverbali i datës 18 prill 2011, faqe 17:

Xhemajl Halilaj: Nuk u diskutuan detaje në lidhje me këtë me Rrahim Mirenën. Nuk kam folur për asnjë hollësi me Rrahim Mirenën.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: Po mbi Fatmir Pajazitin?

Xhemajl Halilaj: Po. Fatmiri më tha se Rrahimi do të merrej brenda 30 orësh.....

Kryetari i Trupit Gjyqësor: Kush u tha ju se Rrahim Mirena do të merrej?

Xhemajl Halilaj: Fatmir Pajaziti më tha se makina do t'a merrete në Gjilan dhe se do të ishte në Vienë brenda 30 orësh.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: Makina me familjen e Rrahim Mirenës?

Xhemajl Halilaj: Po.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Në fund Curri shtoi detaje të tjera të cilat konfirmojnë versionin e dhënë nga Halilaj përsa i përket rolit të Pajazitit në kontrabandimin e familjes Mirena:

Kryetari i Trupit Gjykses: Na thatë se vëllai juaj u kishte thënë se edhe Fatmir Pajaziti ishte i përfshirë në këtë kontrabandim të migrantëve, çfarë ju tha u saktësisht nga Sylja?

Halil Curri: Ne folëm në telefon dhe unë isha në Slloveni se Xhemajli duhet t'i dorëzonte Rrahimin dhe familjen e tij Fatmir Pajazitit!

Kryetari i Trupit Gjykses: T'ia dorëzonte ku?

Halil Curri: Në Lipjan.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra Sylja ju tha ju se Xhemajl Halilaj i kishte dorëzuar familjen e Rrahimit Fatmir Pajazitit?

Halil Curri: Po, në komunën e Lipjanit.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kush ia kishte thënë këtë vëllait tuaj?

Halil Curri: Xhemajl.

...

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju na thatë se ishte vëllai juaj ai që ju tha se edhe Fatmir Pajaziti ishte i përfshirë në kontrabandimin e migrantëve, çfarë ju tha ju saktësisht Sylja?

Halil Curri: Ne folëm në telefon dhe unë isha në Slloveni, se Xhemajli duhej t'ia dorëzonte Rrahimin dhe familjen e tij Fatmir Pajazitit!

Kryetari i Trupit Gjykses: T'ia dorëzonte ku?

Halil Curri: Në Lipjan.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra Sylja u tha ju se Xhemajl Halilaj ia kishte dorëzuar familjen e Rrahimit Fatmir Pajazitit?

Halil Curri: Po, në komunën e Lipjanit.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kush ia tha këtë vëllait tuaj?

Halil Curri: Xhemajli.⁵⁵

Nga ana tjetër, i pandehuri Fatmir Pajaziti thjesht ka mohuar çfarëdolloj përfshirjeje në këtë episod dhe ka pohuar se nuk e ka njohur kurrë familjen Mirena dhe se ai nuk është marrë kurrë me kontrabandimin e këtyre personave jashtë Kosovës.⁵⁶

Pra, dëshmia kundër Pajazitit bazohet vetëm në deklaratën e Halilajt.

Dëshmia e Currit përputhet me atë të Halilajt, por përsa i përket përfshirjes së Pajazitit Curri deklaroi vetëm atë që i është thënë atij nga Halilaj. E vetmja gjë që Curri dinte mbi këtë episod direkt ka të bëjë me dorëzimin e të hollave Halilajt nga Mirena.

Kontaktet telefonike dhe mesazhet telefonike të regjistruara në numrat e telefonit 044 278 144 dhe 044 249 952 nuk kanë asnjë relevancë kundër Pajazitit, meqenëse nuk ishte e mundur të vendoset lidhja mes numrave të lartshënuar me të pandehurin.

⁵⁵ Procesverbal i datës 18 prill 2011, faqet 7 dhe 14.

⁵⁶ Procesverbal i datës 15 prill 2011, faqja 27:

Prokurori Publik: A keni njohur ndonjëherë dikë me emrin Mirena apo Rahim Mirena?

Fatmir Pajaziti: Nuk njoh dikë të tillë. Nuk kam dëgjuar kurrë për këtë person.

Prokurori Publik: Keni folur ndonjëherë me Xhemajl Halilajn, me persona të tjerë që donin të shkonin jashtë shtetit?

Fatmir Pajaziti: Nuk kam folur në lidhje me këtë çështje sepse nuk kam patur kohë të flas mbi këto çështje. Që nga viti 2006 punoja me një shoqatë dhe jam kryesuesi. Kam parë deklaratën time dhënë në polici; Vura re se policia ka shkruar në atë deklaratë çfarë ka dashur.

Kryetari i Trupit Gjykses: Aty ka qenë i pranishëm edhe Avokati juaj Mbrojtës dhe ju e keni nënshkruar atë dhe duhet të keni kujdes kur akuzoni një oficer policie se ka kryer një vepër penale. Ju mund të thoni çfarë të doni por nëse akuzoni dikë në mënyrë të rreme se ka kryer një krim atëherë në këtë rast edhe ju po kryeni një krim.

Fatmir Pajaziti: Kjo është e bazuar në fakte. Agjencia ime është krijuar në 2003, është regjistruar në Prishtinë. Agjencia ime nuk njihet nga MD Raisen por nga BF Commerce dhe është e regjistruar nën këtë emër që nga 2003, me shkrim agjencia është regjistruar në Dardani, para ndërtesës ElectroKosova, gjatë vitit kur Xhemajl Halilaj ishte aty punonjës.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Në fakt ai ka mohuar se ka qenë përdoruesi i këtyre numrave dhe policia ka bërë lidhjes mes tij dhe numrave vetëm ne bazë të informatave të siguruar nga informatorë, emrat e të cilëve nuk i janë zbuluar Gjykatës.⁵⁷

Duke ballafaquar dhe krahasuar dy versionet e të njëjtit episod dhënë nga Halilaj dhe nga Pajaziti, i pari duket më i besueshëm dhe më logjik.

Në fakt nga dëshmitë e tjera të grupit del që paratë për kontrabandimin paguheshin zakonisht pasi emigrantët të kishin arritur destinacionin e tyre. Prandaj është shumë e llogjikshme që paratë i janë dhënë nga Mirena një personi të tretë (*id est* Halilaj) për të paguar cmimin e trafikimit, vetëm pas përfundimit të suksesshëm të udhëtimit.

Po ashtu, sjellia e Halilajt që pas tragjedisë i dorëzoi paratë policisë me qëllim që t'ja kthenin ato të afërmeve të Mirenës, vërteton rolin e tij në këtë episod.

Përveç kësaj, me qëllim që të vlerësohet pozitivisht tregimi i Halilajt, duhet të merret në konsideratë se me dëshminë e tij ai akuzoi jo vetëm Pajazitin, por edhe vetveten dhe ky është një element më tepër për besueshmërinë e tij (ja vlen të nënvizohet se pa një dëshmi të tillë do të kishin mbetur fare të paditur personat e përfshirë në kontrabandimin e familjes Mirena dhe hollësitrat e udhëtimit).

Po ashtu, një element tjetër i besueshmërisë së variantit të dhënë nga Halilaj është përputhja absolute me dëshminë e dhënë gjatë hetimit.

E vetmja mundësi për ta parë si të pavërtetë dëshminë e Halilajt është që i pandehuri që nga fillimi fare i hetimit, sajoi kryesisht akuzimin kundër Pajazitit dhe më pas i qëndroi me kokëfortësi versionit të tij fillestar (të rremë) gjatë të gjithë procedurës. Megjithatë nuk ka ndonjë element (as vetë Pajaziti nuk mund të tregojë as shenjë më të vogël në këtë kuptim) që mund të çojë në një përfundim të tillë.

Është e padiskutueshme që nëse një i pandehur akuzon një të pandehur tjetër, verifikimi i besueshmërisë duhet të jetë edhe më e plotë dhe e saktë se ç'bëhet për deklaratën e dëshmitarit, përderisa pozita e tij nuk është asnjane.

Nga ana tjetër KPPK, ndryshe nga kodet e tjerë të procedurës, nuk kërkon që akuzimet e bëra nga një i bashkë-akuzuar kundër një të pandehuri tjetër të vërtetohen nga elementë të jashtëm të konfirmimit që çojnë drejtëpërsëdrejti tek personi që është objekt i akuzimit.

Prandaj vlerësimi i mbështetshmërisë dhe besueshmërisë më lart i bërë për deklaratën e dhënë nga Halilaj është e mjaftueshme që mbështesë përtej dyshimit të arsyeshëm përgjegjësinë e Pajazitit (dhe të Halilajt) në lidhje me kontrabandimin e familjes Mirena.

2.3.Pozita e Rabit Ajvazit.

⁵⁷ Procesverbali i datës 7 prill 2011, faqja 17.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Lidhur me pozitën e Rabbit Ajvazit e vetmja provë e prokurorit ishte deklarata e dhënë nga A A sipas të cilës paratë për udhëtimin e djalit të tij I duhej ti jepeshin Shpejtim Ademajt nëpërmjet Rabbit Ajvazit.

Megjithatë një variant i tillë nuk u konfirmua nga dëshmitari gjatë gjykimit kryesor. I ballafaquar nga mbrojtia dhe nga trupi gjykues në lidhje me mospërputhjet me dëshminë e mëparshme, A pohoi fuqimisht se paratë duhej ti jepeshin drejtpërsëdrejti Shpejtim Ademajt dhe se Ajvazi nuk kishte të bënte fare me udhëtimin jashtë shtetit të djalit të tij Ilir.⁵⁸

Duke patur parasysh moshën e madhe të dëshmitarit, është e mundur që gjatë hetimit, kur ai është marrë në pyetje nga policia, ka ndodhur një keqkuptim dhe emri i Rabbit Ajvazit është thënë gabimisht si personi që duhej të merrte shumën e parave për Shpejtimin.

Ky konkluzion është përforcuar gjatë të gjithë dëshmisë së A që vërtetoi se Ajvazi ishte përfshirë vetëm në kontrabandimin e një anëtari të familjes së tij dhe madje kishte këshilluar A që të mos e kontaktonte Shpejtim Ademajn për ta dërguar jashtë shtetit djalin e tij Ilirin, meqë këtij të fundit nuk mund ti besohej.

Për arsyet e mësipërme përgjegjësia e Ajvazit për kontrabandimin e Ilir Agushit nuk mund të konsiderohet që të jetë treguar përtej dyshimit të arsyeshëm, prandaj i pandehuri duhet të lirohet nga akuzat përderisa nuk është provuar që ai ka kryer veprën penale për të cilën është ngarkuar.

⁵⁸ Procesverbali i 2 Shkurtit 2011, faqet 55, 56 dhe:

A A: Rabbit tha: "Mos e le Elmi Qerimi: Kur kontaktuat me Rabbitin, çfarë e pyete atë?"

A A: e pyeta se si e nxorri motrën jashtë Kosovës. Kush e bëri këtë dhe si e bëre?

Elmi Qerimi: Gjatë bisedës me Rabbitin, a dëgjove ndonjë emër apo i mësove ato më vonë?

A A: Unë nuk dëgjova ndonjë emër.

Elmi Qerimi: E di dhe ti the më parë se djali tjetër i yti, Shkëlzeni punon në Zvicër. A ka vepruar Rabbiti apo ti si ndërmjetsues në lidhje me djalin tuaj?

A A: Jo.

Elmi Qerimi: A ka kërkuar Rabbiti para ty?

A A: Jo.

Elmi Qerimi: A të tha Rabbiti, se nëse bëhet ndonjë shërbim dhe ti nuk paguan paratë, Rabbiti do ta bënte këtë?

A A: Jo.

...

Elmi Qerimi: Me që ne jemi nga i njëjti fshat unë e di saktësisht nivelin gjuhes së tij dhe është shumë e varfër dhe fshatareske dhe ai nuk e di kuptimin e fjalës ndërmjetsues. Faqja 3 e deklaratës e dhënë në polici, cila ishte vlera e mjeteve që ti shkove për ti dhënë atij dhe përgjigja e tij ishte "Unë duhej ti jepja 3,000 Euro Rabbitit sapo Iliri të ishte në Zvicër". Pyetja është: a është kjo fjalë e vërtetë?

A A: Mua nuk më kujtohet ta kem thënë këtë.

Kryetari i trupit gjykues: Ju nuk thatë se marrveshja ishte ti jepje 3,000 Euro Shpejtimin nëpërmjet Rabbit porsa Iliri kishte arritur në Zvicër?

A A: Jo.

Kryetari i trupit gjykues: Pra cila ishte marrëveshja?

A A: Shkëlzeni duhet ti jepte 500 Euro Shpejtimin porsa djali të arrijë në Zvicër.

Kryetari i trupit gjykues: Kishte para të tjera që duhet ti jepeshin ndonjë personi tjetër?

A A: Porsa djali të arrinte në Zvicër, Shkëlzeni duhej ti jepte Shpejtimin 500 Euro dhe kur unë të merrja një telefonatë që ai kishte arritur unë duhej ti jepja 2,500 Euro Shpejtimin.

Kryetari i trupit gjykues: Nëpërmjet dikujt apo drejtpërdrejtë Shpejtimin?

A A: Drejtpërsëdrejti Shpejtimin.

Elmi Qerimi: A ke folur për këtë çështje me Rabbitin?

A A: Jo.

Elmi Qerimi: Çfarë të tha Rabbiti kur fole me të për familjen e tij? Cilat ishin fjalët e tij saktësisht?

A A: Rabbit tha: "Mos e le djalin të shkojë me të sepse ai është një gënjeshtar."

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Prokurori nuk ka paraqitur prova që Ajvazi të ketë kryer veprën penale të Krimit të Organizuar dhe në këtë mënyrë ai duhet të lirohet nga ngarkimet penale në lidhje me këtë pikë të aktakuzës.

2.4. Njërëzit që ishin në fakt të pranishëm në barkën që u përmbys dhe fati i tyre përfundimtar.

Pas egzaminimit të episodeve të vecanta të trafikimit mund të bëhet një paraqitje e migrantëve që ishin të pranishëm në barkën që u përmbys në natën fatale të 14 Tetorit 2009 dhe për fatin e tyre përfundimtar.

B R qartësoi në dëshminë e tij se ai ishte në barkë me partneren e tij Elvira Jaha dhe fëmijët e tyre kur barka u përmbys dhe se të gjithë ata ranë në ujë, ai humbi kontaktet me Elvirën dhe ai nuk e pa më atë të gjallë.

Rama identifikoi trupin e saj të vdekur vetëm dy javë më pas, kur ai u thërrit nga policia.

Dëshmitari foli gjithashtu për praninë në barkë të migrantëve të tjerë:

Kryetari i trupit gjykues: Për shkak se në deklaratën dhënë në polici thuhet se ty të janë treguar fotografitë e familjes Ademi, a janë këto fotografi për të cilat keni folur?

B R: Po.

Kryetari i trupit gjykues: dhe ishin 4 persona, babai, nëna dhe dy fëmijë?

B R: Po.

Kryetari i trupit gjykues: Ty të është treguar gjithashtu fotografia e Ibrahim Kocit, ishte ky person në barkë?

B R: Po.

Kryetari i trupit gjykues: Gjithashtu fotografia e Ilir Agushit, a ishte ky person në barkë?

B R: Po.

Kryetari i trupit gjykues: Të është treguar fotografia e familjes Mirena?

B R: Jo aty.

Kryetari i trupit gjykues: Ku?

B R: Këtu.

Kryetari i trupit gjykues: Ku?

B R: Në Kosovë, kur jam intervistuar nga policia.

Kryetari i trupit gjykues: A ishin këta njerëz në barkë?

B R: Po.

Kryetari i trupit gjykues: Babai, nëna dhe tre vajzat e tyre?

B R: Po.⁵⁹

Prandaj nga dëshmia e Ramës, që nuk ka mospërputhje me ndonjë element tjetër, mund të pranohet se B R, Elvira Jaha, Erida Jaha, Rendi Jaha, Ilir Agushi, Ibrahim Koci, Florim Ademi, Elfete Ademi, Albert Ademi, Florian Ademi, Ibrahim Mirena, Valbona Mirena, Doruntina Mirena, Dafina Mirena dhe Agnesa Mirena ishin më siguri në barkën që u përmbys në lumin Tisa në natën midis 14 dhe 15 Tetorit 2009.

Megjithëse B R nuk foli për familjen e I K, ai shtoi se në barkë ishin edhe persona të tjerë (18 persona - 9 të rritur dhe 9 fëmijë - plus drejtuesi i barkës) dhe nga tregimi i I K dhe Blerim Ademaj (të dy ata dëshmuan) rezulton pa asnjë dyshim që personat e tjerë në barkë ishin Lendita Krasniqi, Agnesa Krasniqi dhe Anita Krasniqi.

⁵⁹ Procesverbali i 2 Shkurtit 2011, faqet 37 - 38.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Të gjithë trupat me përjashtim të katër prej tyre u nxorrën, dhe megjithëse nuk është bërë autopsia, mund të paraqiten disa konsiderime për shkaqet e vdekjes.

Së pari: anjë nuk i ka parë këta njerëz gjallë pasi ata ranë në ujrat e lumit Tisa. Ky lumë sigurisht që nuk është një përrua i vogël dhe ka emër të keq si lumë i rrezikshëm për tu kaluar (në fakt shumë nga migrantët dhe veçanërisht të afërmit e tyre donin të siguroheshin përpara udhëtimit se nuk do të kalohej ndonjë lumë me barkë).

Prandaj është shumë e mundshme që personat që ranë në ujëra dhe që nuk janë parë më të gjallë, vdiqën duke u mbytur në lumë.

Së dyti: në dosjen e lëndës janë fotografite që tregojnë disa nga trupat e nxjerrë.

Raporti i policisë i datës 2.11.2009 (marrë me pëlqimin e palëve) paraqit se Fadil Mirena dhe Sami Mirena, të afërm të Rrahim Mirenës, kanë njohur fotografite bashkëngjitur në raport dhe treguar atyre trupin e këtij të fundit. Megjithëse raporti nuk thotë ndonjë gjë për shkakun e vdekjes si dhe për vendin e gjetjes së trupit, kushtet e trupit sugjerojnë që Mirena ka vdekur nga mbytja në ujë (trupi është i ënjtur dhe i mbuluar me baltë).

Një raport tjetër i datës 2.11.2009 (marrë me pëlqimin e palëve) paraqit që Syle Curri dhe Naxhije Curri mundën të njohin trupin e vdekur të Valbona Mirenës nga fotografite e treguar atyre të bashkëngjitura në raport. Kushtet e trupit janë shumë të ngjashme me ato të trupit të Rrahim Mirenës.

Përveç kësaj ka një fotografi të një trupi të vdekur që është mbi ujë që duket të jetë lumë apo liqen.

Një tjetër raport i policisë i datës 2.11.2009 (marrë me pëlqimin e palëve) paraqit që Fakte Asllani, një e afërme e Elfete Ademi, mundi ta njohë në fotografite bashkëngjitur raportit Florian Ademin, djalin e Florin dhe Elfete Ademit. Kushtet e trupit të vogël janë të ngjashme me ato të përshkruar më lart.

Raporti policisë i datës 31.1.2009 (marrë me pëlqimin e palëve) paraqit që Shpejtim Krasniqi, vëllai i I K, mundi të njohë fotografite bashkëngjitur raportit të mësipërm Lendita Krasniqin (emri vajzërisë së saj ishte Morina) dhe Agnesa Krasniqin. Kushtet e trupave janë të ngjashme me ato të përshkuara më lart.

Elementët e mësipërm të çojnë në konkluzionin, që të konsiderohet si i provuar përtej dyshimit të arsyeshëm, se përveç B R dhe fëmijëve të tij, të gjithë migrantët që ishin në barkë u mbytën në lumin Tiza në natën e 14 dhe 15 Tetorit 2009.

Vlen të përmendet se prokurori u përpoq që të paraqisë si provë disa autopsi të disa trupave të pa identifikuar. Autopsitë ishin kryer në Serbi dhe kështu që paraqitja e këtyre provave duhet që të përmbushë kërkesat e parashikuara nga Neni 507 i KPPK.

Prokurori pretendoi se provat ishin marrë nga Serbia në bazë të reciprocitetit, pra në përputhje me Nenin 507, paragrafi 3 të KPPK.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Megjithatë prania e kushteve të reciprocitetit faktik duket të jetë shumë e diskutueshëm për vende që nuk e njohin njëri tjetrin.

Sidoqoftë autopsitë e ofruara nga Prokurori nuk kanë një letër përcjellëse që të tregojë se ishte një dërgesë zyrtare e raporteve të autopsisë nga autoritetet Serbe për Policinë e EULEX-it.

Prandaj ishte e pamundur për trupin gjykues të vleronte si cili autoritet i paraqiti policisë raportet e autopsisë; kjo mungesë absolute e zyrtarizimit nuk mund të lejonte trupin gjykues të vlerësonte egzistencën e kushteve të reciprocitetit (nuk ka dërgim zyrtar të raporteve pra kështu që nuk është e mundshme që të vlerësohet se si erdhën në duart e prokurorit). Prandaj, provat e propozuara nuk mund të pranohen (përveç kësaj palët nuk dhanë pëlqimin për të marrë autopsitë në bazë të Nenit 368 të KPPK).

Vetëm një nga autopsitë e mësipërme kishte të bënte me një trup të paidentifikuar (trupi i Valbona Mirena) dhe në lidhje me këtë autopsi është dhënë nga avokati mbrojtës i Fatmir Pajaziti për të kërkuara raportin e autopsisë (prandaj raporti i autopsisë mund të merret në konsideratë vetëm në lidhje me pozitën e të pandehurit të mësipërm).

Konkluzionet e raportit të mësipërm tregojnë që shkak i vdekjes ishte mbytja/mbytja në ujë, që vërteton vlerësimin tashmë të bërë në arsyetimin që Valbona Mirena ishte në barkë dhe ajo u mbyt në aksident.

2.5. Egzistenca e grupit të organizuar që merret me kontrabandimin e migrantëve.

Provat e paraqitura nga prokurori në të gjithë shqyrtimin kryesor i lejuan trupit gjykues të vërtetojë përtej dyshimit të arsyeshëm egzistencën e një grupi kriminal të strukturuar dhe të organizuar që merret me kontrabandimin e migrantëve nga Kosova për në disa vende të Bashkimit Europian (kryesisht Francë, Gjermani, Austri) dhe në Zvicër.

Ky grup i organizuar kriminal mbështetet në një strukturë solide të bazuar kryesisht në Kosovë dhe në Serbi (por jo vetëm në këto dy vende) që përkundrejt një shumë parash që variojnë nga 3000 deri në 1500 Euro për migrant, kanë mbledhur dhe transportuar migrantë nga Kosova në Serbi, dhe më pas nëpërmjet Serbisë për në Hungari dhe prej aty në vendet e treguara më lart.

Janë të shumta provat që demonstronë praninë e grupit të mësipërm kriminal dhe ato vijnë nga burime të ndryshme.

- **Provat nga dëshmitë.**

Dëshmia e lartpërmendur e B Rregoi qartë se, për të arritur në lumin Tisa, familja ka udhëtuar në disa makina (një Golf nga Prishtina në Gjilan, më pas një Opel nga aty në kufirin me Serbinë, dhe më pas një Passat sapo ata kaluan kufirin dhe për rreth 15 minuta, dhe më pas një Ford deri në qytetin e Suboticës deri sa ata arritën në një shtëpi, dhe më pas prej aty një makinë pick up dhe më pas një Jeep deri sa ata arritën në një pyll dhe më së fundi në barkë).

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Shtatë makina të ndryshme (në fakt tetë, me që për një pjesë të udhëtimit familja ishte ndarë dhe Elvira Jaha me fëmijët ishin transportuar në një Nissan Micra) u përdorën për të bërë transportimin e migrantëve nga Pristina deri tek lumi.

Të gjithë shoferët (secila makinë kishte një shofer të ndryshëm) e dinin saktësisht çfarë të bënin dhe nuk kishte nevojë për migrantët që të jepnin spjegime apo tregonin rreth asaj se ku të shkonin.

Përkundrazi, shumica e shoferëve i thanë migrantëve çfarë të bënin dhe në cilën makinë duhet të hipnin pas mbarimit të çdo pjese të udhëtimit.⁶⁰

Më tej Rama deklaroi se migrantët ishin vendosur për disa orë në një shtëpi: është e qartë se ata nuk ishin pritur, por se ndalimi në shtëpi gjithashtu ishte planifikuar paraprakisht dhe ishte një nga fazat e caktuara të udhëtimit organizuar për të kontrabanduar migrantët jashtë Kosovës.

Prandaj është e qartë se udhëtimi i B R dhe familjes së tij ishte planifikuar me kujdes dhe organizuar paraprakisht dhe se disa individë të ndodhur në Kosovë dhe në Serbi bashkëpunuan për atë plan.

Po ashtu duhet të merret me mend se porsa migrantët të arrinin në bregun Hungarez të lumit Tisa, ti prisnin persona të tjerë për ti çuar ata në dëstinacion.

Në fakt të gjithë dëshmitë e paraqitura tregojnë që migrantët duhej të dërgoheshin në vendin e destinacionit të tyre përfundimtar (ku gjithashtu një pjesë e parave të kontrabandimit supozoheshin të paguheshin) dhe se dikush duhet ti priste ata sapo ata të kishin arritur në Hungari.

Tregimi i Ramës tregon për egzistencën e një strukture të organizuar me shumë njerëz të përfshirë në Kosovë e Serbi dhe në Hungari. Në fakt është thjesht e pamendueshme që Avni Hajdari, personi që bëri marrëveshjen me Ramën për udhëtimin ilegal të kishte ngritur një strukturë të tillë vetëm për udhëtimin fatal të 14 Tetorit.

Pra, mund të merret me mend se struktura e mësipërme ishte funksionale dhe operative në kohën që është organizuar udhëtimi për R dhe familjen e tij.

Një tjetër e dhënë që del nga dëshmia e mësipërme dhe që tregon se Avni Hajdari sigurisht përdorte një mekanizëm egzistues, të strukturuar dhe të mirë vajisur është fakti që R dhe familja e tij nuk u kontrolluan në kufirin midis Kosovës dhe Serbisë (një kufi ku kontrollon, për arsye të njohura, janë të rrepta dhe veçanërisht të përpiktë).

Dhe e njëjta organizatë me siguri u mor me kontrabandimin e familjes Ademi: migrantët arritën marrëveshjen me Ismet Ramën dhe Avni Hajdarin, ndoqën të njëjtën rrugë si R dhe përfundimisht arritën në Suboticë dhe ishin në të njëjtën barkë.

⁶⁰ Procesverbal i 12 Shkurtit 2011, faqet 33 - 34.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Gjithashtu dëshmitë e dhëna nga Agush dhe SH A lidhur me kontrabandimin e të afërmit të tyre Ilir dhe nga dëshmitë e I K dhe SH K për kontrabandimin e familjes Krasniqi vërteton praninë e një grupi të organizuar që merrej me kontrabandimin e migrantëve dhe se Anton Gecaj dhe personi që thërritej Joca ishin njerëzit kryesorë në organizatë dhe se është një lidhje e pamohueshme midis këtyre dy njerëzve dhe dy vëllezërve Ademaj.

- **Dëshmia e dhënë nga Blerim Ademaj.**

Në deklaratën e dhënë nga Blerim Ademaj përpara trupit gjykues janë paraqitur të dhëna të tjera për egzistencën e grupit të strukturuar që përfshin disa nga të pandehurit dhe që kishin qëllim të kontrabandonin migrantët nga Kosova për në vendet e Europës Perëndimore.

Pjesët e dëshmisë që lidhen më këtë paraqiten më poshtë:

Prokurori Publik: E di se me çfarë merrej Anton Gecaj për të siguruar jetesën?

Blerim Ademaj: Ai ishte përfshirë në kontrabandimin e qenieve njerëzore për në Europë, siç na ka thënë ai.

Prokurori Publik: E dini, dhe ju pyes nëse e dini, nëse Anton Gecaj ka kontrabanduar ndonjë pjesëtar nga familja juaj në Europë?

Blerim Ademaj: Po, disa kohë më parë, shumë kohë përpara se ne t'ja shisnim atij makinën, ai kishte kontrabanduar dy kushërinj të mij nga babai.

Kryetari i trupit gjykues: Emrat e tyre?

Blerim Ademaj: Haxhi Ademaj dhe Sejdi Ademaj.

...

Prokurori Publik: Mund të na thoni se cilën rrugë ndoqën ata, pra Sejdiu and Haxhiu?

...

Kryetari i trupit gjykues: Dhe kur ka ndodhur kjo?

Blerim Ademaj: Nuk më kujtohet se kur ka ndodhur, por di që kjo ka ndodhur shumë kohë më parë.

Kryetari i trupit gjykues: Një vlerësim i përafërt?

Blerim Ademaj: 2006 ose 2007.

Prokurori Publik: Cilën rrugë ndoqën ata?

Blerim Ademaj: Serbi, Hungari, Austri, Zvicër.

Prokurori Publik: Me që përmendët Serbinë dhe Hungarinë, a të kanë përmendur kushërinjtë tuaj në fakt ndonjë emër të personave të tjerë përveç Anton Gecajt që mund ta kenë ndihmuar atë?

Blerim Ademaj: Po, përpara se ata të shkonin në një hotel në Suboticë atyre ju tha që ti thonin recepsionistes që ata ishin të Anton Gecajt dhe Jocës.

Prokurori Publik: Ky emri i Jocës, përveç që e keni diskutuar me djemtë e xhaxhait, e keni diskutuar ndonjëherë këtë emër me ndonjë tjetër?

Blerim Ademaj: Me Antonin.

...

Prokurori Publik: Në faqen 7, paragrafi 5 në pyetjen time nëse dikush tjetër kishte përmendur Jocën, ju jeni përgjigjur si vijon: 'emri i Jocës është përmendur gjithashtu nga Caka i cili më tha se do të shkonte në Serbi për të takuar Jocën pasi ndodhi ngjarja.' Të kujtohet të më kesh dhënë këtë deklaratë?

Blerim Ademaj: Në fakt unë po flisja në fillim fare, përpara se të ndodhte ngjarja.

Prokurori Publik: Të kuptova drejt, kjo që unë sapo të lexova është thënë pasi ka ndodhur ngjarja?

Blerim Ademaj: Po.

Kryetari i trupit gjykues: Që do të thotë tragjedia?

Blerim Ademaj: Po.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

...

Blerim Ademaj: Kur Antoni mbylli telefonin e tij për 2 ditë dhe nuk ju përgjigj asnjë telefonate, dhe përpara se ta mbyllte telefonin ai më dha mua dy numra. Njëri ishte numër i Serbisë dhe tjetri ishte i Kosovës.

Prokurori Publik: i telefonove këtyre 2 numrave?

Blerim Ademaj: Unë telefonova vetëm njërin.

Prokurori Publik: Cilin?

Blerim Ademaj: Atë të Serbisë.

...

Blerim Ademaj: Antoni më dha mua numrat e telefonit dhe më tha mua ti telefonoja atij numri dhe në Serbi do të përgjigjej Caka.

Kryetari i trupit gjykues: Caka i kishte të dy këto numra, apo vetëm numrin e Serbisë?

Blerim Ademaj: Vetëm numrin e Serbisë.⁶¹

* * *

Kryetari i trupit gjykues: Prokurorit Publik ju i thatë se Antoni ju tha ju se një nga numrat i përkiste Cakës. Antoni ishte ai që të tha se një nga numrat i përkiste një personi të quajtur Caka?

Blerim Ademaj: Po.

Kryetari i trupit gjykues: Po në të njëjtin rast a të tha ai ndonjë gjë tjetër për një person tjetër të quajtur Joca?

Blerim Ademaj: Po.

Kryetari i trupit gjykues: Cfarë tha ai?

Blerim Ademaj: Antoni më tha se ishte vazhdimisht në kontakt me Jocan që nuk po i thonte Antonit asgjë cfarë kishte ndodhur dhe ai vetëm tha se ishin zënë nga policia.

Kryetari i trupit gjykues: A të tha ai ndonjë gjë se cfarë po bënte Joca?

Blerim Ademaj: Ai më tha se ja kishte kaluar njerëzit atij. Pra, Antoni ja kishte përcjellë ata Jocës.

Kryetari i trupit gjykues: Që cfarë të bënte?

Blerim Ademaj: Ti çonte ata në Austri.

Kryetari i trupit gjykues: Nëpërmjet Hungarisë?

Blerim Ademaj: Po.

Kryetari i trupit gjykues: A të tha ai ndonjë gjë tjetër për rolin për sa i përket se sa i rëndësishëm ishte Joca?

Blerim Ademaj: Ai më thonte që ja kishte përcjellë njerëzve Jocës dhe Joca do ti merrte ata në Austri dhe t'ja dorëzonte Antonit. Anton Gecaj jetonte në Sllovaki.

Kryetari i trupit gjykues: A të tha Antoni ndonjë gjë rreth mardhënieve midis Jocës dhe Cakës?

Blerim Ademaj: Jo.

...

Kryetari i trupit gjykues: Nëse të kuptova drejtë, ju thatë më herët se ju i telefonuat numrit të Serbisë dhe një person i quajtur Caka tu përgjigj; mund ti thuash trupit gjykues për përmbajtjen e bisedës midis teje dhe Cakës?

Blerim Ademaj: Ishte nëse kishte ndonjë të re dhe ne të dy pyetëm njëri tjetrin.

Prokurori Publik: A të tha ky person se ai do të takonte Jocën?

Blerim Ademaj: Po.

Prokurori Publik: Përse?

Blerim Ademaj: Të fliste ndoshta me që unë nuk mund ta kuptoja atë me që Antoni më kishte dhënë numrin e një personi në Serbi dhe tha se ishte Caka dhe ai më tha se ai do të takonte Jocën në Maqedoni ndërsa Joca ishte në Serbi. Unë e kuptova që Antoni më dha mua numrin për të shmangur cdo përgjegjësi.

Kryetari i trupit gjykues: Përse donte të shkonte në Maqedoni Caka të takonte Jocën?

⁶¹ Procesvervali i 13 Majit 2011, faqet 7-10.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Blerim Ademaj: Unë nuk e di.

Kryetari i trupit gjykues: Bajram Tmava, ju kërkoj që të mos flisni.⁶²

* * *

Kryetari i trupit gjykues: Por në procesverbal ka diçka më shumë, 'Unë fola me këtë personin Caka, dhe ai më tha se ai kishte edhe këta njerëzit që i kishte sjellë Antoni dhe se ai kishte planifikuar të shkonte në Maqedoni që të takonte një person të quajtur Hoca.' Cfarë do të thuash ai kishte edhe njerëzit që i kishte dërguar Antoni?

Blerim Ademaj: Unë nuk e di se çfarë donte të thonte ai me këtë, nëse ai i kishte dhënë apo jo njerëzit e tij. Unë doja të dija vetëm për familjen e Shkelzenit.

Kryetari i trupit gjykues: Po, po ti po thua fjalët e Cakës, a janë këto fjalët e tij apo ke ndryshuar ti ndonjë gjë?

Blerim Ademaj: Po, ai i tha këto.

...

Kryetari i trupit gjykues: Kjo fjali të çon tek ajo vijuese, që thotë se ai kishte plan të shkonte në Maqedoni për tu takuar me Jocën që është e qartë që merrej me kontrabandimin e migrantëve. Pa ndonjë sugjerim të avokatëve mbrojtës, a të tha ai përse ai do të shkonte në Maqedoni të takonte Jocën?

Blerim Ademaj: Po, sepse ai nuk dinte ende se çfarë kishte ndodhur me ta? Antoni thonte vetëm se ata ishin paraburgosur.

...

Kryetari i trupit gjykues: Cila ishte arsyeja për Cakën për të shkuar në Maqedoni? Për të marrë informata për ty apo cila ishte arsyeja?

Blerim Ademaj: Për të marrë informata për udhëtarët e tij, ata njerëz që do të transportoheshin.

Kryetari i trupit gjykues: Përse do ta bënte ai këtë për ty? Ju nuk e njihnit njëri tjetrin.

Blerim Ademaj: Jo për mua, por për Antonin. Unë nuk e dija mardhënien.

Kryetari i trupit gjykues: Ju thatë se ai po e bënte këtë për Antonin, ta tha ai këtë apo jo?

Blerim Ademaj: Jo, ai nuk ma tha këtë mua por Antoni më dha numrin e tij. Më pas Antoni më mori mua në telefon dhe hapi telefonin e tij dhe më pas unë fola me Antonin dhe unë nuk fola më me Cakën.

...

Blerim Ademaj: Pastaj dy ditë më vonë Antoni e hapi telefonin dhe më pas unë pata një kontakt me Antonin. Antoni më tha se depozitoi 30,000 apo 20,000 si dorëzani për ata që të liroheshin. Dhe atë ditë Antoni më tha 'Tani do të shkoj të takoj Jocën'. Pastaj unë mora Shkelzenin dhe e dërgova atë në aeroport sepse Antoni ende thonte që ai nuk dinte asgjë çfarë kishte ndodhur.

Kryetari i trupit gjykues: E pyete Cakën nëse ai ishte në Maqedoni apo ta tha vetë ai këtë?

Blerim Ademaj: Unë nuk e pyeta.

Kryetari i trupit gjykues: Pra ai tha, 'Po shkoj në Maqedoni'?

Blerim Ademaj: Po. Ai tha 'Kam qëllim të shkoj në Maqedoni.'

Kryetari i trupit gjykues: Pas këtij kontakti, gjatë të cilit shkëmbyet këtë informacion dhe Caka të tha se ai do të shkonte në Maqedoni, ke patur ndonjë kontakt tjetër me Cakën?

Blerim Ademaj: Jo.

Kryetari i trupit gjykues: Sepse përsëri në procesverbal ju thoni pas këtij diskutimi, 'Ne i kemi telefonuar njëri tjetrit vazhdimisht për të pyetur nëse kishte ndonjë të re'.

Blerim Ademaj: Po.

Kryetari i trupit gjykues: Ke patur kontakte me telefon me Cakën?

Blerim Ademaj: Po, gjatë asaj periudhe.

Kryetari i trupit gjykues: Dhe për çfarë ishin këto kontakte?

Blerim Ademaj: Ne ishim të interesuar të dinim nëse ai dinte ndonjë gjë për atë që kishte ndodhur.

⁶² Procesverbali 13 Maj 2011, faqet 17-19.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Kryetari i trupit gjykues: A shkoi ai në Maqedoni për të folur me Jocën?

Blerim Ademaj: Nuk e di sepse ndërkohë Antoni e hapi telefonin dhe më pas unë nuk e kontaktova atë më.

...

Kryetari i trupit gjykues: Kur të tha Antoni se do të dorëzohej, të tha ai se donte ti tregonte policisë për VIJ?

Blerim Ademaj: Po.

Kryetari i trupit gjykues: Cfarë është VIJ?

Blerim Ademaj: Kur më tha ai që po ndiqte V-në do të thonte një rrugë të caktuar. Ky ishte vendi në të cilën njerëzit supozoheshin të kapërcenin.

Kryetari i trupit gjykues: Ai të tha ty sipas teje, 'pastaj ai më tha do të shkoj në polici ti tregoj atyre për VIJ sepse ata po më akuzojnë mua për VIJ.' Më pas është përgjigja jote kur të pyet Prokurori Publik se çfarë nënkuptonit me VIJ dhe ju thatë se ti mendove që ishte rrjeti i njerëzve që sillnin këta njerëz nga Kosova në Europë

Blerim Ademaj: Ai e quajti atë V.

Kryetari i trupit gjykues: Fillimisht ju thatë ishte rruga dhe më pas kur të ballaqova unë ti the se ishte emri i rrjetit.

Blerim Ademaj: Unë ju thashë ju saktësisht atë që më tha ai.

Kryetari i trupit gjykues: Ju i thatë Prokurorit Publik: se ti mendove që ishte rrjeti i njerëzve që binin personat nga Kosova në Europë, pra ti flet për njerëz të organizuar që e bënin këtë; këto ishin fjalët tuaja.⁶³

Nga dëshmia e dhënë nga Blerim Ademaj dalin disa elemente të qartës dhe të pamohueshëm.

Së pari, deklarata e tij provon egzistencën e strukture të organizuar kriminale që kontrabandoi migrantë nga Kosova në pjesën Perëndimore të Europës. Numri i migrantëve të kontrabanduar nga organizata kriminale (dhe kështu madhësia dhe niveli i zhvillimit të strukturës së saj) ishte kaq i madh sa që një nga anëtarët më kryesorë të organizatës kriminale, Anton Gecaj mund të fitonte rreth 50.000 Euro në javë nga kontrabandimi.⁶⁴

Shifrat e mësipërme janë tronditëse dhe japin një ide të përmasave të trafikimit, kur mendon se çmimi për një migrant të kontrabanduar ishte 3000 Euro për çdo të person të rritur dhe 1.500 për çdo fëmijë nën 12.⁶⁵

Duhet të vihet në dukje se nëse Anton Gecaj vlerësonte paratë që fitonte në javë ishin 50.000 Euro, në fakt paratë e fituara nga organizata duhet të ishin shumë më tepër, përderisa secili

⁶³ Procesverbali 13 Maj 2011, faqet 26-34

⁶⁴ Procesverbali 13 Maj 2011 faqe 32:

Kryetari i trupit gjykues: Të tha Antoni se sa para fitonte nga biznesi i kontrabandimit të njerëzve?

Blerim Ademaj: Gjatë telefonatës së fundit ndërsa po kthehesha për të shkuar në punën time ai më telefoni dhe ne folëm për rreth 40 minuta. Në një farë mënyre ai thjesht po ankohej, duke më thënë mua se nuk donte që të ndodhte asgjë e keqe megjithëse ne nuk kishim ende për tragjedinë, sepse unë kam fituar shumë që nuk mundesha me asnjë biznes tjetër.

Kryetari i trupit gjykues: A të përmendi ai shumën e parave?

Blerim Ademaj: Po. Ai më tha se kishte fituar shumë dhe foli për 30,000 deri 40,000.

Kryetari i trupit gjykues: Ai tha se nuk ishte i interesuar të humbte një biznes që fitonte 50,000 në javë.

Blerim Ademaj: Ai përmendi një shumë të madhe.

Kryetari i trupit gjykues: E konfirmron që ai foli për 50,000 Euro në javë?

Blerim Ademaj: Po ai fitonte deri në atë shumë në javë.

⁶⁵ Procesverbali 13 Maj 2011 faqe 19:

Prokurori Publik: E dini sa ishte çmimi apo a të tregoi Antoni çmimin për një person për tu kontrabanduar jashtë Kosovës?

Blerim Ademaj: Kur e mora atë në telefon në lidhje me I Kn dhe familjen e tij dhe i thashë atij se ai donte të dërgoheshin gruaja dhe fëmijët, ai më tha nga 12 vjeç e lart ishte 3000 për person dhe nën moshën 12 vjeç ishte 1,500 Euro.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

udhëtim përfshinte pjesmarrjen e disa personave (grumbulluesit e migrantëve në Kosovë, shoferët në Kosovë, Serbi dhe Hungari, njerëzit që siguronin llogjistikën dhe ndihmën në Serbi dhe Hungari) siç mund të nxirret në mënyrë të pamohueshme nga tregimi i B R. Këta njerëz janë paguar me siguri nga organizata për shërbimet e tyre.

Së dyti, Anton Gecaj dhe personi i quajtur Joca ishin midis anëtarëve kryesorë të kësaj organizate. Blerim Ademaj deklaroi vendosmërisht që puna e këtyre dy personave ishte kontrabandimi i migrantëve, që do të thotë se ata e bënë atë rregullisht.

Nga deklaratat e Blerimit duken që të jenë të qartë rolet e këtyre dy individëve në organizatë: Antoni ishte përgjegjës për aktivitetin e organizatës në Kosovë dhe, megjithëse jo drejtëpërsëdrejti, por nëpërmjet personave të tjerë (kjo mund të nxirret nga fakti që të gjithë migrantët nuk ishin kontaktuar drejtëpërsëdrejti nga Antoni dhe nga fakti që Antoni, atë kohë, jetonte në Slloveni) mbliidhte migrantë në Kosovë; Joca (dhe njerëzit që punonin për të) ishte përgjegjës për aktivitetin e organizatës në Serbi ndërsa pas kalimit të kufirit Serbi/Hungari duket që Antoni është përsëri përgjegjës (meqenëse paratë e kontrabandimit duhej ti jepeshin atij).⁶⁶

Një tjetër person që del të jetë përfshirë në organizatën e mësipërme është personi që mban pseudonimin Caka/Qaka (*id est* Avni Hajdari).

Për të kuptuar pozitën e tij në hierarkinë e organizatës, merr kuptim të madh se kur Anton Gecaj vendosi të dorëzohej në polici, tregoi Cakën si personin që mund ti jepte Blerimit informacion për fatin e migrantëve, sikur të ishte një lloj zëvendësi i Antonit apo në çdo rast një person që ishte në dijeni të plotë për operacionin e kontrabandimit (me fjalë të tjera jo ushtar në llogore, por një komandanti ushtrisë).⁶⁷

Ja vlen të përmendet se Blerimi shtoi se vetë Caka, duke ju përgjigjur kërkesës së tij për informatat, i kishte thënë atij se ai “gjithashtu kishte njerëz”.

Megjithëse Blerimi ishte i turbullt në lidhje me kuptimin e këtyre fjalëve, nga konteksti del qartë se personi i quajtur Caka/Qaka kishte grumbulluar drejtëpërsëdrejti migrantë që ishin përfshirë në tragjedi.

Interpretimi i mësipërm, që është i vetmi që ka kuptim, është konfirmuar po ashtu nga fjalët e Blerimit që deklaroi se gjithashtu një person nga Mitrovica i kishte thënë atij se “ai i kishte dhënë njerëz Cakës”. Përsëri i vetmi kuptim i mundshëm është se këta persona “të dhënë” ishin migrantë që do kontrabandoheshin nëpërmjet ndërhyrjes së Cakës.⁶⁸

⁶⁶ Procesverbali 13 Maj 2011, faqe 34.

Kryetari i trupit gjykues: Cfarë të tha Antoni për Jocan?

Blerim Ademaj: Ai më tha se ai ja dha njerëzit atij, që do të thotë Antoni Jocas dhe më tej Joca supozohej t'ja jepte atyre Antonit që ti dërgonte ata në Zvicër, sipas Antonit.

Kryetari i trupit gjykues: Është pak a shumë siç ja keni thënë Prokurorit Publik, por ju shtuat, 'E di që Antoni më tha vazhdimisht se ai i kishte dorëzuar njerëzit Jocës.; është e vërtetë?

Blerim Ademaj: Po.

...

Kryetari i trupit gjykues: Mos thatë Joca Cakës apo e kundërta?

Blerim Ademaj: Caka ma ka përmendur mua këtë

⁶⁷ Procesverbali 13 Maj 2011, faqe 17.

⁶⁸ Procesverbali 13 Maj 2011, faqe 30.

Kryetari i trupit gjykues: A të tha ndonjë gjë të vecantë ky personi nga Mitrovica; çfarë bisede patëti me këtë person?

Blerim Ademaj: Unë kam folur me të vetëm një herë.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Një tjetër tregues i lidhshmërisë së rolit të Cakës/Qakës/Hajdarit është dhënë nga fakti që ai e njihnte Joca, ishte në dijeni të rolit të tij në kontrabandimin e migrantëve dhe ishte në gjendje hynte në kontakt me të dhe ta dinte se ku mund ta gjente atë.

Nga të gjithë këto rrethana mund të nxirret përfundimi se Caka/Hajdari kishin një rol të rëndësishëm në organizatën e udhëhequr nga Anton Gecaj dhe Joca (sa për rolin e Cakës, do të egzaminohen në pjesën që ka të bëjë me masat e fshehta).

Së treti, nga deklaratat e paraqitura deri tani, mund të kuptohet lehtësisht përfshirja e madhe e Shpetim Ademajt në aktivitetin e kontrabandimit të migrantëve. Vëllai i tij Blerimi specifikoi se Shpejtimit transportoi njerëz në Gjilan në emër të Antonit duke marrë 200 Euro për çdo udhëtim.
69

Edhe pse Blerimi nuk mundi (ose nuk deshti) te tregojë se sa udhëtime Shpetimi i ka bërë në emër të Antonit, nga numri i madh i të kontrabanduarve nga ky i fudnit mund të nxirret se udhëtimet e bëra nga Shpëtimi ishin të shumta.

Në fakt Antoni i tha Blerimit se vëllai i tij “i kishte punët mirë në Kosovë” dhe se, pas arrestimit të tij, Antoni ishte i gatshëm të paguaj një sasi të madhe të parave që t’i ndihmojë Shpejtimit (kush e di se në ç’mënyrë), duke treguar një lidhje të ngushtë ndërmjet të dyve që nuk mund të arsyetohet thjesht me udhëtimet që janë bërë nga Shpëtimi në emër të Antonit.

Kryetari i trupit gjykues: A të tha ai ndonjë gjë tjetër për Cakën?

Blerim Ademaj: Ai më tha që ja kishte dhënë njerëzit atij.

Kryetari i trupit gjykues: Cfarë do të thotë kjo?

Blerim Ademaj: nuk e di çfarë donte të thonte.

⁶⁹ Procesverbali 13 Maj 2011, faqe 35-37:

Kryetari i trupit gjykues: A bënte vëllai jot, me sa di ti, ndonjë punë për Antonin?

Blerim Ademaj: Unë e kam dëgjuar vetëm ku ai foli në telefon se unë vij në Kosovë vetëm një herë në vit.

Kryetari i trupit gjykues: Cfarë degjove?

Blerim Ademaj: Ai më tha se i kishte telefonuar Antonit dhe i kishte kërkuar atij të merrte disa njerëz nga Gjilani.

Haxhi Millaku: Jo disa njerëz, dikë. Mund ta përsërisni ju lutem?

Kryetari i trupit gjykues: Lëre atë të mbarojë fillimisht.

Blerim Ademaj: Mund të ketë qenë një apo njëqind.

Kryetari i trupit gjykues: Ajo çfarë thonte Shpejtimit Ademaj kishte të bënte për një person apo më tepër se një?

Blerim Ademaj: Unë vetëm e dëgjova atë të fliste në telefon. Ai tha se ai do të më japë 200 Euro. Dhe për informacionin tuaj ne nuk kemi nevojë për 200 Euro apo për ndonjë shumë tjetër.

Kryetari i trupit gjykues: Dha kush?

Blerim Ademaj: Se ai, do të më jepte mua 200 Euro, duke ju referuar këtij të fundit.

Kryetari i trupit gjykues: Anton do t’i japë Shpejtimit?

Blerim Ademaj: Po.

Kryetari i trupit gjykues: Sepse kur jeni intervistuar përpara Prokurorit Publik, ju thatë si më poshtë, nëse ka problem me përkthimin avokat, më le të finish së pari. ‘Kur e pyeta Shpejtimitin rreth kësaj, ai më tha se po ndihmonte disa njerëz të varfër, që ishin në vështirësi dhe po i dërgonte ata në Gjilan’.

...

Kryetari i trupit gjykues: ‘Kur të më thotë Antoni dhe Antoni do të më japë 200 Euro’.

Blerim Ademaj: Që i referohet të ardhmes.

Kryetari i trupit gjykues: ‘Dhe Antoni do më japë 200 Euro për një grup’.

Blerim Ademaj: Në fakt për makinë.

Kryetari i trupit gjykues: Do të thuash për një udhëtim?

Blerim Ademaj: Për një udhëtim.

Kryetari i trupit gjykues: Në fakt ju thatë specifikuat që do të thotë se ai se ai do të merrte 200 Euro për një udhëtim me makinë për në Gjilan.

Blerim Ademaj: Yes.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Deklarata e Blerimit lë të kuptohet me kuptimin se Shpejtimi ishte njëri ndër personat kryesor që punonte në Kosovë për Antonin (të dhëna të tjera vendimtare do të ipen nga shqyrtimi i masave të fshehta).

Kurse Shpejtimi ishte njëri nga njerëzit e Antonit në Kosovë dhe vullnetarisht konfirmohet me deklaratën e vet Shpejtimit kur e pranoi se ai u jepte emigrantëve informata që i merrte nga Antoni lidhur me çmimet e uhëtimeve të ndryshme⁷⁰.

- Rezultatet e masave të fshehta të lëshuara kundër të pandehurve

Gajtë hetimeve numrat e telefonit ne vijim kane qenë objekt i masave të fshehta apo përgjimit të telekomunikimeve të lëshuar nga ana e Gjyqtarit të Procedurës Paraprake me kërkesë të Prokurorit:

044 610 955, 044 260 626, 044 117 924, 044 278 144, 044 249 952, 044 574 980.

Sa i përket numrave të tëlëfonit si në vijim prokurori lëshoi masa të fshehta të matjes së thirrjeve telefonike të numrave:

044 661 892, 044 264 655.

Tekst mesazhet dhe thirrjet telefonike që janë shkëmbyer në disa nga numrat e sipërme, japin mbështetje të fortë sa i përket ekzistimit të strukturës së grupit të organizuar që merrej me kontrabandimin e emigrantëve, lejojnë të nënvizohet me më përpikmëri roli i disa anëtarëve të organizaatës kriminale (e që janë Caka/Hajdari dhe Spejtim Ademaj dhe përshkruajnë rolin e përfshirjes në këtë grup kriminelësh të individëve të tjerë (e që janë Shaip Selmani dhe Ismail Krapit) të cilët nuk janë përmendur në ndonjërin nga deklaratat gjatë hetimeve ose gjatë zhvillimit të shqyrtimit kryesor.

Teks mesazhet e dërguara dhe të pranuar nga Shpetim Ademaj.

⁷⁰ Procesverbal i datës 15 Prill 2011, faqe 18-20:

Kryetari Trupit Gjyqësor: Si u bë që juve u përgjigjet '4,500'. Duket se juve ishit të informuar lidhur me çmimet për të kontrabanduar njerëzit jashtë.

Shpejtim Ademaj: Kur dëgjojë fjalën "hej" mund t'i referohet një kushëriri tim; një kushëri imi ka mund të përdorë këtë shprehjen "hej". Ju thash se e kisha shëqërbyer Antonin, pastaj iu përgjigja në mënyrën si më është drejtuar.

Kryetari Trupit Gjyqësor: Si është e mundur që ju i dini se cilat janë çmimet?

Shpejtim Ademaj: Ai na i tregoi.

Kryetari Trupit Gjyqësor: Pra juve i dinit çmimet sepse Antoni ua kishte treguar?

Shpejtim Ademaj: Po.

Kryetari Trupit Gjyqësor: Si është e mundur që Antoni ishte në dijeni të çmimeve për të dërguar njerëzit jashtë vendit, a ishte kjo puna/profesionit i tij?

Shpejtim Ademaj: Ju thash se ai ishte njëri që bënte këtë, i cili e dërgoi djalin e axhës.

...

Kryetari Trupit Gjyqësor: Po lidhur me një SMS që është dërguar nga 044 960 912, SMS-i i parë është i datës 30 Gusht 2009, që ishte dërguar në telefonin tënd të mobilit. Nuk ka asgjë për nesër, po shoferat në Gjilan që të na dërgojnë në Suboticë, a janë në dispozicion". Kurse më datë 31 Gusht 2009 nga numri i njëjtë në numrin tënd: "Jemi në Fushë Kosovë dhe do të jemi në Gjilan për rreth, a ke undësi me ma dërgu numrin e shoferit". Pastaj kemi një përgjigje nga telefoni yt me numër, '003816554598156'. Pastaj ky person ju shkruan përsëri dhe ju pyet: 'si e ka emrin Shpet, a është 150 nga Gjilani deri në Suboticë?' Kurse prej jush kemi një përgjigje: 'Po. Emrin e ka Meti'. Cili është shpjegimi i juaj për shkëmbimin e këtyre SMS-ve?

Shpejtim Ademaj: Nuk e di. Nuk më kujtohet ky numër. Është e mundur se ai ka biseduar me Antonin, ose ndoshta unë kam biseduar me atë, dmth Antonin dhe personat e tjerë.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Shpetim Ademaj e pranoi përpara Trupit Gjykses se ishte shfrytëzues i numrit të telefonit 044 661 892⁷¹

Në numrin e lartë disa tekst mesazhe janë regjistruar. Ia vlen të raportohen disa prej tyre.

- o Tekst mesazhet e shkëmbyera me një person të pidentifikuar që përdorte numrin 044 420 310;

më 12/09/2009 është dërguar tekst mesazhi si në vijim nga numri i sipërm për në numrin që e përdorte Shpejtimi: *“Hej, mos u vono sepse ata të dy i kanë paret për nesër, ata janë gati për nesër, më trego se kur do të vish”*;

më 13/09/2009 është dërguar tekst mesazhi si në vijim nganumri i sipërm për në numrin që përdorej nga Shpejtimi: *“hej, njerëzit po të presin, Shpejtimit çfarë po don t’ju themi; ata janë për nesër, hajde nja 5 minuta”* kurse po atë ditë Shpejtimi u përgjigj: *“Do t’i nisi nesër”*.

- o Tekst mesazhet e shkëmbyera me një person të pidentifikuar që përdorte numrin 044 665 674:

Më 23/08/2009 është dërguar teksti si në vijim nga numri i sipërm për në numrin e telefonit që përdorej nga Shpejtimi: *“3 të rritur dhe 2 fëmijë për në Vjenë, sa me ju thonë”*

- o Tekst mesazhet e shkëmbyera me një person të pidentifikuar që përdorte numrin 044 927 759:

Më 06/08/2009, tekst mesazhi si në vijim është dërguar nga numri i sipërm në numrin që ishte në përdorim të Shpejtimit: *“Muharrem 044 927 759, a i ke nisë”* dhe të njëjtën ditë Shpejtimi u përgjigj: *“Po”*;

Po të njëjtën ditë përsëri Muharremi i shkroi Shpejtimit: *“OK, unë qe sa mbërriva, më trego se kur nisen nga Subotica sepse ai do t’i jep 1700 këtu”* Kurse Shpejtimi u përgjigj: *“Po dhe thuaji që ta aktivizojë numrin e Zvicrës”*.

- o Tekst mesazhet e shkëmbyera me një person të pidentifikuar që ishte në përdorim të numrit 044 805 279:

më 25/08/2009, është dërguar tekst mesazhi si në vijim për në numrin që ishte në përdorim të Shpejtimit: *“Hej, sa deri në Zvicër për një fëmijë tre muajsh dhe një grua”* dhe po atë ditë Shpejtimit u përgjigj: *“4500”*;

po atë ditë personi i nëjtë pyeti me një tekst mesazh: *“sa deri në Francë”* kurse përgjigjia e të pandehurit ishte *“3”*.

- o Tekst mesazhi i shkëmbyer me një person të pidentifikuar që ishte në shfrytëzim të numrit 044 960 912:

⁷¹ Procesverbal i datës 15 Prill 2011, faqe 9

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

më 30/08/2009, është dërguar tekst mesazhi si në vijim nga numri i sipërm për në numrin që ishte në përdorim të Shpejtimit: *“Nuk ka asgjë për nesër, po shoferat në Gjilan që të na dërgojnë për në Suboticë, a janë në dispozicion”*;

më 31/08/2009 personi i nëjtë e dërgoi tekst mesazhin Shpejtimit: *“Tash jemi në Fushë Kosovë, do të jemi në Gjilan për pak ma shumë se një orë, a ma dërgon numrin e shoferit”*. Kurse Shpejtimi u përgjigj: *“003816554598156”*; pastaj personi i panjohur dërgoi një tekst plotësues: *“si e ka emrin ai, shpet, a është 150 nga Gjilani deri në Suboticë”*, kurse Shpejtimi u përgjigj: *“Po dhe emrin e ka Meti”*.

- o Tekst mesazhi i dërguar një personi të paidentifikuar që ishte në përdorim të numrit 41767009984;

Më 12.08.2009, është dërguar tekst mesazhi si në vijim nga numri i sipërm për në numrin e Shpejtimit:

“Këta do të vijnë në Llozanë 0762334925, Kemali do t’i jep 3000 euro” kurse më vonë *“baba i tij vjen me i marr në...”*

Mesazhet flasin vet për vete pa pasur nevojë të elaborohet kuptimi i tyre. Tekst mesazhet tregojnë përfshirjen e të pandehurit në një veprim masiv të kontabandimit, i cili për nga dimezionety sjell padyshim një organizatë stabile dhe mirë të rrënjësuar me definim të qartë dhe të qëndrueshëm të roleve në mes të pjesëmarrësve të ndryshëm (ashti siç ishte e qartë nga rrëfimi i B R në lidhje me fazat e ndryshme të duhëtimit jashtë Kosovës).

Përveç kësaj, teksti i sipërm se roli i Ademajt ishte i rëndësishëm e jo, siç përpiquej të demonstrojë gjatë shqyrtimit të tij, thjesht një shofer që punonte për Anton Gecaj dhe apsolutisht i pavetëdijshëm për arsyet pse i transportonte këta njerëz për në Gjilan. Përkundrazi, nga mesazhet e sipërme duket qartë se i pandehuri merrej me çmimin e kontrabandimit me shoferët që transportonin emigrantët nga Gjilani deri në kufi dhe madje vendoste lidhur me datën e nisjes së emigrantëve. Me fjalë të tjera tekst mesazhet flasin për vetvete nga dëshmitë lidhur me epizoda të veçanta të kontabandimit dhe nga rrëfimi i vëllaut të tij, Blerimit se Shpejtimi ishte njëri që punonte në Kosovë për Antonin dhe për organizatat kriminale të udhëhequra nga ai, i cili aranzhoi dhe kontrolloi kontrabandimin e emigrantëve jashtë Kosovës.

Poashtu rasti është që të shtohet se tekst mesazhet ofrojnë poashtu një vërtetim të fuqishëm dhe të pamohueshëm të besueshmërisë së deklaratave të dhëna nga dëshmitë lidhur me përfshirjen e Ademajt në lidhje me epizodat e vetmë të kontrabandimit.

I pandehuri është ballafaquar tejprtej gjatë shqyrtimit kryesor me përmajtjen e shumicës së tekst mesazheve të cekura më lartë, por ai nuk mund të ofronte ndonjë sqarim bindës për gati asnjë prej tyre; ndonjëherë ai pretendonte se kishte marr mesazhe por nuk e dinte për se mesazhe të këtilla i dërgoheshin atij, në disa raste tjera pretendonte se thjesht nuk i kujtohej,

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

kurse në disa raste të tjera thjesht jepte informata njerëzve pa qenë i përfshirë në ndonjë formë në kontrabandim.

Prandaj, mungesa e sqarimit alternativ bindës që janë dhënë nga ana e të pandehurve përforcon konkluzionin rreth ekzistimit të një grupi kriminal të organizuar dhe të strukturuar, i cili së paku gjatë periudhës 2009 (por nga dëshmitë mund të nxirret se së paku Antoni ishte përgjegjës për kontrabandimin e imigrantëve shumë kohë më parë) ka kontabanduar një numër të madh të imigrantëve jashtë Kosovës për në vendet e Europës perëndimore dhe rreth pjesëmarrjes së Shpejtim Ademajt në grupin e sipërm kriminal.

Tekst mesazhet që i dërgoi dhe i pranoi Shaip Selmani

Shaip Selmani e pranoi se numri 044 260 626 ishte numri i telefonit të tij⁷² dhe se, madje edhe pse telefoni i tij celular ishte poashtu në dispozicion gjatë orarit të punës për nëpunësit e kompanisë që ai së bashku me Ismail Krapin e udhëhiqnin⁷³, numri i sipërm i telefonit sihte në shfrytëzim kryesisht nga vet ai⁷⁴.

Dhe se Shaip Selmani ishte personi që ka përdorë numrin e sipërm pjesën më të madhe të kohës dëshmohet me faktin se në disa mesazhe ai është cekur me emër (Shaip); përveç kësaj vlenë të cekët se shumë nga mesazhet janë shkëmbyer vonë në mbrëmje, pas orarit të punës, pra kur nëpunësit e kompanisë nuk mund ta përdornin celularin.

⁷² Procesverbali i 18 Prillit 2011, faqe 23:

Prokurori Publik: A mund t'i tregoni gjyqit se cili ishte numri i telefonit që juve e kishit në posedim?

Shaip Selmani: 044 260 626. Ky ishte numri im personal si dhe numri i kompanisë që neve e udhëhiqnim.

Prokurori Publik: A keni marr një kopje të raportit të masave të fshehta?

Shaip Selmani: Po.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: A mund të jeni më i përpiktë me përgjigjet që dhatë në lidhje me numrin, çfarë ishte kompania dhe çfarë mëndoni me shprehjen "neve"?

Shaip Selmani: Kompania quhej Migros, mishtore. Ishte kombinim i tregut dhe përbëhej prej dy bizneseve: mishtore dhe fruta me perime, si dhe ishte e regjistruar me numër të njëjtë.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: Çfarë nënkupton me "neve"?

Shaip Selmani: Unë dhe Ismail Krapin e udhëhiqnim kompaninë.

⁷³ Procesverbal i 18 Prillit 2011, faqe 23:

Kryetari i Trupit Gjyqësor: Po, por kushe shfrytëzonte numrin 044 260 626?

Shaip Selmani: Unë dhe nëpunësit e mi në kompani e shfrytëzonim këtë numër.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: Po Ismail Krapin?

Shaip Selmani: Ismail Krapin e përdorte numrin e vet. Nëpunësit e shfrytëzonin numrin e Ismail Krapin. Këto dy numra i shfrytëzonim të gjithë ne.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: Pra, poashtu numri 044 260 626 përdorej nga Ismail Krapin dhe nëpunësit e tjerë.

Shaip Selmani: Unë dhe punëtorët e përdornim.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: A përdorte Ismail Krapin këtë numër?

Shaip Selmani: Kur isha në mishtore, Ismail e përdorte gjithashtu.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: Kush ishte pronar i telefonit me këtë numër të telefonit?

Shaip Selmani: E keni fjalën për numrin me 626?

Kryetari i Trupit Gjyqësor: Po.

Shaip Selmani: Unë isha mbajtës i këtij telefoni, por kur largohesha nga lokali, e lëja aty.

⁷⁴ Procesverbali i datës 18 Prill 2011, faqe 25:

Kryetari i Trupit Gjyqësor: Pra, nga Qershori deri në Tetor 2009, ishit vetëm ju ai që përdorte këtë numër të telefonit?

Shaip Selmani: Zakonsihte e përdorja unë atë numër të telefonit, por ka ndodhë që të tjerët e përdorin.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Posa u sqarua se Shaip Selmani ishte shfrytëzues i numrit të sipërm, tekst mesazhet e shkëmbyera në këtë numër mund të ekzaminohen.

- Tekst mesazhet e shkëmbyera me Shpejtim Ademajn që përdorte numrin 044 661 892;

○

më 24/08/2009 Shpejtimi i dërgoi Shaipit tekst mesazhin në vijim: “004436508707725”;

më 25/08/2009, në orën 10.46 Shaipi i dërgoi Shpejtimit tekst mesazhin në vijim: “shok, kur po ta merr mendja e krym atë jaranin”; pastaj në orën 13.16 e dërgoi një tekst mesazh tjetër: “shok, në çfarë ore po planifikon me i përcjellë”; dhe përfundimisht në orën 20.59 ai dërgoi një tekst tjetër: “A ka gjasa me ndodhë ajo shumë shpejtë, shok”;

më 14/09/2009, tekst mesazhin në vijim e dërgoi Shaipi numrit të sipërm: “0654698254, a mundesh të lutem me dërgu një mbushje”;

më 25.09.2009 tekst mesazhin në vijim Shaipi ia dërgoi Shpejtimit: “a është nisë autobusi”, kurse Shpejtimi u përgjigj: “po”;

më 01/10/2009 Shpejtimi ia dërgoi Shaipit tekst mesazhin në vijim: “1506001001977575 shpejtim ademaj”(ia vlen të cekët se numri i sipër është numri i xhirollogarisë bankare të Shpejtim Ademajt, siç rezulton nga raporti i policisë të datës 22 Shkurt 2010, numri i referencës DOC-FIU 041/2010).

Përveç kësaj, përndër faktit se Shpejtim Ademaj dhe Shaip Selmani e mohojnë se njohin njëri tjetrin, ata kanë shkëmbyer 53 thirrje telefonike siç rezulton nga raporti i policisë të frimosur nga R Z DOC, të datës 25 Nëntor 2009, numri i referencës së dokumentit të policisë 2099 DKKO 034.

- Tekst mesazhi i dërguar personit të paidentifikuar, me emrin Ismet, që përdorte numrin +41767391766 (prokurori pretendon se numri i sipërm i takon Ismet Ramës, por në të vërtetë asnjë provë nuk i është orfuar gjyqit lidhur me lidhjen e Ramës me këtë numër në fjalë):\

Më 31/08/2009, në orën 11.47, Shaipi ia dërgoi tekst mesazhin në vijim: “Ismet, thirrëm” dhe në orën 23.59 ai dërgoi mesazhin në vijim: “Tregom çka je tuj bo nesër”;

Më 03/09/2009 në orën 10.44 Shaipi ia dërgoi tekst mesazhin në vijim: “Ismet, a ke mujt me e kontaktu Ardianin se une nuk po muj dhe me pas ditë që ma bon kto, nuk e kisha marr, krejt ia kom rregullu”.

- Tekst mesazhet e shkëmbyera me Ismail Krapin, i cili ishte në përdorim të numrit 044 117 924 (siç do të demonstronohet në pjesën e arsyetimit që ka të bëjë me këtë të fundit):

○

Më 15/07/2009 në orën 11.04 Ismaili ia dërgoi Shaipit tekst mesazhin në vijim: “jemi ngat ujit” kurse Shaipi u përgjigj: “Mirë”;

Më 30/07/2009 Shaipi ia dërgoi këtë tekst mesazh Ismailit: “Bac, merre këtë numër 129830, ai do të pret në kafen Dardani, ai është prej Vushtrrie, thuji se je Shaipi sepse ai nuk më njeh, numri i tij është 044, nuk kam mbushje në telefon, nuk po muj me arrdh atje qysh u murrëm vesh dje”.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Më 09/08/2009 Shaipi ia dërgoi një tekst mesazh Ismailit si në vijim: “A janë nisur”, kurse Ismaili u përgjigj: “Po, po, janë kthye përsëri në banesë”;

Më 02/09/2009 Shaipi I dërgoi Ismailit një tekst mesazh sin ë vijim: “Buc, a janë nisë delet”, kurse Ismaili u përgjigj: “po, po, moti”;

Më 11/09/2009 Shaipi ia dërgoi Ismailit një tekst mesazh si në vijim; “a i ka marr ata”, kurse Ismaili u përgjigj: “Po, po, ai i morri por ai ju morri edhe shumë pare gitihastu”.

- o Tekst emsazhi i dërguar një personi të pidentifikuar, me emrin Afrim, i cili përdorte numrin +31644493317:

Më 11/09/2009 Shaipi e dërgoi këtë tekst mesazh: “Afrim, a mundesh me kry diçka me atë lidhjen e shpejtë ashtu si ja ke bo ma përpara, me i marr drejtpërdrejtë për në Francë sepse gaka po thot se i merr ata por veç për 1600 për njeri deri ne Vjenë”

- o Tekst mesazhet që janë pranuar nga një person i pidentifikuar, i cili përdorte numrin 044 956 023:

Më 27/09/2009 në orën 14.32 Shaipi e ka marr nga numri i sipërm një tekst mesazh si në vijim: “Shaip, kemi qenë të ngujuar për kohë të gjatë këtu në këtë pyll në kufi të Serbisë, ai djali na ka lënë këtu dhe nuk është kthye fare, dëgjo, mundohu ta kontaktosh sepse jemi të ngujuar këtu në pyll”.

- o Tekst mesazhet e dërguara një personi të pidentifikuar, i quajtur Enver, i cili përdorte numrin+41794756200:

Më 16/08/2009 në orën 11.35, Shaipi dërgoi tekst mesazhin si në vijim: “Lel, qysh t’u duk në anije, a ishte mirë, ku je tash” kurse në orën 20.32 ai e dërgon një tekst tjetër: “jaran, a keni mbrri atje hala”;

Më 30/09/2009 Shaipi dërgoi tekst mesazhin në vijim: “Enver, mos shko sepse ai i merr ata në (paqartë v.j.)”

- o Tekst mesazhet e shkëmbyera më një person të pidentifikuar, i quajtur Smajl, i cili ishte në shfrytëzim të numrit: 044 303 873:

Më 18/06/2009 në orën 22.08 Smajli e dërgon tekst mesazhin si në vijim: “një fugon nuk mund të mbijetojnë gjatë, ndoshta e njeh atë Skendën që ka hekur në zemër, nuk duhet të kalojmë nëpër ujë, më trego kur të bjen diçka në mend”.

Më 20/06/2009 në orën 23.03 Shaipi ia dërgon Smajlit tekst mesazhin si në vijim: “Smalj, ata kanë mbrri në banesë, sonte ata flejnë këtu, nuk kanë dhënë pare askund qysh e bojshe ti t’madhe”;

Më 21/06/2009 në orën 21.20 Smajli ia dërgoi Shaipit këtë tekst mesazh: “hej, ndoshta bon diçka sonte sepse ai tha se atje është ma vështirë se sa në burg, ata janë nguju brenda, kurse ai po ju blen ushqim, 40 euro për natën e mbrëmshme kurse 40 euro për sonte” kurse në

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

orën 21.28 Shaipi përgjigjet: *“Smajl, o njeri, askush nuk i mbyll ata brenda, natyrisht se nuk lejohen me dal në qytet sa i përket pohimit tënd se është keq, askush nuk është anku te unë deri tash sepse ata e kanë si në shtëpi të tyre”*

Më 25/06/2009 në orën 12.04 Smajli ia dërgon Shaipit këtë tekst mesazh: *“hej, fola me Skendën, ai tha se taxi po vjen me na marr por ata kanë me kalu nëpër Gjermani e jo Zvicër”*.

- Tekst mesazhi i dërguar një personi të paidentifikuar, me emrin Sheremet, i cili shërbehej me numrin 393200305183:

Më 06/09/2009 Shaipi e dërgoi këtë tekst: *“Sheremet, çka do t’bojm me këta djem, ata po thojn se paret për ata të dy janë te tik, kurse pse ata po më thojnë se ata duhet me i dërgu 5400 për të dy dhe po thojn se sot e kanë ndërmend me u nis”*.

- Tekst mesazhet e dërguara një personi të paidentifikuar, i quajtur Naser, i cili shërbehej me numrin 393284191917:

Më 24/08/2009 në orën 18.50 Shaipi e dërgoi këtë tekst mesazh: *“Ai do të nisët nesër pasdite, sot nuk bon, ai do të jetë si në shtëpi të vete, mos baj merak”* kurse në orën 20.59 një tekst tjetër: *“Naser, do ta sjelli tek ti më makinë shok, dhe po qe se dëshiron me e marr personalisht në Vjenë, t’i hjeqi 500 euro”*.

Përsëri tekst mesazhet e sipërme flasin për vete dhe qartë, pa pasur nevojë të elaborojmë aq shumë domethënjen e tyre.

Për shebull, në lidhje me tekst mesazhet e shkëmbyera me personin e paidentifikuar, të quajtur Ismail nga data 18 deri 25 Qershor 2009, është e mundur të kemi një pamje të qartë të të gjitha fazave të procesit të kontrabandimit (udhëtimi me fugon, frika se personi do të duhet të kalojë lumin, arritja në shtëpi, kushtet e vrazhda të emigrantëve në shtëpitë në Suboticë ku emigrantët ishin disi në izolim dhe nuk mund të largoheshin⁷⁵, arranzhimet që të arrijnë në destinacionin e tyre përfundimtar).

Tekst mesazhet tregojnë përfshirjen e të pandehurit në veprimin masiv të kontrabandimit të emigrantëve dhe pjesëmarrjes së tij në organizimet kriminale të udhëhequra nga Anton Gecaj dhe i cili sigursisht llogarit Avni hajdarajn (poashtu i njohur si Qaka/Caka) dhe Shpejtim Ademaj në mesin e anëtarëve prominent.

Përveç kësaj mesazhet e shkëmbyera me këtë të fundit e bëjnë të qartë se Shaipi ishte ngushtë duke bashkëpunuar me Ademajn në kontrabandimin e emigrantëve, prandaj ata merrnin pjesë në organizatën e njëjtë.

⁷⁵ Lidhur me specifike, shih deklaratën e Muharem Ramadanit, të datës 10 Nëntor 2009 dhe 10 Maj 2010 që është marr në pajtim me Nenin 368, Par.I, pika 1 e KPPK-së.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Nga kërkesa që Shaipi ia dërgoi Ademajt për mbushje të kartelës së tij telefonike dhe nga përmbajtja e vet tekst mesazheve duket se Selmani (e poashtu partneri i tij Krapit) ishin përgjegjës për kontaktet me emigrantët (para dhe pas udhëtimit), si dhe për grumbullimin e parave prej tyre (paratë t'i ipen Ademajt pastaj), prandaj mbante një post më pak të rëndësishëm se Ademaj, i cili kishte kontakte direkte me udhëheqësit e organizatës (dhe në veçanti me Anton Gecajn).

Tekst mesazhet e dërguara personit të paidentifikuar me emrin Afrim ofron një vërtetim të fuqishëm dhe solid të konkludimit tanimë të ekspozuar lidhur me rolin e Qaka/Cakas në organizatën kriminale që mirrej me kontrabandimin e emigrantëve. Qaka nuk ishte vetëm anëtar i asaj organizate, por roli i tij ishte me rëndësi, meqë ishte në gjendje të caktojë çmimin dhe të vendosë nëse dhe kur mund të kontrabandohej një person.

Tekst mesazhi i sipërm poashtu tregon lidhjen në mes të Selmanit dhe Hajdarit (poashtu i njohur si Caka/Qaka), duke e bërë të qartë se të dy ata, së bashku me Shpejtim Ademajn kanë punuar për organizatë kriminale të njëjtë të udhëhequr nga Antoni dhe Joca.

I pandehuri ishte në detaje i ballafaquar gjatë shqyrtimit kryesor me përmbajtjen e shumicës së tekst mesazheve të sipër cekura, por nuk ishte në gjendje të ofrojë ndonjë sqarim bindës për shumicën e tyre: ndonjëherë pretendonte se thjeshtë kishte pranuar mesazhin, por nuk e dinte për se një mesazh i ishte dërguar atij, në disa raste ai pretendon se thjeshtë nuk i kujtohej, kurse në disa raste mesazhet nuk i kishte dërguar ai, por njerëzit e tjerë.

Mungesa e ndonjë sqarimi alternativ bindës që është dhënë nga i pandehuri përforcon konkludimin lidhur me ekzistencën e një grupi të organizuar, i cili së paku gjatë gjithë vitit 2009 (por nga dëshmitë del se së paku Antoni ishte përgjegjës për kontrabandimin e emigrantëve shumë kohë më parë), kontrabandoi një numër të madh të emigrantëve jashtë Kosovës për në shtetet e Europës Perëndimore si dhe rreth pjesëmarrjes së Shaip Selmanit në grupin e cekur lartë kriminal.

Tekst mesazhet që i dërgoi dhe i morri Ismail Krapit

Ismail Krapit e pranoi se numri telefonik 044 117 924 ishte numri i tij i telefonit,⁷⁶ edhe pse pretendonte se poashtu njerëzit që punonin në kompani që e udhëheqnin përdorin, meqë ai e linte celularin në lokalet e kompanisë së tij.⁷⁷

⁷⁶ Procesverbal i datës 12 Maj 2011, faqe 3

⁷⁷ Procesverbal i datës 12 Maj 2011, faqe 5:

Kryetari i Trupit Gjykoës: Po celulari ku kartelja me këtë numër ishte vënë, a ishte i juaji apo i kompanisë?

Ismail Krapit: Unë jam pronar i kompanisë, prandaj është i imi.

Kryetari i Trupit Gjykoës: Cilët njerëz të tjerë shërbeheshin me celularin tën nëse e din?

Ismail Krapit: Kur them se ishin 22 njerëz të punësuar aty, do të thotë se ata bënin thirrje. Kompania kishte nevojë të bënte thirrje lidhur me porositë e ndryshme dhe telefoni ishte në tavolinë, një tavolinë të veçantë.

Kryetari i Trupit Gjykoës: Ku në zyrën tënde?

Ismail Krapit: Nuk ishte zyre; ishte në shërbim afër kafenesë.

Kryetari i Trupit Gjykoës: Pra ti e lije telefonin tënd aty?

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Vlenë të ceket se verzioni i sipërm i dhënë nga Ismaili duket jo bindës dhe i pabesueshëm. Në fakt, meqë ishte afarist, është e qartë se ai kishte nevojë të jetë i arritshëm (nuk kishte celular tjetër): nuk kishte ndonjë numër tjetër): prandaj ka shumë pak të ngjarë që, përveç disa rasteve të rralla, ai nuk e merrte telefonin celular me vete kur largohej nga vendi i punës.

Për më tepër, shumë nga tekstet e mesazheve ishin dërguar apo pranuar natën vonë ose, në ndonjë rast, jashtë orëve të punës, gjë që e bën jotë bindshme që telefoni celular është përdorur, në atë moment të veçantë, nga punonjësit e kompanisë.

Ndonjëherë në përmbajtjen e teksteve të mesazheve është përmendur pseudonimi i të pandehurit (Buc)⁷⁸ dhe herë të tjera është përdorur emri i tij i shkurtuar (për emrin Ismail).

Një fakt tjetër mbështetës në këtë rindërtim të ngjarjeve jepet edhe nga fakti, kur telefoni celular është përdorur nga persona të tjerë (dhe kjo ka ndodhur vetëm dy herë, një herë nga partneri i tij i biznesit Shaipi dhe herën e dytë nga një person i quajtur Milaim), emri i dërguesit është treguar në tekst, duke nënvizuar kështu që dërguesi nuk ishte Ismaili si zakonisht, por një person tjetër.

Të gjitha këto konsiderata të çojnë në përfundimin që numri i mësipërm i telefonit është përdorur pothuajse ekskluzivisht nga Ismail Krapit.

Pasi është sqaruar se Ismail Krapit ka qenë përdoruesi i numrit të mësipërm, tekstet e mesazheve të shkëmbyera në këtë numër mund të ekzaminohen.

- o Tekstet e mesazheve të shkëmbyera me Shpejtim Ademajn duke përdorur numrin e telefonit 044 661 892:

më 9/08/2009, teksti i mëposhtëm i është dërguar Shpejtim Krapit nga Krapit: “*Mbushë kreditin e këtij numri edhe një herë 0656331837*”;

më 11/08/2009, teksti i mëposhtëm i është dërguar Shpejtim Krapit nga numri i mësipërm: “*A mund ta mbushësh këtë numër me 200 dinarë 0655008531*”;

më 24/08/2009, teksti i mëposhtëm i është dërguar Shpejtim Krapit nga numri i mësipërm: “*0654193926*”; në të njëjtën ditë edhe një tekst tjetër i është dërguar Shpejtim Krapit nga i njëjti numër: “*0656331837, mbushi që të dy plot me kredit, Shaip*”; (në këtë rast Shaip Selmani, partneri i biznesit të Ismail Krapit po e përdorte celularin);

Ismail Krapit: Po.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: Pas orarit të punës kush e mbante telefonin?

Ismail Krapit: Ka ndodhë që shkonin tre deri katër ditë që unë nuk e merrja telefonin. E lija në kompani dhe aty gjithmonë kishte roje.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: E merrje zakonisht telefonin me vete?

Ismail Krapit: Kur isha aty në mbrëmje, kafeneja mbetej hapur deri në mesnatë, nëse isha i pranishëm kur mbyllej kafeneja, e merrja me vete. Nëse nuk isha aty kur mbyllej kafeneja, e lija aty sepse më nevojitej.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: A ke pasur numra të tjerë ose jo?

Ismail Krapit: Jo.

⁷⁸ Procesverbali i datës 12 maj 2011, faqja 16:

Ismail Krapit: Të thashë që nuk e njoh këtë numër telefoni dhe është e vërtetë që nuk e njoh këtë numër; unë kam një pseudonim që përdor që është Bucidhe askush nuk më ka thirrur mua me këtë pseudonimin Isë.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

më 26/08/2009, teksti i mëposhtëm i është dërguar Shpejtimit nga numri i mësipërm: *“Shoku, për nja një orë ai djali nga dje do të arrijë në një vend të caktuar”* dhe Shpejtimi u përgjigj: *“Çoje tek apartamenti për nja tri orë, pastaj jepi numrin 0656331837 dhe shkruaj që nuk ke kredit për këtë numër”*;

më 27/08/2009, teksti i mëposhtëm i është dërguar Shpejtimit nga numri i mësipërm: *“më dërgo numrin serb të Metit”* dhe Shpejtimi përgjigjet *“0628368439”*;

më 02/09/2009, teksti i mëposhtëm i është dërguar Shpejtimit nga numri i mësipërm: *“Shpresojmë që sonte të bëjmë punën”* dhe Shpejtimi përgjigjet: *“OK, bos, sigurisht do ta mbarojmë”*;

më 25/09/2009, teksti i mëposhtëm i është dërguar Shpejtimit nga numri i mësipërm: *“Në çfarë kohe duhet të jem në Gjilan?”*;

më 28/09/2009, teksti i mëposhtëm i është dërguar Shpejtimit nga numri i mësipërm: *“Shoku, telefonat janë mbyllur dje që të heqim ata të parët, taksia e Antonit u mori 300 euro, nuk e di a e di këtë”* dhe Shpejtimi u përgjigj: *“Po”*.

Për më tepër, pavarësisht nga fakti që Shpejtimit Ademaj dhe Ismail Krapit e kanë mohuar ta njohin njëri-tjetrin, ata kanë shkëmbyer 279 telefonata, siç del edhe nga raporti i policisë i nënshkruar nga R Z DKO, që mban datën 25 nëntor 2009, numri i referencës së dokumentit të policisë është 2099 DKKO 034.

- Tekstet e mesazheve që i janë dërguar një personi të paidentifikuar, të quajtur Ship, duke përdorur numrin e telefonit 044 245 250:

më 23.07.2009 Shipi i dërgoi tekstin e mëposhtëm Ismailit: *“Is, më trego çfarë po ndodh, ajo gruaja më mori në telefon dhe tha që është bërë gati, dhe a është e sigurt që ajo niset të hënën”* dhe Ismaili u përgjigj: *“Ship, dua që kur ajo të largohet të mos ndalojë e të vonohet diku, është më mirë që ajo të presë në shtëpinë e saj sepse siç e di dua që gjithçka të shkojë mirë, flasim nesër”*;

Më 27.07.2009 Shipi i dërgoi tekstin e mëposhtëm Ismailit: *“Do të të marr në telefon nesër, do të bëhet për dy ditë”*;

Më 29.08.2009 Shipi i dërgoi tekstin e mëposhtëm Ismailit: *“Is, sa deri në Miluz, vetëm burri dhe gruaja pa fëmijë, më trego po ashtu se kur mund të nisen”*;

Më 30.08.2009 Shipi i dërgoi tekstin e mëposhtëm Ismailit: *“Is, e kemi lënë për pasnesër, ok, vetëm që ata të hyjnë në Francë, ok”* dhe më 31.08.2009 Ismaili përgjigjet: *“Nesër, 10.30 në Prishtinë, jepu një telefon me vete, e din ti”*;

më 01.09.2009 në orën 08.45 Shipi i dërgoi tekstin e mëposhtëm Ismailit: *“A po i merr në orën 10 sepse unë duhet të çoj djalin në shkollë, sot fillon klasën e parë, ok”*, dhe Ismaili përgjigjet: *“Leri tek restorant Maxi dhe do të shkoj unë e do t’i marr prej andej”* dhe Shipi u përgjigj përsëri: *“Jo, nuk mund t’i lemë sepse ata do të mendojnë që diçka nuk është në rregull, por a mund t’i marrësh ti në orën 10:30”* dhe Ismaili u përgjigj *“Po”*;

më 08.09.2009 Shipi i dërgoi tekstin e mëposhtëm Ismailit: *“a po i merr ata dy persona, ai po merr paratë, mere pjesën time dhe tënde, ti personalisht duhet të bësh një marrëveshje me ta, që të dy ata kanë paratë, me të gjithë personat që të sjell unë, ti merru me ta personalisht”*;

më 11.09.2009 Ismaili i dërgoi tekstin e mëposhtëm Shipit: *“tregoju atyre se ai do të vijë tani që t’ju marrë e t’ju çojë në gjumë deri në mëngjes, tregoju”* dhe Shipi u përgjigj: *“ata po thonë se ai i ka lënë në rrugë”*;

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

më 08.10.2009 Ismaili i dërgoi tekstin e mëposhtëm Shipit: *“a pranon me 1.8 deri tek A”*, dhe Shipi u përgjigj: *“po, po, do ta bëjmë por duhet të presim derisa ata të përgatiten dhe pastaj i merr ti, ok”*, dhe pastaj Ismaili u përgjigj përsëri: *“mos shko sipër dyshit”* dhe Shipi u përgjigj: *“ok”*.

- Tekstet e mesazheve të dërguara tek një person i panjohur, i quajtur Bajram, duke përdorur numrat +41765147224 dhe 33667216958:

Më 24.09.2009 një person i quajtur Milaim dërgoi një tekst në numrin e parë të sipërpërmendur: *“Axha Bajram për sa më merr nga Subotica në Francë për një person ta çosh direkt, më trego, jam unë Milaimi”*;

Më 29.09.2009 Ismaili i dërgoi tekstin e mëposhtëm numrit të dytë të sipërpërmendur: *“Axha Bajram, pot ë pranosh, kur të shkosh në Francë unë do të të dërgoj 7 mijë Euro, më trego”*.

- Tekstet e mesazheve të dërguara tek një person i panjohur, duke përdorur numrin 385955364220:

më 30.08.2009 Ismaili dërgoi mesazhin e mëposhtëm: *“1800 nga Subotica në Vjenë, sapo më tregoi Shipi që ai është në Suboticë”* dhe pasta jai dërgoi edhe një tjetër: *“1500 është për mua por për ty e bëj pak më lirë, 1700, a e don këtë Mil”*.

- Tekstet e mesazheve që janë shkëmbyer me një person të pidentifikuar, duke përdorur numrin 044 924 016:

më 25.08.2009 personi që e përdorte këtë numër i dërgoi tekstin e mëposhtëm Ismailit: *“buc, a i ka nisë ai ata”*, dhe Ismaili u përgjigj: *“jo, nuk i ka nisë, thotë se do t'i nisë në orën 10 në darkë dhe ti ia kalo mirë”*;

më 26.08.2009 në orën 10.35 Ismaili dërgoi tekstin e mëposhtëm: *“ai i Gjilanit që iku dje sot e ka kry dhe tjetri është akoma në Vjenë, do ta kryjë sot, tung, tung”* dhe në orën 17.29 Ismaili dërgoi edhe një tekst tjetër: *“Po e nis një vajzë, paret po i lemë tek Agushi, aty ku e kemi marrë skllavin dhe gruan e tij, a mund ta lemë tek Agushi”*, dhe personi i pidentifikuar u përgjigj: *“po, leje aty, pa problem”*.

Përsëri mesazhet e mësipërme dëshmojnë dhe flasin vetë, pa pasur nevojë për të shtjelluar shumë lidhur me kuptimin e tyre.

Shumica e konsideratave që janë bërë për Shaip Selmanin vlejné po ashtu edhe për Ismail Krapin. Marrëdhënia me Shpejtim Ademajn është edhe më e fuqishme dhe më e ngushtë dhe të dy ata madje e kanë shprehur hapur se kontrabandonin emigrant (shihni për shembull tekstet e shkëmbyera më 26 gusht).

Në tekstin e dërguar më 28 gusht 2009 Ismaili përmend Antonin, duke e bërë të qartë edhe një herë se grupi kriminal ku po merrte pjesë Krapin, ishte ai grup që udhëhiqej nga Anton Gecaj.

Paorama që na shfaqet nga mesazhet e mësipërme tregon se sa masive ishte veprimtaria e kontrabandimit të emigrantëve dhe se sa i thellë dhe i përcaktuar ishte përfshirja e Krapin dhe se cili ishte roli i tij në organizatë.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Po ashtu si Selmani, roli i Krapit ishte më pak i rëndësishëm se ai i Shpejtimit, siç dukert edhe nga kërkesat për të fundin që të mbushte kartat e telefonëve, si edhe nga fakti që Krapit qartësisht po merrte udhëzime nga Ademaj.

Krapit (ashtu si edhe Selmani) duket se është në krye të kontakteve me emigrantët (përpara dhe gjatë udhëtimit), duke u dhënë informacione emigrantëve lidhur me çmimet dhe ndryshimet e destinacioneve të ndryshme si edhe për mbledhjen e parave (shihni tekstet e shkëmbyera me personin e pidentifikuar më 26 gusht 2009).

I pandehuri është përballur tërësisht gjatë gjykimit kryesor me përmbajtjen e shumicës së teksteve të mesazheve të përmendura më sipër, por ai nuk mundi të japë ndonjë shpjegim të arsyeshëm për shumicën prej tyre: ndonjëherë ai deklaroi se ai vetëm e kishte marrë mesazhin, por që nuk e kishte parë kurrë atë, herë tjetër ai deklaroi se nuk i kujtoheshin rrethanat që e kanë bërë të dërgojë ndonjë mesazh të caktuar ose që mesazhi është dërguar prej tij.

Mungesa e ndonjë shpjegimi alternativ të dhënë nga i pandehuri e forcon perfundimin për ekzistencën e një grupi të organizuar, i cili të paktën gjatë viti 2009, kontrabandoi një numër të madh emigrantësh jashtë Kosovës për në vendet e Europës Perëndimore, dhe për pjesëmarrjen e Ismail Krapit në grupin e mësipërm kriminal.

Kontaktet telefonike që kanë lidhje me të pandehurin Avni Hajdari.

Edhe pse Hajdari ka mohuar të ketë përdorur numrin e telefonit 044 610 955, dëshmia e B R ka qartësuar pa dyshim se i pandehuri po e përdorte numrin e mësipërm.

Rezultatet e listimit të telefonatave kanë treguar se i pandehuri ka shkëmbyer 23 telefonata me Shpejtim Ademajn, pas datës 14.10.2009, edhe pse gjatë marrjes në pyetje ata e kanë mohuar ta kenë njohur njëri-tjetrin.

Për më tepër, rezultati i listimit të telefonatave ka treguar kontakte telefonike, po ashtu, edhe mes Shaip Selmanit e Avni Hajdarit, pa harruar faktin se të dy të pandehurit e kanë mohuar ta kenë njohur njëri-tjetrin (shih raportin e policisë të datës 18/08/2010, numri i referencës 2099 DKKO 034).

Sa për rolin e Qakës/Cakës në organizatë, ia vlen të përmendet përsëri (përmabjtja e mesazhit është analizuar tashmë) mesazhet e mëposhtme të regjistruara në numrin e përdorur nga Shaip Selmani dhe që janë dërguar prej tij më 11.09.2009 tek një person i pidentifikuar, i quajtur Afrim, duke përdorur numrin +31644493317:

*“Afrim, a mund ta përfundosh diçka me atë lidhjen e shpejtë siç ke bërë më parë, t’i çosh drejtë në Francë sepse **qaka** po thotë i çon ai por vetëm për 1600 euro secilin për në Vjenë”.*

- **Rolet e të pandehurve në grupin e organizuar kriminal.**

Pasi është vlerësuar ekzistenca e një grupi kriminal që merret me kontrabandimin e emigrantëve, mund të përcaktohen rolet e anëtarëve të organizatës që janë identifikuar.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Anton Gecaj: ai ishte pa dyshim udhëheqësi, ose të paktën njëri nga udhëheqësit e grupit kriminal dhe kishte disa vetë që punoni për të në Kosovë (njëri nga më aktivët ishte Shpejtim Ademaj). Ai përcaktonte çmimin për kontrabandimin dhe jepte udhëzime për vartësit në fazat e ndryshme të udhëtimit që të kontrabandoheshin emigrantët jashtë Kosovës.

Sasia mjaft e madhe e parave e përfituar gjatë kontrabandimit e bën të qartë që Anton Gecaj ishte njëri nga përfituesit kryesorë të sasisë së madhe të parave të mbledhura nga organizata përmes veprimtarisë së saj kriminale.

Joca (i identified nga prokurori si Josip Gjurashëviq, edhe pse nuk janë ofruar prova lidhur me identifikimin e mësipërm): ai ishte personi që merrej me kryerjen e asaj pjese të udhëtimit të emigrantëve nëpër Serbi, pasi e kishin kaluar kufirin me Kosovën. Pozicioni i tij në organizatë ishte kryesor dhe dukej se ai kishte një rol të ngjashëm me atë të Antonit.

Avni Hajdari, Ismet Rama, Shpejtim Ademaj, Ismail Krapo dhe Shaip Selmani: që të gjithë ata kishin një rol më pak të rëndësishëm se i të dyve të përshkruar më sipër; ata që të gjithë merreshin me mbledhejn e emigrantëve dhe me mbjaten e kontakteve mes tyre (veçanërisht Krapo, Selmani dhe Ademaj) si edhe me transportimin e emigrantëve (veçanërisht Ademaj).

Hajdari (alias Qaka/Caka) duket se është më kryesori në këtë grup njerëzish, meqë nga Anton Gecaj ai tregohej si personi që mund të jepte informacionin lidhur me tragjedinë, pasi Gecaj kishte vendosur të dorëzohej në polici.

Është e qartë se organizata numëronte edhe disa anëtarë të tjerë të paidentifikuar (kryesisht shoferë për transportimin e emigrantëve dhe njerëz të tjerë që merreshin me strehimin e emigrantëve pasi kishin arritur në Suboticë).

Sa për Blerim Ademajn, pjesëmarrja e tij në grupin kriminal duket se është jo plotësisht e provuar. Në fakt, prokurori vetëm ka ofruar provë të përfshirjes së Blerimit në dy episode e kontrabandimit (që ndodhën në të njëjtin rast, në udhëtimin fatal të datës 14 tetor 2009), që është i pamjaftueshëm të bazojë pjesëmarrjen e tij në grupin kriminal, meqë pjesëmarrja në një grup kriminal do të thotë një stabilitet dhe kohëzgjatje e caktuar, e cila nuk është provuar nga prokurori.

Sigurisht ekziston një dyshim i bazuar që Blerimi ishte njëri nga burrat që punonte në Zvicër për Antonin (në fakt Blerimi jetonte atje dhe ishte i përfshirë vetëm në episode e kontrabandimit të emigrantëve në Zvicër), por ky dyshim nuk arrin rangun e provave të plota dhe prandaj, në përputhje me rregullat e parapara me anë të Nenit 3, Par. 2 të KPPK, i pandehuri nuk mund të konsiderohet si një anëtar i organizatës kriminale.

Përfundimi i mësipërm është *a fortiori* i vlefshëm edhe për Fatmir Pajazitin dhe Xhemail Halilajn, të cilët janë akuzuar lidhur me një episod të vetëm të kontrabandimit, pa ndonjë provë të mëtejshme lidhur me pjesëmarrjen e tyre në grupin e organizuar kriminal që merrej me kontrabandimin e emigrantëve.

3. KUALIFIKIMI LIGJOR.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Pss rindërtimit të ngjarjeve dhe vlerësimit të provave të paraqitura, mund të analizohet së fundmi edhe kualifikimi ligjor i fakteve.

Lidhur me episode e veçanta të kontrabandimit, kualifikimi i bërë nga prokurori, që i akuzoi të pandehurit me veprën penale të Kontrabandimit të Migrantëve, në kundërshtim me Nenin 138, Paragrafët 1 dhe 6 të KPK, kjo duket se është e saktë.

Në fakt, Neni 138, Par. 7, Pika 1e KPK qartëson se termi kontrabandim i migrantëve do të thotë prikurimi i hyrjes së paligjshme të një personi në një vend, në të cilin personi nuk është shtetas apo nuk ka qëndrim të përhershëm. Prokurimi i hyrjes së paligjshme duhet bërë me qëllim të përfitimit financiar apo material.

Pika 2 e të njëjtit paragraf specifikon se termi hyrje e paligjshme do të thotë kalimi i një kufiri të Kosovës dhe/apo kalimi i kufijve të një shteti tjetër, pa respektuar kërkesat e nevojshme për hyrje të ligjshme në një vend të tillë.

Pas vlerësimit të provave, mund të konfirmohet me siguri se emigrantët nuk mund të hynin në Hungari në mënyrë të ligjshme (përndryshe pagesa e një shume kaq të madhe parash do të ishte e pakuptimtë) dhe se anija u mbyt ndërsa ata kalonin kufirin mes Hungarisë dhe Serbisë (që shënohet me anë të Lumit Tisa).

Ia vlen të përmendet se fjala “kalim” nuk do të thotë doemos që emigranti hyn në vendin ku ai/ajo nuk mund të hynte në mënyrë të ligjshme; në fakt, me qëllim që ta konsiderojmë veprën penale të kompletuar, është e mjaftueshme që emigrantët kaluan kufirin, edhe pa arritur në vendin (shtetin) tjetër.

Dhe kjo është ajo që ndodhi aktualisht, meqë emigrantët kaluan kufirin e Serbisë, edhe pse shumica e tyre nuk mundën të arrinin në Hungari, por vdiqën në ujërat e Lumit Tisa.

Është provuar, po ashtu, mjaftueshmërisht se hyrja e paligjshme është bërë nga të pandehurit me qëllimin e marrjes së një përfitimi material.

Të gjithë dëshmitarët kanë specifikuar se duhej paguar një çmim për kontrabandimin dhe është thjeshtë e pallogaritshme që secili nga personat e përfshirë në kontrabandim nuk kishte një përfitim material për ndërhyrjen e tyre. Shumica e parave sigurisht do t'u jepej udhëheqësve të organizatës (Antonit dhe Jocës), por sigurisht bie në kundërshtim me llogjikën e ftohtë se njerëzit e përfshirë në kontrabandim nuk po fitonin asgjë për shërbimet e tyre (që përfshinte një sasi të caktuar rreziku, meqë ata ishin të përfshirë në një veprimtari kriminale).

Sa për pozitën e Xhemajl Halilajt, edhe po të mendojmë që ai nuk kishte ndonjë përfitim material në kontrabandimin e familjes Mirena, sidoqoftë ai dha një kontribut rastësor në kryerjen e veprës penale, duke vënë në kontakt Mirenën me Pajazitin, duke mbajtur paratë për kontrabandimin si një lloj depozite (me qëllim që t'ia dorëzonte ato Pajazitit, pasi të përfundonte udhëtimi) dhe duke e informuar Mirenën lidhur me datën dhe vendin e nisjes, duke qenë krejtësisht i vetëdijshëm se Pajaziti po siguronte një përfitim material.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Është një parim i përgjithshëm që, edhe pse vepra penale kërkon një qëllim të veçantë (*dolus specialis*), dhe vepra e parashikuar me anë të Nenit 138 të KPK kërkon qëllimin e veçantë të kontrabandimit të emigrantëve me qëllimin e sigurimit të një përfitimi material, (në këtë mënyrë një qëllim që shkon përtej rezultatit të kryerjes së agjentit), mjafton që të paktën njëri nga pjesëmarrësit në kryerjen e veprës penale (sigurisht në rast se vepra është kryer në bashkë-kryerje) ajo e ka qëllimin e kërkuar të veçantë, ndërsa të tjerët mund të kenë vetëm qëllimin e përgjithshëm që të japin kontributin e tyre në kryerjen e veprës penale.

Në rastin në fjalë Pajaziti e kishte sigurisht atë qëllim të veçantë dhe Halilaj sigurisht që kishte dijeni për këtë; pavarësisht nga kjo, ai me ndërgjegje pranoi të luante një rol aktiv në kontrabandim, duke qenë i ndërgjegjshëm që emigrantët do të dërgoheshin jashtë Kosovës në mënyrë të paligjshme.

Prandaj, Halilaj sigurisht ka dhënë një kontribut të veçantë në kryerjen e veprës penale dhe mu kjo përbën përgjegjësinë e tij.

Është vendi për të shtuar se i njëjti përfundim do të vlente edhe për të pandehurit e tjerë (Shaip Selmani, Ismail Krapo, Blerim Ademaj), në (rastin e papërshtatshëm) kur dikush mund të konsideronte të paprovuar përtej dyshimit të arsyeshëm se ata kishin ndonjë përfitim material. Në fakt, rrethana e pamohueshme që ata kishin dijeni për bashkëpunimin në veprimtari kriminale, që ishte që njerëzit e tjerë sigurisht të përfitonin nga ana material, përcakton saktë fajësinë e tyre mbi bazën e parimit të shpjeguar më sipër.

Prandaj pas vlerësimit të provave të prezantuara dhe vlerësimit sa i përket cilësimit të tyre juridik, mund të vërtetohet që, sa i përket veprës penale Kontrabandimi me Migrantë, ekzistimi i *actus reus* dhe *mens rea* është vërtetuar sa i përket të gjithë të pandehurve të cilët janë dënuar.

Gjithashtu, kualifikimi i bërë nga prokurori i grupit të njerëzve që merren me kontrabandim si një grup i organizuar kriminal konsiderohet i saktë nga trupi gjyqësor.

Në fakt, sa i përket të pandehurve Avni Hajdari, Shpejtim Ademaj, Ismail Krapo dhe Shaip Selmani, është vërtetuar përtej çfarëdo dyshimi të bazuar që pjesëmarrja e tyre në një grup të organizuar kriminal (dhe në aktivitetet e grupit të cekur) të udhëhequr nga Anton Gecaj dhe një individ me emrin Joca, i cili ka qenë i strukturuar me një ndarje të roleve në mes të pjesëtarëve, ka ekzistuar për një periudhë të caktuar kohore (masat e fshehta shfaqin prova për një ekzistim të tillë që nga Qershori 2009, por dëshmitë kanë provuar që aktiviteti ilegal i organizatës, dhe në veçanti i Antonit, kanë filluar shumë më herët) dhe ka vepruar në bashkërenditje me qëllimin e kontrabandimit përjashta Kosovës të një numri masiv të migrantëve. Dobia pasurore e përfituar nga ky aktivitet ka qenë enorme.

Sjelljet e tilla janë tërësisht të përfshira në dispozitën e paraparë nga Neni 274, para. 2 të KPK me të cilën janë akuzuar të pandehurit e lartpërmendur.

Më tej, është e pakontestueshme (sepse është demonstruar në mënyrë fatale nga tragjedia) që kontrabandimi i migrantëve është ndërmarrë nga organizata në një mënyrë në të cilën është rrezikuar jeta dhe siguria e tyre dhe prandaj cilësimi i bërë nga prokurori, i cili i ka akuzuar të pandehurit edhe me Nenin 274 paragrafi 4 të KPK, duket se është i saktë, edhe pse jo për të gjithë të pandehurit.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Në fakt, vetëm sa i përket të pandehurve Avni Hajdari dhe Shpejtim Ademaj mund të konsiderohet si e vërtetuar që, kur ka ndodhur tragjedia, ata ende kanë qenë brenda organizatës kriminale dhe duke marrë pjesë në aktivitetet e saj. Në fakt, siç është treguar me lart, ata kanë qenë drejtpërsëdrejti të përfshirë në kontrabandimin e disa migrantëve të cilët kanë vdekur në tragjedinë që ka ndodhur në lumin Tisa.

Nga formulimi i dispozitës, duket që aplikohet rëndimi i dënimit edhe pse vdekja është në lidhje të thjeshtë shkakore me aktivitetin e organizatës.

Me fjalë tjera, edhe pse Avni Hajdari dhe Shpejtim Ademaj kanë përjashtuar mundësinë që udhëtimi i aranzhuar mund të përfshinte rrezikun e vdekjes për disa migrantë, vet fakti që aktiviteti i kontrabandimit në të vërtetë rezultoi në vdekjen e migrantëve përshinë, në vetvete, që vepra penale e paraparë nga Neni 274, para. 4 është kryer nga dy të pandehurit në referencë me të dyja *actus reus* dhe *mens rea*.

Sidoqoftë, duket qartë që të dy të pandehurit kanë qenë në dijeni të rrezikshmërisë së udhëtimit (të dy ata kanë qenë jo vetëm pjesëtarë të organizatës, por kanë qenë të spikatur) dhe që ata me siguri kanë paraparë dhe pranuar rrezikun që një tragjedi e tillë mund të ndodhë (pakujdesia *apo dolus eventualis*, Neni 15, paragrafi 3 i KPK).

Përkundrazi, e njëjta gjë nuk mund të thuhet për Ismail Krapin dhe Shaip Selmanin.

Nuk ka asnjë provë që të pandehurit e lartcekur kanë qenë të përfshirë në kontrabandimin e migrantëve të cilët kanë qenë në barkë duke kaluar lumin Tisa natën e 14 Tetorit 2009. Tekst mesazhet e fundit relevante sa i përket përfshirjes së tyre në kontrabandimin e migrantëve datojnë nga fundi i Shtatorit.

Prandaj, sipas Nenit 3, para. 2 të KPPK, nuk mund të konsiderohet si e vërtetuar përtej dyshimit të bazuar që të pandehurit e lartcekur ende kanë qenë pjesëmarrës aktiv në aktivitetet e organizatës kur ka ndodhur tragjedia dhe që ata kanë qenë të përfshirë në aktivitetet që kanë çuar në vdekjen e migrantëve.

Prandaj, sa i përket Ismail Krapit dhe Shaip Selmanit, cilësimi i bërë nga prokurori nuk duket se është i saktë dhe akuza penale duhet të ri-cilësohet nga Neni 274 para. 4 të KPK në Nenin 274, para. 2 të KPK.

Pas ri-cilësimit të akuzës, provat e prezantuara kundër dy të pandehurve të lartcekur tregojnë padyshim ekzistimin e *actus reus* dhe *mens rea* në lidhje me veprën e lartcekur penale.

4. PROPOZIMET E PALËVE

Palët kanë ngritur disa çështje gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Nga disa dëshmitarë është kërkuar që të i njohin të pandehurit përpara trupit gjykues. Pasi që dëshmitarët e kanë bërë njohjen pa përshkrim të mëparshëm të personave që është dashtë të i njohin, disa nga avokatët mbrojtës kanë pretenduar që kjo mënyrë e veprimit është në shkelje të rregullave të parapara në Nenin 255 të KPPK.

Trupi gjykues i konsideron si të gabuara kundërshtimet e lartcekura: Në fakt Neni 255 i KPPK ka të bëjë me vet identifikimin e personave apo sendeve; identifikimi, siç rezulton qartë nga lokacioni i dispozitës, është një veprim hetimor.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Përkundrazi, njohja e një personi përpara gjykatës duhet të konsiderohet si pjesë e dëshmisë dhe prandaj nuk i nënshtrohet rregullave të parapara për identifikim.

Më tej avokatët mbrojtës kanë kërkuar më shumë se një herë që disa deklarata të dhëna nga dëshmitarët të përjashtohen, sepse avokatët mbrojtës të të pandehurve nuk janë ftuar për të ndihmuar në marrjen në pyetje.

Interpretimi i lartcekur përsëri është i pavlerë, siç rezulton nga aktvendimi i lëshuar në seancën e 9 Shkurtit 2011.⁷⁹

Veç kësaj, avokati mbrojtës i Avni Hajdarit ka kërkuar nga gjykata që të parashtrojë një kërkesë te Autoritetet Serbe me qëllim për të ditur nëse janë bërë autopsitë e njerëzve të vdekur dhe sa njerëz kanë qenë në barkën që është përmbysur.

Kërkesat e lartcekura janë konsideruar të panevojshme nga trupi gjykues, siç rezulton nga aktvendimi i lëshuar në seancën e 14 Prillit 2011.⁸⁰

Avokati i njëjtë mbrojtës ka paraqitur vërejtje që raportet e policisë në bazë të tekst mesazheve të siguruara nëpërmes urdhrave për masa të fshehta duhet të shpallen prova të papranueshme, pasi që ato kishin lidhje me tekst mesazhet e dërguara dhe të pranuar para lëshimit të urdhrimit. Me fjalë tjera avokati mbrojtës ka pretenduar paligjshmërinë e masës së fshehtë të përgjimit të telefonave sa i përket tekst mesazheve të shkëmbyera para lëshimit të urdhrimit për përgjim.

Trupi gjykues e konsideroi kundërshtimin si të pavlerë, sepse masa e fshehtë e përgjimit të telekomunikimeve e parapare në Nenin 258 të KPPK nuk bën ndonjë dallim në mes të telekomunikimeve që janë në vazhdim e sipër (siç janë bisedat nëpërmes telefonit) dhe telekomunikimeve që tashmë kanë ndodhur (siç janë tekst mesazhet), por thjeshtë i referohet telekomunikimeve.

Dhe, pasi që është e pakontestueshme që masa e fshehtë e përgjimit të telekomunikimeve lejon përgjimin e tekst mesazheve në vazhdim e sipër, në mungesë të një ndalesë specifike në

⁷⁹ Procesverbali i 9 Shkurtit 2011, faja 10:

Sa i përket kundërshtimit të parë të ngritur nga Avokati Mbrojtës në lidhje me deklaratën që dëshmitari ia ka dhënë Prokurorit Publik, trupi gjykues lëshon këtë aktvendim: kundërshtimi është i pabazë dhe prandaj refuzohet. Në fakt është e shkruar qartë në Nenin 237 të KPP që Prokurori Publik mund të vendosë të thërret avokatin mbrojtës gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit. Folja "mund" e bën të qartë që Prokurori Publik nuk është i obliguar që të ftojë Avokatin Mbrojtës gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit.

⁸⁰ Procesverbali i 14 Prillit, faja 2:

Sa i përket kërkesës për prova të paraqitur nga Bajram Tmava, të datës 4 Mars 2011, trupi gjykues lëshon këtë aktvendim: kërkesa për prova të reja nga Serbia refuzohet; në fakt sa i përket informacioneve me qëllim që të verifikohet nëse autopsia është bërë në Serbi, kërkesa është e panevojshme pasi që nga provat që janë në dosje të lëndës dhe gjithashtu nga provat e pranuar gjatë shqyrtimit gjyqësor shkaku i vdekjes së viktimave duket i qartë dhe evident. Sa i përket kërkesës për të verifikuar numrin e saktë të njerëzve të barkë, rrethana e lartcekur është sqaruar nga dëshmitari M R dhe prandaj nuk ka nevojë për sqarim. Rrethanat se kush ka qenë pronari i barkës dhe kush e ka drejtuar barkën nuk janë relevante sepse M R ka sqaruar që ishte e qartë që barka ishte e mbingarkuar dhe ai nuk foli për ndonjë gabim të shoferit. Sa i përket kërkesës që të kërkohet sqarim nga autoritetet Serbe në lidhje me rolet e të akuzuarve, rrethana e lartpërmendur do të mund të sqarohet nëpërmes provave në dosje të lëndës dhe atyre që do të pranohen gjatë shqyrtimit gjyqësor.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

ligj, nuk ekziston asnjë arsye logjike apo juridike pse tekst mesazhet tashmë të shkëmbyera të mos mund të përgjohen nëpërmes masave të njëjta të fshehta.

Prandaj masa e fshehtë e përgjimit të telekomunikimeve mund të konsiderohet absolutisht legjitime me qëllim të sigurimit të tekst mesazheve të shkëmbyera para lëshimit të urdhrat për përgjim (në fakt semantika e fjalës përgjim – nga folja Latine *capere*, që do të thotë të merr - kujton një aktivitet të fshehur të marrjes, por nuk do të thotë që marrja duhet të ketë lidhje vetëm me bisedat në vazhdim e sipër).

Më tej, prokurori ka prezantuar në dy raste deklaratën që Enver Neziri ia ka dhënë autoriteteve Hungareze: në rastin e parë prova është deklaruar si e papranueshme, pasi që nuk ishte siguruar në pajtim me Nenin 507 të KPPK;⁸¹ pastaj prokurori ka treguar se ai i është bindur kushteve të parapara në Nenin 507 para. 3 të KPPK, por prova është konsideruar e panevojshme nga trupi gjykues.⁸²

5. PËRCAKTIMI I DËNIMIT

Kur imponon sanksionin penal, gjykata duhet të ketë parasysh edhe qëllimin e përgjithshëm të dënimit – që është për të parandaluar aktivitetet e rrezikshme për shoqërinë duke i ndaluar të tjerët nga kryerja e veprave të ngjashme penale – dhe qëllimin specifik që është parandalimi i kryesit nga përsëritja e veprës penale.

Në rastin aktual trupi gjykues ka arritur në përfundim që veprat penale për të cilat të pandehurit janë shpallur fajtorë janë akte kriminale shumë të rënda, të kryera me qëllim dhe me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore.

Sa i përket pozitës së Shpejtim Ademajt, Avni Hajdarit, Ismail Krapit, Shaip Selmanit dhe Fatmir Pajazitit, gjithashtu duhet shtuar që ata kanë gënjyer haptazi gjatë procedurës penale, duke i mohuar rrethanat që janë vërtetuar në mënyrë të pamohueshme nga aktivitetet e përgjimit dhe prandaj nuk kanë shfaqur asnjë shenjë pendimi, pavarësisht nga tragjedia e tmerrshme që ka ndodhur.

Sa i përket të pandehurit Blerim Ademaj, deklarata e tij, edhe pse jo tërësisht e sinqertë në lidhje me rolin e tij dhe atë të vëllait të tij, sidoqoftë ka ndriçuar deri diku strukturën dhe rolet në organizatën që kontrabandonte njerëz përjashta Kosovës dhe prandaj kjo rrethanë (dhe fakti që ai në mënyrë spontane i është dorëzuar policisë dhe ka hequr dorë nga e drejta për seancë për konfirmim të aktakuzës) duhet të merret parasysh kur të përcaktohet dënimi kundër tij.

⁸¹ Procesverbali i 14 Prillit 2011, faqja 4

⁸² Procesverbali i 24 Majit 2011, faqja 4:

Deklarata e Enver Nezirit sipas Nenit 152 paragrafi 3 pika 1 trupi gjykues konsideron që marrja e një prove të tillë është panevojshme dhe në fakt sa i përket deklaratës ajo i ka dy pika relevante, së pari identifikimi nga dëshmitari Avni Adiri i personit me nofkën Joca sa i përket kësaj pike dëshmitarë të tjerë në këtë shqyrtim gjyqësor tashmë ka dhënë deklaratat e tyre dhe prandaj marrja në pyetje e Enver Nezirit është e panevojshme. Pika tjetër e rëndësishme është bashkëpunimi i pretenduar i Jocës me Anton Gecajn por dëshmitari në deklaratë ka raportuar që ai vetëm i ka dëgjuar rrethanat nga një person tjetër dhe prandaj marrja në pyetje e dëshmitarit nuk do të ishte e rëndësishme dhe e nevojshme sa i përket pikës së lartcekur dhe deklarata të i kthehet Prokurorit Publik.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Poashtu fakti se të pandehurit Shpejtim Ademaj, Blerim Ademaj, Avni Hajdari, Ismail Krapit, Shaip Selmani dhe Xhemail Halilaj nuk kanë qenë të dënuar më parë duhet marrë konsideratë lidhur me përcaktimin e dënimit.

Sa i përket Fatmir Pajazitit, ai ka qenë më parë i dënuar më një vit burgim për veprën penale të Rrezkim në Trafikut Publik, në kundërshtim me Nenin 165 të Ligjit Penal të Kosovës.

Sa i përket Xhemajl Halilaj gjykata konstaton se ekzistojnë rrethana lehtësuese, të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet duke shqiptuar dënim më të lehtë (Neni 66, paragrafi 1 pika 2 e KPPK-së). Në fakt ai haptas dhe me sinqeritet i përshkroi ngjarjet në të cilat ka qenë i përfshirë, duke zbardhur veprimet (të cilat përndryshe do të mbeteshin të paqartë) që janë ndërmarr nga ai dhe Fatmir Pajaziti në lidhje me kontrabandimin e familjes Mirena.

Përveç kësaj sjellja e tij e sinqertë gjatë gjithë shqyrtimit kryesor dhe shkalla e ultë e përgjegjësisë penale çoi në konkludimin që të shqiptohet një dënim me kusht.

Prandaj trupi Gjykses, pas marrjes në konsideratë të gjitha kriteret e parapara me Nenet 64, 64 dhe 66 të KPPK-së, përcakton dënimin si në vijim:

Sa i përket Shpëjtim ADEMAJ, Gjyqi e konsideron se dënimi do të jetë si në vijim:

14 vjet burg dhe 200.000 Euro gjobë lidhur me veprën penale të Krimit të Organizuar, në kundërshtim me Nenin 274, paragrafi 4 i KPK-së;

2 vjet burg për çdo emigrant të kontrabanduar lidhur me veprën penale të Kontrabandimit të Emigrantëve në bashkë-kryerje, në kundërshtim me Nenin 138, paragrafi 6 dhe Neni 23 i KPK-së (kontrabandimi i secilit emigrant përfshin kryerjen e një veprë penale në kundërshtim të Nenit 138 paragrafi 6 i KPK-së, prandaj i pandehuri i sipërm ka kryer pesë vepra penale në kundërshtim të Nenit 138, 6 të KPK-së);

Dënimi unik, në pajtim me Nenin 71, paragrafi 1 dhe 2 i KPK-së është përcaktuar në 17 vjet burg dhe 200.000 Euro gjobë;

Sa i përket Avni HAJDARAJ, Gjyqi është i mendimit se dënimi i drejtë do të jetë si në vijim:

16 vjet burg dhe 250.000 Euro gjobë lidhur me veprën penale të Krimit të Organizuar, në kundërshtim të Nenit 274, paragrafi 4 i KPK-së;

2 vjet burg për secilin emigrant të kontrabanduar lidhur me veprën penale të Kontrabandimit të Emigrantëve në bashkë-kryerje, në kundërshtim të Nenit 138, paragrafi 6 dhe Neni 23 të KPK-së (kontrabandimi i secilit emigrant përfshin kryerjen e një veprë penale në

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

kundërshtim të Nenit 138 paragrafi 6 i KPK-së, prandaj i pandehuri i sipërm ka kryer tetë vepra penale në kundërshtim të Nenit 138, 6 të KPK-së);

Dënimi unik, në pajtim me Nenin 71, paragrafi 1 dhe 2 të KPK-së është përcaktuar në 19 vjet burg dhe 250.000 Euro gjobë;

Në lidhje me dënimin prej 250.000 Euro gjobë kundër Hajdarit dhe Ademajt është me rëndësi si në vijim:

Neni 71, paragrafi 4 dhe 5 i KPPK-së, i cili parasheh që rasti i dënimit unik kur dënimet për të qenë unik nuk janë homogjene (gjobë dhe burgim), parasheh gjobë maksimale prej 50.000 Euro.

Është e qartë se shuma e lartëcekur duhet të konsiderohet si gabim administrativ (50.000 Euro në vend të 500.000 Euro) meqë ekzistojnë vepra të vetme penale siç është Krimi i Organizuar (Neni 274, paragrafi 4 i KPK-së) që mund të dënohet me gjobë deri në 500.000 Euro.

Përndryshe, mos marrja parasysh e kufirit të sipërm si një gabim administrativ do të rezultojë që në lidhje me një person të dënuar në procedurë të njëjtë për dy vepra penale të Krimin të Organizuar, në kundërshtim me Nenin 274, par. 4 të KPK-së, gjoba maksimale e shqiptueshme do të ishte 50.000 Euro, ndërsa gjoba maksimale për çdo vepër penale të Krimin të Organizuar do të jetë 500,000 Euro (që është kundër logjikës dhe arsyes së thjeshtë, prandaj çon në përfundimin se maksimumi i treguar prej 50.000 për dënim unik është një gabim administrativ).

Sa për Ismail KRAPI dhe Shaip SELMANI Gjykata vlerëson se dënimi i drejtë do të jetë si vijon:

8 vjet burgim secilit për veprën penale të Krimin të Organizuar, në kundërshtim të Nenit 274, paragrafi 2 i KPK-së.

Sa për Fatmir PAJAZITI Gjykata vlerëson se dënimi i drejtë do të jetë si vijon:

2 vjet burgim për çdo emigrant të kontrabanduar për veprën penale të Kontrabandimit të Emigrantëve në bashkë-kryerje, në kundërshtim me Nenin 138, paragrafi 6 dhe Nenit 23 të KPK-së (kontrabandimi i çdo emigranti përfshin kryerjen e një vepre penale në kundërshtim të Nenit 138 paragrafi 6 të KPK-së, prandaj i pandehuri i lartë ka kryer pesë vepra penale në kundërshtim me Nenin 138, 6 të KPK-së);

dënimi unik, në pajtim me Nenin 71 paragrafët 1 dhe 2 të KPK-së, është përcaktuar në 7 vjet burgim.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Sa i përket Xhemajl HALILAJ, Gjykata vlerëson se dënimi i drejtë do të jetë si vijon:

1 vit e 6 muaj burgim për çdo emigrant të kontrabanduar për veprën penale të Kontrabandës së Emigrantëve në bashkë-kryerje, në kundërshtim të Nenit 138, paragrafi 6 dhe Nenit 23 të KPK-së (kontrabandimi i çdo emigranti përfshin kryerjen e një vepre penale në kundërshtim të Nenit 138 paragrafi 6 të KPK-së, prandaj i pandehuri ka kryer pesë vepra penale në kundërshtim me Nenin 138, 6 të KPK-së);

dënimi unik, në pajtim me Nenin 71 paragrafët 1 dhe 2 të KPK-së, është e përcaktuar në 2 vjet burgim.

Në pajtim me Nenet 41, 42, 43 dhe 44 të KPK-së dënimi kundër Xhemajl Halilaj është me kusht, prandaj dënimi nuk do të ekzekutohet nëse personi i dënuar nuk e kryen një vepër tjetër penale për një periudhë prej 3 vjetësh.

Sa i përket Blerim ADEMAJ Gjykata vlerëson se dënimi i drejtë do të jetë si vijon:

2 vjet burgim për çdo emigrant TË kontrabanduar për veprën penale të kontrabandimit me Emigrantë në bashkë-kryerje, në kundërshtim me Nenin 138, paragrafi 6 dhe nenit 23 të KPK-së (kontrabandimi i çdo emigranti përfshin kryerjen e një vepre penale në kundërshtim të Nenit 138 paragrafi 6 të KPK-së, prandaj i pandehuri ka kryer katër vepra penale në kundërshtim me Nenin 138, 6 të KPK-së).;

dënimi unik, në pajtim me Nenin 71 paragrafët 1 dhe 2 të KPK-së, është përcaktuar në 5 vjet burgim.

Koha e kaluar në paraburgim nga Fatmir Pajaziti, Avni Hajdari dhe Shpejtim Ademaj nga 16.12.2009 deri sa aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm duhet të llogaritet në kuadër të dënimit në përputhje me Nenin 391 paragrafi (1), nënparagrafi 5 dhe Neni 278 paragrafi 7 i KPPK-së.

Koha e kaluar në arrest shtëpiak nga Xhemajl Halilaj nga 16.12.2009 deri më 14.09.2010 duhet të llogaritet në kuadër të dënimit, në përputhje me Nenin 391 paragrafi (1), nënparagrafi 5 dhe Neni 278 paragrafi 7 të KPPK-së.

Koha e kaluar në paraburgim nga Shaip Selmani dhe Ismail Krapu prej datës 16.12.2009 deri më 17.12.2009 dhe nga 17/06.2011 derisa aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm duhet të llogaritet në kuadër të dënimit, në përputhje me Nenin 391 paragrafi (1), nënparagrafi 5 dhe Neni 278 Par 7 të KPPK-së.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Koha e kaluar në arrest shtëpiak nga Blerim Ademaj nga data 27/01/2011 deri më 16/06/2011 dhe në paraburgim nga data 17/06/ 2011 derisa aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm, duhet të llogaritet në kuadër të dënimit, në përputhje me Nenin 391 paragrafi (1), nënparagrafi 5 dhe Neni 278 Paragrafi 7 të KPPK-së.

6. SHPENZIMET

Të akuzuarit e shpallur fajtor duhet të mbulojnë shpenzimet e procedurës penale, me përjashtim të përkthimit (KPPK, Neni 102, paragrafi 1).

Kostoja është përcaktuar në 70 Euro për një seancë që arrin shumën totale prej 1,330 Euro, duke përfshirë koston e masave të fshehta të lëshuara gjatë hetimit, plus 1000 euro për shpenzimet e udhëtimeve të bëra, përkatësisht nga Gjermania dhe Sllovenia, nga dëshmitarët Avdurrahim Ademi dhe Halil Curri.

Prandaj shuma e përgjithshme është përcaktuar në 2,330 euro. Meqë nuk është e mundur të përcaktohet se çfarë pjese të shpenzimeve do të paguhet nga secili i pandehur, personat e dënuar duhet të jenë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për shpenzimet.

7. KËRKESA PËR KOMPENSIM

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor palët e dëmtuarit janë përkujtuar për mundësinë për të parashtruar kërkesë për të realizuar kompensim material në kuadër të procedurës penale, sipas KPPK-së, Neni 355, Par. 2, por nuk është paraqitur asnjë kërkesë për kompensim material në gjykatë.

Prandaj gjykata nuk ishte e detyruar të marrë një vendim të veçantë lidhur me këtë çështje.

8. KËSHILLA JURIDIKE

Këshilla juridik: në bazë të Nenit 400 të KPPK-së, një ankesë duhet të shpallet brenda 8 ditëve nga shpallja e këtij Aktgjykimi.

Në bazë të Nenit 407 të KPPK-së, ankesa duhet të dorëzohet nëpërmjet Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, në Gjykatën Supreme të Kosovës brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga data e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit.

Procesmbajtëse

Vlora Johnston

Kryetari i Trupit Gjyqësor

Gianfranco Gallo

